**VENDIM**
**Nr. 380, datë 30.11.2023**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË DREJTUESVE TË PROKURORIVE TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM"**

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa "a" të Kushtetutës, nenet 159, pika 2, germat "a" dhe "e", 164 pika 8, 184 "dh" dhe 189, pika 1, germa "c", të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes e sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe me propozimin e Grupit të Punës sipas urdhrit të kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 1430, datë 23.6.2023, "Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e rregullores për vlerësimin etik dhe profesional të drejtuesve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm", Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për vlerësimin etik dhe profesional të drejtuesve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm", si dhe anekset bashkëlidhur sipas tekstit që shoqëron këtë vendim.
2. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
3. U shpall në Tiranë, sot më 30.11.2023.

KRYETAR
**Alfred Balla**

**RREGULLORE**
PËR VLERËSIMIN E DREJTUESIT TË PROKURORISË TË PROKURORIVE TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
**Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, procedurës, kritereve dhe metodologjisë për vlerësimin e veprimtarisë së drejtuesit të prokurorisë, në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë", i ndryshuar.

Neni 2
**Qëllimi i rregullores**

1. Vlerësimi i veprimtarisë së drejtuesit të prokurorisë, si elementi bazë i zhvillimit të karrierës, si dhe i përmirësimit të vazhdueshëm të performancës dhe aftësive profesionale të tyre.
2. Vendosja e standardeve të qëndrueshme për vlerësimin e aftësive drejtuese, organizative dhe të komunikimit të drejtuesit të prokurorisë të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm.
3. Të kontribuojë në përmirësimin e strukturës organizative të prokurorive, si dhe të kushteve të punës të magjistratëve.

4. Përcaktimi i mënyrës së kryerjes të vlerësimit të veprimtarisë së drejtuesit të prokurorisë të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm.

Neni 3
**Fusha e veprimit**

1. Kjo rregullore zbatohet për vlerësimin e veprimtarisë së drejtuesit të prokurorisë të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, të zgjedhur apo caktuar përkohësisht në këtë pozicion, të cilët e kanë ushtruar këtë detyrë për të paktën 1 (një) vit nga data e marrjes së këtij mandati.

2. Drejtuesi vlerësohet të paktën një herë gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij. Në çdo rast, veprimtaria e drejtuesit vlerësohet nga Këshilli të paktën gjashtë muaj para përfundimit të këtij mandati.[1]

3. Këto rregulla nuk zbatohen për vlerësimin e aftësive drejtuese dhe organizative të:

a) Drejtuesit të prokurorisë për veprimtarinë si prokuror gjatë kohës që ushtron edhe detyrën si drejtues, veprimtari e cila do i nënshtrohet vlerësimit sipas rregullores të miratuar me vendimin nr. 95, datë 9.5.2022, "Për miratimin e rregullores për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve";[2]

b) Prokurorit të Përgjithshëm për kohën që ai ushtron këtë funksion.

Neni 4
**Përkufizime**

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a)"Dosja e vlerësimit" është dosja e hapur për secilin drejtues prokurorie në vlerësim, që përmban dokumentet e cituara në nenin 82, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe aktet e tjera të përcaktuara në këtë rregullore;

b) "Drejtuesi" është drejtuesi i prokurorisë, i caktuar përkohësisht apo i zgjedhur;

c) "Këshilli" është Këshilli i Lartë i Prokurorisë;

ç) "Komisioni" është Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale në Këshill;

d) "Këshilltari për vlerësimin" është prokurori i komanduar pranë Këshillit, pjesë e njësisë mbështetëse të komisioneve, i ngarkuar me përgatitjen e akteve në dobi të procesit të vlerësimit;

dh) "Ligji për statusin" është ligji nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;

e) "Raporti analitik" është akti që hartohet nga këshilltari për vlerësimin, nën mbikëqyrjen e relatorit;

ë) "Relatori" është anëtari i Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale në Këshill dhe/ose anëtari zëvendësues, i caktuar me short për çdo vlerësim;

f) "Projektraporti i vlerësimit" është akti i hartuar nga relatori që përmban, për secilin drejtues prokurorie, të dhënat dhe informacionet sipas nenit 93 të ligjit për statusin, analizën e tyre dhe propozimin për nivelin e vlerësimit;

g) "Bashkëpunim efektiv" nënkupton që drejtuesi i prokurorisë gjatë komunikimit zyrtar shkresor zbaton afatet e posaçme dhe të përgjithshme të Kodit të Procedurave Administrative, apo legjislacioni procedural penal.

Neni 5
**Parimet e vlerësimit**

---

[1] Shiko nenin 84/3 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

[2] Shiko nenin 76/2 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili parashikon se: "Vlerësimi i aftësive drejtuese si kryetar me të paktën "shumë mirë" ka përparësi në vlerësimin si magjistrat, i cili kryhet pas vlerësimit si kryetar".

Vlerësimi i drejtuesve të prokurorisë bazohet dhe kryhet në përputhje me parimin e ligjshmërisë, pavarësisë, barazisë, objektivitetit, transparencës, mosdiskriminimit, meritokracisë dhe të drejtës për zhvillimin e karrierës.

Neni 6
**Kriteret për vlerësimin e veprimtarisë së drejtuesit**[3]

Vlerësimi i veprimtarisë së drejtuesit të prokurorisë kryhet bazuar në këto kritere:
a) aftësitë drejtuese dhe organizative;
b) aftësitë e komunikimit.

Neni 7
**Aftësitë drejtuese dhe organizative**[4]

1. Me anë të kriterit të aftësive drejtuese dhe organizative vlerësohen aftësitë e drejtuesit për organizimin e qartë të veprimtarive administrative, si prokuror, nëpërmjet dhënies së vendimeve dhe urdhrave për të siguruar respektimin e afateve dhe përdorimin sa më të mirë të burimeve të disponueshme, si dhe aksesin dhe transparencën në prokurori pa cenuar sekretin hetimor.
2. Kriteri i aftësive drejtuese dhe organizative matet duke u bazuar në treguesit që kanë lidhje me:
a) mirorganizimin e prokurorisë në seksione;
b) planifikimin e prokurorëve për çështje të natyrës urgjente;
c) zëvendësimin në kohë të prokurorëve që kanë pengesa në proces;
ç) zhvillimin e mbledhjeve tematike për prokurorët;
d) planifikimin dhe përdorimin efikas të fondeve publike, sipas nevojave të prokurorisë;
dh) mbikëqyrjen, për efekt të përmirësimit të informacionit në faqen zyrtare të prokurorisë;
e) mbikëqyrjen, për krijimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori, në përputhje me nevojat e palëve e të publikut;
ë) organizimin e trajnimeve për prokurorët dhe punonjësit e prokurorisë.
3. Përfshirja e drejtuesit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë ose në trajnime profesionale për drejtimin dhe organizimin e prokurorisë vlerësohet me përparësi në matjen e këtij kriteri.

Neni 8
**Aftësitë komunikuese**[5]

1. Me anë të kriterit të aftësisë komunikuese vlerësohet aftësia e drejtuesit për komunikim të qartë, në kohë dhe transparent. Ky kriter matet duke u bazuar në treguesit që kanë lidhje me:
a) bashkëpunimin efektiv dhe në kohë me Këshillin, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Ministrinë e Drejtësisë, Kontrollin e Lartë të Shtetit ose me çdo institucion tjetër mbikëqyrjeje ose auditi;
b) komunikimin me publikun dhe të tretët, duke caktuar saktësisht oraret për pritjen e publikut, dokumentacionin e takimeve ose të shkresave për t'iu përgjigjur institucioneve të ndryshme

Neni 9
**Burimet e vlerësimit për veprimtarinë e drejtuesve**[6]

---

[3] Shiko nenin 79 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
[4] Shiko nenin 80 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
[5] Shiko nenin 81 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
[6] Shiko nenin 82 i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Vlerësimi i veprimtarisë së drejtuesit bazohet në këto burime:

a) dosja personale e drejtuesit;

b) vlerësimi i kryer nga drejtuesi, i cili përmbush, në mënyrë të njëjtë, kriteret e vlerësimit të kryer nga magjistrati;

c) raportet vjetore të drejtuesit, ku pasqyrohen të dhënat e veprimtarisë financiare dhe procesverbalet e mbledhjeve vjetore të analizës së prokurorisë, si dhe raporti përkatës i përfaqësuesit të Këshillit në këto mbledhje, duke përfshirë edhe regjistrimin audio;

ç) çdo urdhër ose vendim i drejtuesit i nxjerrë në ushtrim të kompetencave për organizimin e prokurorëve ose të administratës të prokurorisë;

d) të dhëna statistikore për funksionimin e prokurorisë në pesë vitet e fundit;

dh) raportet e inspektimit të prokurorisë nga institucionet shtetërore;

e) çdo dokument, i cili tregon aftësitë e komunikimit të drejtuesit me publikun dhe të tretët;

ë) mendimi i dhomës vendore të avokatisë dhe të kryetarit të gjykatës ku ushtron funksionin drejtuesi i prokurorisë;

f) informacioni me shkrim nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera që vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e drejtuesit në veprimtari trajnuese për drejtimin dhe organizimin e prokurorisë;

g) të dhëna për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj drejtuesit në këtë cilësi, gjatë periudhës së vlerësimit;

gj) vendime përfundimtare për masa disiplinore, për shkak të pozicionit të drejtuesit, të dhëna gjatë periudhës së vlerësimit, pavarësisht nëse masa disiplinore është shuar ose jo;

h) kundërshtimet e drejtuesit dhe çdo procesverbal ose dokument i seancës dëgjimore gjatë procesit të vlerësimit;

i) çdo burim tjetër që evidenton veprimtarinë profesionale të drejtuesit. (- mendimi i Prokurorit të Përgjithshëm për performancën e prokurorisë për periudhën e vlerësimit; - raportimet vjetore të Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvendin e Shqipërisë; - vlerësimi i Prokurorit të Përgjithshëm për funksionimin e policisë gjyqësore në atë prokurori për periudhën e vlerësimit dhe për organizimin dhe funksionimin administrativ të prokurorisë);

j) aktet e tjera të përcaktuara në këtë rregullore dhe anekset e saj,

### Neni 10
### **Nivelet e vlerësimit**[7]

1. Vlerësimi i veprimtarisë të drejtuesit kryhet sipas këtyre niveleve:

a) "Shumë mirë", në rastin e veprimtarisë drejtuese me cilësi mbi mesataren;

b) "Mirë", në rastin e veprimtarisë drejtuese me cilësi mesatare;

c) "Mjaftueshëm", në rastin e veprimtarisë drejtuese nën mesatare.

2. Vlerësimi i përgjithshëm "shumë mirë" jepet nëse veprimtaria e drejtimit të drejtuesit vlerësohet "shumë mirë" në të dyja kriteret. Vlerësimi i përgjithshëm "mjaftueshëm" jepet nëse veprimtaria e drejtimit të drejtuesit vlerësohet "mjaftueshëm", të paktën në një prej kritereve. Në rastet e tjera, veprimtaria e drejtimit të drejtuesit vlerësohet "mirë".

## KREU II
## PROCEDURA E VLERËSIMIT TË DREJTUESIT

### Neni 11
### **Roli i Komisionit**

Komisioni për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale është përgjegjës, për:

---

[7] Shiko nenin 83 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

1. Përgatitjen dhe propozimin drejtuar Këshillit, brenda muajit nëntor të çdo viti, të programit vjetor të vlerësimit etik dhe profesional të drejtuesve për vitin pasardhës.

2. Ndjekjen e procedurës së vlerësimit për çdo drejtues, të përcaktuar në listën e vlerësimit.

3. Pas krijimit të dosjes së vlerësimit dhe përgatitjes së raportit analitik, Komisioni vlerëson, nëse dokumentacioni i dosjes së vlerësimit është i plotë dhe mund të vijohet me hartimin e projektraportit të vlerësimit, ose i kërkon relatorit marrjen e të dhënave të tjera nga burimet e vlerësimit, duke i përcaktuar ato.

Neni 12
**Roli i relatorit**

1. Relator është njëri nga anëtarët e Komisionit për Vlerësimin Etik dhe Profesional i cili caktohet me short në mbledhjen e Këshillit.

2. Përveç rasteve të konfliktit të interesit apo pamundësisë në ushtrimin e funksionit, bazuar në arsye që lidhen me ngarkesën dhe efektivitetin e punës, me kërkesë të motivuar të kryetarit të Komisionit ose të çdo anëtari të Komisionit, Këshilli mund të vendosë:

a) përjashtimin e një anëtari të Komisionit nga shorti;

b) përfshirjen në procedurat e shortit për caktimin e relatorit, të anëtarëve zëvendësues. Në këtë rast, anëtari zëvendësues që përfshihet në short, zgjidhet sipas përkatësisë, prokuror ose joprokuror, të anëtarit që zëvendëson;

c) rregulla të tjera për mënyrën e hedhjes së shortit, në varësi të rrethanave dhe në funksion të rritjes së efektivitetit dhe transparencës.

3. Relatori është përgjegjës për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të aftësive drejtuese, organizative dhe të komunikimit të drejtuesit dhe merr masat e mëposhtme për:

a) njoftimin e drejtuesit për fillimin e procedurës së vlerësimit

b) mbledhjen e dokumentacionit të vlerësimit, duke bashkëpunuar dhe komunikuar me drejtuesin, komisionin përkatës dhe çdo institucion tjetër;

c) mbikëqyr krijimin e dosjes së vlerësimit dhe të përgatitjes së raportit analitik;

ç) njoftimin e kryetarit të Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale në Këshill, për krijimin e dosjes së vlerësimit dhe të raportit analitik;

d) harton projektraportin e vlerësimit të drejtuesit;

4. Në ushtrimin e përgjegjësive të tij relatori ndihmohet nga këshilltari ligjor magjistrat i komanduar në Këshill që caktohet me short, si dhe nga Njësia Mbështetëse e Komisioneve dhe personeli administrativ i Këshillit, të cilët kanë detyrimin të ndjekin procedurat, të kryejnë veprimet dhe të përgatisin aktet përkatëse, sipas udhëzimeve të relatorit.

Neni 13
**Këshilltari për vlerësimin**

1. Këshilltari për vlerësimin është prokurori i komanduar pranë Këshillit, pjesë e njësisë së mbështetjes së komisioneve.

2. Këshilltari për vlerësimin, nën mbikëqyrjen e relatorit, është përgjegjës, për:

a) mbledhjen e dokumentacionit dhe krijimin e dosjes së vlerësimit;

b) hartimin e raportit analitik;

c) çdo detyrë tjetër të caktuar në ligj dhe në këtë rregullore.

Neni 14
**Fazat e vlerësimit**

Vlerësimi i aftësive drejtuese, organizative dhe të komunikimit të drejtuesit zhvillohet sipas fazave të mëposhtme:

a) veprimet paraprake, të cilat përfshijnë përgatitjen e programit të veçantë të vlerësimit të drejtuesve, caktimin e relatorit dhe të këshilltarit përgjegjës për çdo vlerësim;

b) mbledhja e dokumentacionit dhe krijimi i dosjes së vlerësimit nga këshilltari përgjegjës për vlerësimin nën mbikëqyrjen e relatorit;

c) hartimi i raportit analitik nga këshilltari;

ç) shqyrtimi i plotësimit të procedurave të vlerësimit nga Komisioni;

d) hartimi i projektraportit të vlerësimit nga relatori përkatës;

dh) miratimi i projektraportit të vlerësimit nga Komisioni.

e) miratimi i raportit të vlerësimit nga Këshilli dhe publikimi i ekstrakteve të raportit të vlerësimit dhe të vendimit të vlerësimit.

Neni 15

**Programi i veçantë i vlerësimit të drejtuesve**

1. Komisioni harton projektprogramin e veçantë të vlerësimit të drejtuesve si pjesë të programit të vlerësimit etik dhe profesional të cilin, Këshilli e miraton brenda muajit nëntor të çdo viti. Programi i veçantë i vlerësimit të drejtuesve përmban listën e drejtuesve për të cilët do të kryhet vlerësimi përgjatë vitit në vazhdim, periudhën e vlerësimit dhe, për aq sa është e mundur, planifikimin tremujor të vlerësimeve individuale, duke garantuar një organizim efikas të procedurave të vlerësimit, si dhe lehtësimin e zhvillimit të shortit.

2. Në përgatitjen e projektprogramit, Komisioni mbështetet nga njësia e burimeve njerëzore. Kjo njësi, brenda muajit shtator, i paraqet Komisionit listën emërore të drejtuesve, të përditësuar me të dhënat e mëposhtme:

a) kohën(datën/muajin/vitin) e caktimit/zgjedhjes së drejtuesit dhe prokurorinë përkatëse;

b) vlerësimet e mëparshme si drejtues nëse ka duke përcaktuar periudhën e këtyre vlerësimeve;

c) çdo të dhënë tjetër që Komisioni e vlerëson të nevojshme për qëllim të hartimit të programit.

3. Projektprogrami hartohet, bazuar në parimin e kryerjes së vlerësimit të aftësive drejtuese, organizative dhe të komunikimit të drejtuesve në kohën e duhur. Lista e drejtuesve përfshin detyrimisht të gjithë drejtuesit e prokurorive, të cilëve u përfundon mandati në vitin në vazhdim, duke përllogaritur detyrimin ligjor që veprimtaria e drejtuesit të vlerësohet nga Këshilli të paktën 6 (gjashtë) muaj para përfundimit të mandatit.

4. Programi i veçantë i vlerësimit të drejtuesve është pjesë e programit të vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

5. Brenda muajit janar, drejtuesit e prokurorive dërgojnë në Këshill të dhënat statistikore sipas formës standarde të parashikuar në aneksin nr. 2, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

Neni 16

**Caktimi i relatorit dhe këshilltarit për vlerësimin**

1. Bazuar në listën e drejtuesve të miratuar në programin e veçantë të vlerësimit të drejtuesve, në mbledhje plenare, Këshilli cakton me short relatorin dhe këshilltarin përgjegjës për çdo vlerësim, duke mbajtur parasysh, për aq sa është e mundur, barazinë e shpërndarjes së punës. Për shkak të ngarkesës së punës dhe kur Komisioni e çmon të nevojshme, në shortin për zgjedhjen e relatorit përfshihen edhe anëtarët zëvendësues.

2. Relatori, brenda tri ditëve nga caktimi i tij, i njofton drejtuesit që vlerësohet fillimin e procedurës së vlerësimit, emrin e këshilltarit përgjegjës për vlerësimin, si dhe të drejtën për të kërkuar përjashtimin e tyre.

3. Drejtuesi subjekt vlerësimi ka të drejtë të kërkojë përjashtimin e relatorit apo të këshilltarit përgjegjës për vlerësimin, jo më vonë se 3 (tri) ditë nga marrja dijeni e shkakut të përjashtimit, duke shoqëruar kërkesën, kur është rasti, me aktet provuese të shkakut të përjashtimit. Këtë të drejtë, drejtuesi subjekt vlerësimi, e ka edhe ndaj çdo anëtari tjetër të Këshillit.

4. Këshilli vendos lidhur me kërkesën e drejtuesit subjekt vlerësimi për përjashtimin e relatorit të çështjes dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit apo të këshilltarit përgjegjës për vlerësimin, jo më vonë së 7 (shtatë) ditë nga paraqitja e saj. Nëse relatori i çështjes ose këshilltari përgjegjës për vlerësimin përjashtohet, Këshilli zhvillon menjëherë procedurat e shortit për ricaktimin e relatorit ose këshilltarit përgjegjës për vlerësimin.

Neni 17

**Procedura e vlerësimit për drejtuesit**

1. Drejtuesi i prokurorisë i paraqet Komisionit vlerësimin e kryer prej tij dhe çdo burim të përshtatshëm të vlerësimit të tij në Këshill, brenda tri javëve nga data e marrjes së njoftimit, sipas nenit 85 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar.

2. Në procedurën e vlerësimit të veprimtarisë së drejtuesit nuk zbatohen nenet 86, pika 2, 87, 88, pika 2, 90, pika 1, dhe 91 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar.

Neni 18

**Përmbajtja e formularit të vlerësimit të drejtuesit**

1. Formulari i vlerësimit të drejtuesit përmban vetëvlerësimin e drejtuesit. Formati standard i "Formularit të vlerësimit të drejtuesit" përcaktohet në aneksin nr. 2, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

2. Formulari i vlerësimit të drejtuesit plotësohet në rubrikat përkatëse nga drejtuesi i prokurorisë, në zbatim të nenit 86, pika 1 të ligjit për statusin.

3. Formulari i vlerësimit të drejtuesit është pjesë e akteve të vlerësimit dhe përbën burim vlerësimi, në kuptim të nenit 82, shkronja "b", të ligjit për statusin.

Neni 19

**Hapat për plotësimin e formularit të vlerësimit të drejtuesit**

1. Brenda 3 (tri) javëve nga marrja e njoftimit të vendimit të Këshillit për fillimin e procesit të vlerësimit drejtuesi plotëson formularin e vlerësimit.

2. Formulari i vlerësimit plotësohet në mënyrë elektronike dhe, pasi printohet, nënshkruhet nga drejtuesi i prokurorisë.

3. Pas plotësimit të formularit të vlerësimit, të parashikuar nga neni 82 i ligjit për statusin, por jo më vonë se 1 (një) muaj nga marrja e njoftimit të vendimit të Këshillit për fillimin e procesit të vlerësimit të aftësive drejtuese, drejtuesi i prokurorisë dërgon pranë Këshillit, në format elektronik dhe shkresor, formularin e vlerësimit të drejtuesit bashkë me të dhënat statistikore të funksionimit të prokurorisë në pesë vitet e fundit dhe të gjitha aktet e tjera të përcaktuara në nenin 82 të ligjit për statusin dhe aktet e tjera të përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 20

**Vetëvlerësimi i drejtuesit**

1. Drejtuesi vetëvlerësohet sipas dy grup-kritereve të vlerësimit: aftësitë drejtuese dhe organizative dhe aftësitë komunikuese, të parashikuara në ligjin për statusin, duke përzgjedhur vetëm njërën nga shkallët e aftësisë për çdo tregues vlerësimi, të përcaktuara në formularin e vlerësimit.

2. Drejtuesi, në vetëvlerësimin e tij:

a) vlerëson aktivitetin si drejtues përkundrejt kritereve vlerësuese;

b) paraqet një analizë të të dhënave statistikore të prokurorisë për periudhën si drejtues dhe duke i krahasuar me të dhënat statistikore të periudhës para, vlerëson nivelin e performancës së prokurorisë për periudhën si drejtues;

c) përshkruan masat që ka ndërmarrë për përmbushjen e objektivave të përcaktuar në platformën e paraqitur prej tij në konkurrimin si drejtues;

ç) përshkruan shkallën në të cilën janë përmbushur këta objektiva, duke dhënë edhe shpjegimin përkatës;

d) përshkruan objektivat për mandatin e dytë, nëse do të kërkojë një të tillë;

dh) si dhe çdo tregues tjetër që ai mendon se ndikon në vlerësimin e tij si drejtues.

Neni 21

**Dosja e vlerësimit**

1. Relatori, brenda një jave nga paraqitja e vlerësimit prej drejtuesit, merr masat për krijimin e dosjes së vlerësimit. Drejtuesi ka të drejtë, në çdo kohë, të marrë kopje apo ekstrakte të akteve të përditësuara.

2. Në dosjen e vlerësimit të drejtuesit, veç akteve dhe informacioneve të parashikuara në nenin 82 të ligjit për statusin, përfshihen dhe informacione nga institucione të tjera audituese ose kontrolluese, të cilat kërkohen kur çmohet e nevojshme, si dhe aktet e tjera të përcaktuara në këtë rregullore.

3. Brenda dy javëve nga krijimi i dosjes së vlerësimit, këshilltari përgjegjës për vlerësimin, nën mbikëqyrjen e relatorit, harton raportin analitik sipas formatit standard të përcaktuar në aneksin nr. 5, bashkëlidhur rregullores. Raporti analitik përmban listën e akteve të mbledhura në procesin e vlerësimit, si dhe analizon në mënyrë të detajuar dhe të strukturuar të dhënat nga aktet e dosjes së vlerësimit.

Neni 22

**Hartimi i projektraportit të vlerësimit**

1. Brenda një muaji nga krijimi i dosjes së vlerësimit dhe pasi Komisioni i ka vlerësuar të plota procedurat, relatori harton projektraportin e vlerësimit të aftësive drejtuese dhe organizative dhe të aftësive komunikuese të drejtuesit, sipas formës standarde të miratuar nga Këshilli.

2. Projektraporti i hartuar nga relatori diskutohet dhe miratohet në Komision.

3. Në hartimin e projekt raportit, relatori analizon të gjitha të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të përcaktuara në nenin 82 të ligjit për statusin dhe nga aktet e përcaktuara në këtë rregullore.

4. Projektraporti i vlerësimit përmban:

a) të dhënat personale të drejtuesit, si: arsimimi, vjetërsia, nivelet e mëparshme të vlerësimit (nëse ka pasur si drejtues), si dhe informacion të përgjithshëm për periudhën në të cilën bëhet vlerësimi, prokurorinë ku ka qenë drejtues në periudhën në të cilën bëhet vlerësimi, dhe për masat disiplinore që janë dhënë ndaj tij për shkak të pozicionit të drejtuesit të dhëna gjatë periudhës së vlerësimit, pavarësisht nëse masa disiplinore është shuar apo jo;

b) të dhënat e marra nga burimet e vlerësimit dhe analiza e tyre, për vlerësimin e veprimtarisë si drejtues, sipas kritereve të vlerësimit;

c) propozimin për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi dhe nivelin e përgjithshëm të vlerësimit;

5. Projektraporti i miratuar nga Komisioni i njoftohet drejtuesit, i cili informohet për të drejtën për të aksesuar dosjen e vlerësimit dhe për ta kundërshtuar atë me shkrim brenda dy javëve nga data e marrjes së njoftimit, sipas nenit 94 të ligjit për statusin.

6. Drejtuesi ka të drejtë të dëgjohet nga Këshilli në mbledhjen plenare, në të cilën do të shqyrtohet projektraporti i vlerësimit.

7. Projektraporti i vlerësimit është pjesë përbërëse e dosjes së vlerësimit.

Neni 23

**Projektraporti i vlerësimit dhe vendimi i Këshillit**

1. Projektraporti i vlerësimit i përcillet për shqyrtim mbledhjes plenare të Këshillit, nga relatori. Si rregull, çështja përfshihet në rendin e ditës së mbledhjes së radhës së Këshillit.

2. Çdo anëtar i Këshillit ka akses në dosjen e vlerësimit. Në rast se, ndonjë nga anëtarët e Këshillit ka mendim ndryshe nga relatori, paraqet mendimin e tij të arsyetuar, duke bërë edhe propozimet konkrete, para vendimmarrjes së Këshillit.

3. Këshilli zhvillon seancën dëgjimore në prani të drejtuesit subjekt vlerësimi, si dhe personave të tjerë, nëse kjo kërkohet nga drejtuesi ose nëse kjo është e nevojshme për të sqaruar faktet.

4. Nëse drejtuesi nuk ka kërkuar të dëgjohet nga Këshilli, çështja shqyrtohet bazuar në relatimin e çështjes nga relatori, i cili u përgjigjet edhe pyetjeve eventuale nga anëtarët e Këshillit.

5. Nëse drejtuesi ka kërkuar të dëgjohet, çështja shqyrtohet bazuar në relatimin e çështjes nga relatori dhe në shpjegimet e drejtuesit, i cili, gjatë dëgjesës, nuk duhet të përsërisë përmbajtjen e paraqitur në kundërshtimin me shkrim.

6. Çdo anëtar i Këshillit mund të bëjë pyetje për relatorin dhe drejtuesin subjekt vlerësimi.

7. Këshilli urdhëron shtyrjen e seancës për jo më shumë se 30 ditë, nëse gjatë shqyrtimit të projektraportit të vlerësimit konstatohen gabime procedurale ose materiale, ose nëse nevojiten prova të tjera që mund të ndikojnë në nivelin e vlerësimit; dhe korrigjimi i këtyre gabimeve nuk mund të bëhet menjëherë, për shkak të nevojës për të marrë dokumente të tjera.

8. Këshilli, pasi shqyrton projektraportin e vlerësimit dhe duke u bazuar në përfundimet e seancës dëgjimore, pasi dëgjon mendimet ndryshe të anëtarëve të Këshillit, nëse ka, vendos të miratojë, me ndryshime ose të kërkojë hartimin e një projektraportit të ri të vlerësimit, nga anëtari relator.

9. Në rastet, kur Këshilli e vlerëson drejtuesin me një nivel të ndryshëm ose bën një arsyetim të ndryshëm nga ai i propozuar në projektraportin e vlerësimit, në vendim pasqyrohen arsyet përkatëse. Raporti i vlerësimit që miratohet nga Këshilli është pjesë përbërëse e vendimit.

## KREU III
## PËRFUNDIMI I VLERËSIMIT

### Neni 24
### **E drejta e ankimit**

1. Kundër vendimit të Këshillit, drejtuesi ka të drejtën e ankimit vetëm për shkelje të rënda procedurale.

2. Ankimi paraqitet në Gjykatën e Apelit Administrativ, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar të Këshillit.

### Neni 25
### **Efektet e vlerësimit të drejtuesit**

1. Në rastin, kur drejtuesi vlerësohet "Mjaftueshëm", Këshilli nis procedurat për mbarimin e mandatit të tij dhe hapjen e garës për këtë pozicion.

2. Në rastin, kur drejtuesi vlerësohet "Mjaftueshëm" dhe Këshilli konstaton se në ushtrimin e funksionit si drejtues, nga ana e drejtuesit në vlerësim janë konsumuar shkelje disiplinore të parashikuara në nenin 102, germat "f", "g", "gj", "i", "k", "l", "ll", "m", "n", "nj", "o" dhe "p", të ligjit për statusin, raporti i vlerësimit i dërgohet Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë.

### Neni 26
### **Arkivimi i dosjes së vlerësimit**

1. Kur vlerësimi i drejtuesit bëhet përfundimtar, rezultati i vlerësimit përfshihet në dosjen personale të prokurorit.

2. Dosja e vlerësimit arkivohet sipas rregullave të përgjithshme për arkivimin e akteve të Këshillit.

## KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT DHE TRANZITORE

Neni 27
**Përfundimi i procedurës pa vendim përfundimtar**

Kur Këshilli vendos mbarimin e statusit të një prokurori i cili është caktuar si drejtues i prokurorisë, për veprimtarinë e të cilit ka filluar vlerësimi i aftësive drejtuese, deklarohet përfundimi i procedurës së vlerësimit pa vendim përfundimtar.[8]

Neni 28
**Dispozita kalimtare**

1. Marrja e mandatit si drejtues i prokurorisë nuk përbën shkak apriori për heqjen dorë apo zëvendësimin nga hetimi i çështjeve që ky prokuror ka në hetim, por mund të zëvendësojë përfaqësimin e tij në gjykim.
2. Rregulli i parashikuar në pikën 1 të këtij neni nuk zbatohet për drejtuesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për shkak të volumit disa herë më të lartë të punës drejtuese dhe organizative.
3. Drejtuesi i prokurorisë mund të kërkojë heqjen ose uljen e ngarkesës në punë apo zvogëlimin e kësaj ngarkese për çështjet që po heton apo përfaqëson në gjykim sipas rregullave të parashikuara në rregulloren përkatëse duke iu drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë, pa ndikuar në shpërblimin e tij financiar si prokuror apo drejtues nëse kërkesa pranohet.[9]

Neni 29
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe botimit të saj në Fletoren Zyrtare.

ANEKSI NR. 1
METODOLOGJIA E PIKËZIMIT ME QËLLIM PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT TË DREJTUESIT TË PROKURORISË SË SHKALLËS SË PARË OSE TË APELIT ME JURIDIKSION TË PËRGJITHSHËM

ANEKSI NR. 2
FORMULARI I VETËVLERËSIMIT TË DREJTUESIT TË PROKURORISË
*Për periudhën 20__ - 20 ___*

ANEKSI NR. 3
TABELA PËR TË DHËNAT STATISTIKORE TË FUNKSIONIMIT TË PROKURORISË
*Për periudhën 20__ - 20 ___*

ANEKSI NR. 4
TABELA PËR NGARKESËN (KALLËZIME PENALE) E PROKURORËVE
*Për periudhën 20__ - 20 ___*

ANEKSI NR. 5

[8] Shiko nenet 63–67 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
[9] Shiko nenin 26 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

AKTET E DREJTUESIT TË PROKURORISË PËR VLERËSIMIN E AFTËSIVE DREJTUESE
*Për periudhën 20____ - 20_____*

ANEKSI NR. 6
RAPORTI ANALITIK I VLERËSIMIT TË DREJTUESIT TË PROKURORISË
*Për periudhën 20__ - 20 ___*

ANEKSI NR. 7
PROJEKTRAPORT I VLERËSIMIT TË AFTËSIVE DREJTUESE DHE ORGANIZATIVE DHE AFTËSIVE TË KOMUNIKIMIT TË DREJTUESIT TË PROKURORISË
*Për periudhën 20__ - 20 ___*

**ANEKSI nr. 1**

**METODOLOGJIA E PIKËZIMIT ME QËLLIM PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT TË DREJTUESIT TË PROKURORISË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM**

1. Metodologjia e pikëzimit ka për qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të drejtuesit të Prokurorisë të Juridiksionit të Përgjithshëm, për secilin kriter dhe treguesit përkatës ligjorë, mbi bazën e një sistemi pikësh të përcaktuar mbi meritokracinë, profesionalizmin, kualifikimin, aftësinë drejtuese, organizative, komunikuese, efektivitetin në vendimmarrje me synim përmirësimin e vazhdueshëm të performancës, integritetit, llogaridhënies dhe eficencës së sistemit të prokurorisë.
2. Metodologjia e pikëzimit është pjesë përbërëse e "*Skemës së Vlerësimit*", sipas përcaktimeve të nenit 2 shkronja "*ll*" të ligjit nr. 96/2016 "*Për Statusin e gjyqtareve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.*
3. Me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të drejtuesit të prokurorisë të juridiksionit të përgjithshëm, pikëzimi bëhet duke u bazuar në kriteret e posaçme të parashikuar në nenet 68-97 të Ligjit për Statusin. Në procedurën e vlerësimit të veprimtarisë së kryetarit nuk zbatohen nenet 86, pika 2, 87, 88, pika 2, 90, pika 1, dhe 91 të këtij ligji.
4. Vlerësimi për secilin kriter matet duke u bazuar në treguesit e përcaktuar në mënyrë eksplicite nga ligji. Për aq sa ligji e lejon, përcaktimi i indikatorëve (nëntreguesve) shtesë të çdo treguesi vlerësues për secilin kriter dhe pesha specifike e tyre, të parashikuar në këtë rregullore, bëhet në tabelën e pikëzimit, pjesë e kësaj metodologjie, duke u bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi, në aktet nënligjore, në standardet ndërkombëtare, si dhe në praktikat më të mira.
5. Vlerësimi i drejtuesit të prokurorisë kryhet sipas kritereve të mëposhtme:
   a) aftësitë drejtuese dhe organizative;
   b) aftësitë e komunikimit.
6. Vlerësimi i drejtuesit të prokurorisë kryhet sipas këtyre niveleve:
   a) Vlerësimi "Shumë mirë", jepet në rastin e veprimtarisë drejtuese me cilësi mbi mesataren;
   b) Vlerësimi "Mirë", jepet në rastin e veprimtarisë drejtuese me cilësi mesatare;
   c) Vlerësimi "Mjaftueshëm", jepet në rastin e veprimtarisë drejtuese nën mesatare.
7. Vlerësimi i përgjithshëm "shumë mirë" jepet nëse veprimtaria drejtuese e kryetarit vlerësohet "shumë mirë" në të dyja kriteret.
8. Vlerësimi i përgjithshëm "mjaftueshëm" jepet nëse veprimtaria drejtuese e drejtuesit vlerësohet "mjaftueshëm", të paktën në një prej kritereve. Në rastet e tjera, veprimtaria drejtuese e kryetarit vlerësohet "mirë"
9. Niveli i vlerësimit të drejtuesit përcaktohet për çdonjërin nga dy kriteret e vlerësimit.
10. Shkalla/cilësia e veprimtarisë drejtuese përcaktohet për secilin nënkriter (indikator) dhe për çdonjërin nga dy kriteret e vlerësimit mbi bazën e një shkalle pikëzimi nga 1 deri në 100 pikë.

11. Brenda çdo kriteri vlerësimi bëhet ndarja e pikëve sipas rëndësisë së çdo treguesi vlerësimi duke shmangur përfundime që nuk janë përgjegjësi e drejtuesit të prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm.
12. Në tabelën e pikëzimit përcaktohet ndarja e kritereve të vlerësimit, lista e aspekteve të çdo kriteri, treguesit e vlerësimit dhe pikëzimi i tyre sipas nivelit, në funksion të pikëzimit dhe të vlerësimit final të drejtuesit të prokurorisë.

**1. AFTËSITË DREJTUESE DHE ORGANIZATIVE(100 pikë)**

A. Mirorganizimin e prokurorisë në seksione; (20 pikë);
B. Planifikimin e prokurorëve për çështje të natyrës urgjente (10 pikë);
C. Zëvendësimin në kohë të prokurorëve që kanë pengesa në proces (10 pikë):
Ç. Zhvillimin e mbledhjeve tematike për prokurorët (10 pikë);
D. Planifikimin dhe përdorimin efikas të fondeve publike, sipas nevojave të prokurorisë (10 pikë);
E. Mbikëqyrjen për efekt të përmirësimit të informacionit në faqen zyrtare të prokurorisë (10 pikë);
F. Mbikëqyrjen për krijimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori në përputhje me nevojat e palëve e të publikut (10 pikë);
G. Kujdeset për çështjet e ruajtjes dhe të sigurisë në prokurori (10 pikë);
H. Organizimin e trajnimeve për prokurorët dhe punonjësit e prokurorisë (10 pikë).

**2. AFTËSITË KOMUNIKUESE (100 PIKË)**

A. Bashkëpunimin efektiv dhe në kohë me Këshillin, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Ministrinë e Drejtësisë, Kontrollin e Lartë të Shtetit ose me çdo institucion tjetër mbikëqyrjeje ose auditi (50 pikë);
B. Komunikimin me publikun dhe të tretët, duke caktuar saktësisht oraret për pritjen e publikut, dokumentacionin e takimeve ose të shkresave për t'iu përgjigjur institucioneve të ndryshme (50 pikë).

## I. AFTËSITË DREJTUESE DHE ORGANIZATIVE(100 pikë)

Për të pikëzuar aftësitë drejtuese dhe organizative të drejtuesit të prokurorisë, vlerësuesi përqendrohet në dosjen personale, vlerësimi i kryer nga drejtuesi, raportet vjetore, raporti përkatës i përfaqësuesit të Këshillit, duke përfshirë edhe regjistrimin audio, çdo urdhër ose vendim i drejtuesit i nxjerrë në ushtrim të kompetencave për organizimin e prokurorisë ose të administratës të prokurorisë, të dhëna statistikore për funksionimin e prokurorisë në pesë vitet e fundit, raportet e inspektimit të prokurorisë nga institucionet shtetërore, çdo dokument i cili tregon aftësitë e komunikimit të drejtuesit me publikun dhe të tretët, mendimi i dhomës vendore të avokatisë dhe të kryetarit të gjykatës ku ushtron funksionin drejtuesi i prokurorisë, informacion me shkrim nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera që vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e drejtuesit në veprimtari trajnuese për drejtimin dhe organizimin e prokurorisë, të dhëna për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj drejtuesit në këtë cilësi, gjatë periudhës së vlerësimit, vendime përfundimtare për masa disiplinore,

mendimi i Prokurorit të Përgjithshëm për performancën e prokurorisë për periudhën e vlerësimit, raportimet vjetore të Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvendin e Shqipërisë, mendimi i Prokurorit të Përgjithshëm për funksionimin e policisë gjyqësore në atë prokurori për periudhën e vlerësimit dhe për organizimin dhe funksionimin administrativ të prokurorisë.

Vlerësuesi çmon aftësitë e drejtuesit për organizimin e qartë të veprimtarive administrative, nëpërmjet dhënies së vendimeve dhe urdhrave për të siguruar respektimin e afateve dhe përdorimin sa më të mirë të burimeve të disponueshme, si dhe aksesin dhe transparencën në prokurori.

**A. Mirorganizimin e prokurorisë në seksione; (20 pikë)**

1. Marrja e masave për ngritjen e seksioneve bazuar ndër të tjera në mendimin e mbledhjes së përgjithshme, në numrin dhe specializimin e prokurorëve, llojin, përhapjen dhe kategoritë e veprave penale, subjekteve, si dhe në rekomandimet e Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit[1] (1 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[2]:*
   - *Respektimi i procedurës ligjore për ngritjen e seksioneve dhe caktimin e drejtuesve të tyre;*
   - *Përcaktimi i prokuroreve në seksion në përshtatje me specializimet e tyre;*
   - *Patundshmëria e lëvizjes nga seksioni.)*
2. Organizimi i punës dhe marrja e masave të nevojshme për mirëfunksionimin e prokurorisë në tërësi, duke respektuar më rigorozitet parashikimet ligjore, duke siguruar paanshmërinë, pavarësinë dhe efikasitetin e punës së prokurorisë[3] (1 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[4]:*
   - *Respektimi i parashikimeve ligjore dhe nënligjore për organizmin e punës dhe funksionimin e prokurorisë në tërësi;*
   - *Miratimi i rregulloreve, urdhrave, udhëzimeve të brendshme për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë;*
   - *Mbarëvajtja e punës dhe marrjen e masave dhe veprimeve për të siguruar efikasitetin dhe ligjshmërinë e veprimtarisë së prokurorisë që drejton.)*
3. Organizimi i shpërndarjes së çështjeve prokurorëve, bazuar në kritere objektive dhe transparente, në përputhje me ligjin[5], si dhe sigurimi i përdorimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve në prokurori[6] (1 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[7]:*
   - *Respektimi i parashikimeve ligjore dhe nënligjore për shpërndarjen e çështjeve me short prokurorëve;*

---

[1] Shih nenin 21 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[2] Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[3] Shih nenin 42/a të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[4] Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[5] Shih nenin 42/c të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[6] Shih nenin 42/h të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[7] Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

- *Normimi i aspekteve procedurale për organizmin dhe funksionimin e shpërndarjes së çështjeve me short, duke përcaktuar personat kompetent, (përshkruar detyrat e secilit prej tyre) dhe procedurën që ndiqet;*
- *Shpërndarja e ngarkesës në mënyrë të barabartë;*
- *Marrja e masave për të siguruar përdorimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve në prokurori, duke bashkërenduar me Prokurorin e Përgjithshëm;*
- *Përdorimi në çdo rast i shortit elektronik, dhe vetëm në raste përjashtimore të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore atë manual;*
- *Zbatimi i këtyre parashikimeve ligjore dhe nënligjore edhe në rastin e ushtrimit të ndjekjes penale nga drejtuesi i prokurorisë;*
- *Marrja e masave administrative për monitorimin e përditësimit të sistemeve elektronike PRESTO dhe SVHOPOW, saktësisë së të dhënave.*

4. Mbikëqyrja dhe sigurimi i organizimit dhe funksionimit të administratës së prokurorisë[1], përpilimi i projektvendimit të vlerësimit, projektraportit të vlerësimit, së bashku me vetëvlerësimin, si dhe marrja e mendimit me shkrim të të gjithë mbikëqyrësve për vlerësimin e nëpunësve civil.[2] (1 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[3]:*
   - *Respektimi i parashikimeve ligjore dhe nënligjore për mënyrën e organizmit dhe funksionimit të administratës së prokurorisë;*
   - *Normimi i aspekteve procedurale për organizmin dhe funksionimin e administratës, duke përcaktuar personat kompetent, përshkruar detyrat e secilit prej tyre dhe procedurën që ndiqet, dhe mënyrën e bashkëpunimit të sektorëve me njëri-tjetrin;*
   - *Normimi i aspekteve procedurale të mbikëqyrjes periodikisht, duke përcaktuar personat kompetent, detyrat e tyre, mënyrën e mbikëqyrjes dhe adresimin, zgjidhja e problematikave të konstatuara, si dhe vlerësimi i performacës së tyre me objektivitet...".*
5. Drejtimi, bashkërendimi, mbikëqyrja dhe sigurimi i veprimtarisë së Policisë Gjyqësore, dhënia e urdhrave të detyrueshëm lidhur me ushtrimin e funksioneve, dhe përpilimi i raportit të vlerësimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore[4](1 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[5]:*
   - *Respektimi i parashikimeve ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe funksionimin e seksioneve të policisë gjyqësore në prokurori;*
   - *Normimi i aspekteve procedurale-administrative të ushtrimit të veprimtarisë së seksionit të policisë gjyqësore;*
   - *Respektimi i procedurës ligjore për caktimin e tyre në seksione në përshtatje me specializimet e tyre, si dhe patundshmëria e lëvizjes nga seksioni;*
   - *Shpërndarja e ngarkesës në mënyrë të barabartë;*

[1]Shih nenin 42/f të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[2] Shih nenin 85 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[3]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[4]Shih nenin 42/gj të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[5]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

- *Drejtimi dhe bashkërendimi i veprimtarisë së shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit, si dhe shërbimeve të tjera të Policisë Gjyqësore;*
- *Marrja e masave për mbikëqyrjen periodike të ushtrimit të veprimtarisë së policisë gjyqësore, adresimi dhe zgjidhja e problematikave, si dhe vlerësimi i performancës së tyre me objektivitet;*
- *Marrja e informacionit për veprimtarinë dhe etikën e oficerit të Policisë Gjyqësore, si dhe të dhëna statistikore për volumin e punës, shpejtësinë, cilësinë e akteve dhe problematikat e konstatuara në kryerjen e hetimeve.)*

6. Mbikëqyrja e disiplinës në punë, respektimit të etikës të prokurorit, planifikimin e punës së tyre, si dhe përmbushja e angazhimeve ligjore për vlerësimin profesional të prokurorëve[1] (1 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[2]:*
   - *Mbikëqyrja e disiplinës në punës, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre;*
   - *Mbikëqyrja e respektimit të standardeve të etikës dhe rregullat e sjelljes nga prokurorët. Evidentimi i problematikave dhe adresimi i rasteve;*
   - *Planifikimi i punës së prokurorëve, në përputhje me planin strategjik të institucionit, të Prokurorisë së Përgjithshme, rekomandimet e Këshillit të Ministrave, rezolutës së Kuvendit;*
   - *Marrja e masave për përmbushjen e angazhimeve ligjore për vlerësimin profesional, në bashkërendim më Këshillin;*
   - *Objektiviteti dhe saktësia në dhënien e mendimit për veprimtarinë e magjistratit dhe vlerësimi i tij për këtë veprimtari, sipas kritereve të vlerësimit, duke u bazuar në nivelet e vlerësimit;*
   - *Normimi i aspekteve administrative procedurale lidhur me paraqitjen, trajtimin dhe kthimin e përgjigjes për ankesat e bëra nga persona fizikë ose juridikë, ose një informacioni i lidhur me problematika të konstatuara nga ushtrimi i veprimtarisë së prokurorisë).*
7. Garantimi i zbatimit korrekt të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm[3] (1 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[4]:*
   - *Marrja e masave për njohjen e udhëzimeve nga prokurorët;*
   - *Analizimi dhe diskutimi i tyre në mbledhjen e prokurorëve;*
   - *Marrja e masave për zbatimin e tyre në përshtatje me organizmin dhe funksionimin e prokurorisë që drejton;*
   - *Verifikimi i zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.)*

[1]Shih nenin 42/k të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[2]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[3]shih nenin 43/dh të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[4]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

8. Kërkimi i informacionit për ecurinë e procedimeve[1], verifikimi i ecurisë dhe përfundimit të çështjeve[2] (1 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[3]:*
   - *Qëndrimi proaktiv në përmbushjen e detyrës nëpërmjet kërkimit të informacionit për ecurinë e procedimeve konkrete, në varësi të karakterit sensitiv të veprës penale, rëndësisë së çështjes. Pas shqyrtimit të informacionit, shprehja e qëndrimi të tij me anë të udhëzimeve me shkrim, si dhe ndjekja e zbatimit të tyre për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit. Përjashtimisht, kur rrethanat nuk e lejojnë, udhëzimet mund të jepen verbalisht dhe, brenda një kohe të arsyeshme, të konfirmohen me shkrim;*
   - *Verifikimi periodik i ecurisë dhe përfundimit të çështjeve në funksion të respektimit të afateve procedurale ligjore. Analiza e problematikave të konstatuara dhe adresimi i tyre. Ndjekja në vijimësi e tyre. Nxjerrja e udhëzimeve për kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale përpara se, të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake.)*
9. Nxjerrja udhëzimeve të përgjithshme të natyrës administrative ose procedurale dhe udhëzimeve për çështje konkrete për prokurorët e prokurorisë përkatëse[4] (1 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[5]:*
   - *Nxjerrja e udhëzimeve të përgjithshme për çështje të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë, të karakterit administrativ;*
   - *Nxjerrja e udhëzimeve procedurale penale, apo lidhur me zbatimin e ligjit penal material, me qëllim unifikimin e praktikave brenda prokurorisë, ndjekja e zhvillimeve të legjislacioni, apo jurisprudencës, apo aplikimi i praktikave më të mira;*
   - *Nxjerrja e udhëzimeve jo të detyrueshme me shkrim, të arsyetuara, të qarta për çështje konkrete. Ndjekja e zbatimit të tyre, si dhe efektiviteti i tyre.)*
10. Marrja e masave administrativo-procedurale, miratimi i udhëzimeve të përgjithshme dhe planit të veprimit për të siguruar zbatimin e rekomandimeve prioritare[6]. (1 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[7]:*
   - *Marrja e masave për njohjen, vlerësimin nga prokurorët dhe organizimi i mbledhjes për diskutim dhe dhënie mendimi për masat, aktivitetet dhe mënyrën e zbatimit;*
   - *Miratimi i udhëzimeve të përgjithshme për të lehtësuar zbatimin e udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm. Miratimi i planit të veprimit, në kuadrin e planit të veprimit të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm;*

---

[1]Shih nenin 43/b të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[2]Shih nenin 43/ç të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[3]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[4]Shih nenin46të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[5]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[6]Shih udhëzimin e përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 02 datë 12.05.2023 "Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm".
[7]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

- *Marrja e masave organizative në drejtim të riorganizimit të brendshëm, forcimit të kapaciteteve institucionale e profesionale, monitorimin e zbatimit të tyre;*
- *Informimi në mënyrë periodike i Prokurorisë së Përgjithshme për rezultatet e arritura.)*

11. Marrja e masave procedurale për nxitjen e hetimeve, nga drejtuesi i prokurorisë, apo prokurorët e tjerë në drejtimet prioritare të rekomanduara, duke përfshirë rastet e ndikimit të paligjshëm të brendshëm apo të jashtëm në veprimtarinë e prokurorit, efektiviteti në hetimin e pastrimit të produkteve të veprës penale, ose veprimtarisë kriminale, verifikimin e ecurisë dhe përfundimin e çështjeve për veprat penale prioritare të rekomanduara, duke monitoruar në veçanti, respektimin e afateve procedurale, rritjen e efektivitetit dhe plotshmërisë së hetimeve[1] (1 pikë).

    *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[2]:*
    - *Nxjerrja e udhëzimeve të përgjithshme që sigurojnë zbatimin e rekomandimeve prioritare, garantojnë e lehtësojnë zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm;*
    - *Nxjerrja e udhëzimeve jo të detyrueshme për çështje konkrete, në momentin e caktimit të çështjes për ndjekje, përfshi rastet e regjistruara kryesisht me iniciativën e tij apo të prokurorëve, ose kur vlerësohet e nevojshme për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit në hetimet paraprake ose në fazën e gjykimit, për vepra penale sipas kompetencës lëndore dhe në drejtimet prioritare të rekomanduara;*
    - *Koordinimi i veprimtarisë me prokuroritë e tjera për çështje konkrete që lidhen me fushat/drejtimet prioritare të rekomanduara;*
    - *Kërkimi i informacionit dhe verifikimi për ecurinë/përfundimin e procedimeve në hetimet paraprake ose në gjykim, për veprat penale prioritare të rekomanduara sipas ligjit dhe në kuadrin e forcimit të mekanizmit të kontrollit dhe llogaridhënies së prokurorit, duke garantuar paanshmërinë).*

12. Përgatitja dhe saktësia e të dhënave të raportit vjetor mbi ecurinë e punës në prokurorinë përkatëse përgjatë vitit paraardhës[3] (1 pikë).

    *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[4]:*
    - *Përgatitja e raportit vjetor sipas modelit të miratuar nga Prokuroria e Përgjithshme. Cilësia dhe detajimi i përmbajtjes së raportit;*
    - *Verifikimi i saktësisë së të dhënave të paraqitura në raport;*
    - *Kryerja e analizave të detajuara të temave, çështjeve, apo nënçështjeve, Nxjerrja e përfundimeve, evidentimi i problematikave).*

13. Mbikëqyrja tematike, për grupvepra, ose seksione pranë prokurorisë, të cilat nga raportet dhe analizat e kryera, rezultojnë problematike në drejtim të efiçencës për

---
[1]Shih nenin 6 të udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 02 datë 12.05.2023 "Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm".
[2]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[3]Shih nenin 50 tëligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[4]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

kryerjen e hetimeve penale dhe/ose respektimin e kërkesave ligjore procedurale penale[1] (1 pikë).

*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[2]:*

- *Nxjerrja e akteve nënligjore procedurale-administrative për këtë qëllim;*
- *Organizimi i verifikimeve, monitorimeve periodike me tematikë të përcaktuar me qëllim zgjidhjen e problematikave dhe rritjen e efiçencës dhe zbatimin e akteve nënligjore të nxjerra për këtë qëllim;*
- *Organizimi i mbledhjeve të prokurorëve për të analizuar dhe trajtuar rezultatet e arritura;*
- *Informimi periodikisht i Prokurorisë së Përgjithshme për rezultatet e arritura).*

14. Emërimi dhe koordinimi i punës me zëvendësdrejtuesin e prokurorisë dhe drejtuesit e seksioneve[3] (1 pikë).

*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[4]:*

- *Respektimi i procedurës ligjore për emërimin e zëvendësdrejtuesit të prokurorisë dhe drejtuesit e seksioneve;*
- *Normimi i aspekteve procedurale për ushtrimin e detyrave nga zëvendësdrejtuesi i prokurorisë dhe drejtuesi i seksionit në rast mungese dhe me autorizim të drejtuesit, në drejtim të detyrave të ngarkuara dhe përmbushjes së tyre;*
- *Mbikëqyrja e ushtrimit të detyrave nga zëvendësdrejtuesi dhe drejtuesi i seksionit të prokurorisë për funksionimin e prokurorisë, për përfaqësimin e prokurorisë me të tretët, si dhe për detyrat e tjera të përcaktuara në udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm.)*

15. Zhvillimi i mbledhjeve tematike me prokurorët e seksioneve, prokurorët e caktuar për ndjekjen e çështjeve apo me drejtuesit e policisë gjyqësore të seksioneve apo të strukturave hetimore në shërbimet e Policisë Gjyqësore, të caktuar për ecurinë në kryerjen e hetimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara[5] (1 pikë).

*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[6]:*

- *Organizimi i mbledhjeve, takimeve periodike me tematikë me prokurorët e seksioneve, prokurorët e caktuar për ndjekjen e çështjeve. Dokumentimi i këtyre mbledhjeve. Rëndësia e çështjeve të ngritura, përfundimet e arritura, masat e marra dhe efiktiviteti i tyre;*
- *Organizimi i mbledhjeve, takimeve periodike me tematikë me drejtuesit e policisë gjyqësore të seksioneve apo të strukturave hetimore në shërbimet e Policisë Gjyqësore të caktuar. Dokumentimi i këtyre mbledhjeve. Rëndësia e*

---

[1]Shih nenin 8 të udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 10/2021 "Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore".
[2]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[3]Shih nenin44/4 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[4]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[5]Shih nenin 6 të udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 02 datë 12.05.2023 "Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm".
[6]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

*çështjeve të ngritura, përfundimet e arritura, masat e marra dhe efektiviteti i tyre).*

16. Mbikëqyrja periodike e veprimtarisë së prokurorisë, edhe nëpërmjet analizës së treguesve të gjendjes së kriminalitetit, mbarëvajtjes së punës, efiçencës dhe efektivitetit në ushtrimin e ndjekjes penale sipas prioriteteve te rekomanduara, si dhe vlerësimit të performancës së prokurorisë që drejton[1] (1 pikë).

    *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[2]:*
    - *Normimi i aspekteve procedurale-administrative lidhur me realizimin e analizës së treguesve të gjendjes së kriminalitetit. Përcaktimi i personave kompetent, i detyrave dhe përgjegjësive;*
    - *Normimi i aspekteve procedurale-administrative për realizimin e mbikëqyrjes së mbarëvajtjes së punës, efiçencës dhe efektivitetit në ushtrimin e ndjekjes penale sipas prioriteteve të rekomanduara, si dhe vlerësimit të performancës së prokurorisë që drejton;*
    - *Organizimi i mbledhjes së prokurorëve për të diskutuar mbi rezultatet e analizës dhe mbikëqyrjes, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre).*

17. Konstatimin, vlerësimin dhe verifikimin e shkeljeve individuale të evidentuara nga veprimtaria mbikëqyrëse, ose nga informacione, apo ankesa të ardhura në prokurori[3] (1 pikë).

    *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[4]:*
    - *Konstatimi në kohë i problematikave gjatë veprimtarisë mbikëqyrëse, procedurat e ndjekura për vlerësimin, verifikimin e rasteve të evidentuara, dokumentimin e tyre, si dhe masat e marra;*
    - *Trajtimi i shkeljeve disiplinore, duke përmbushur procedurat dhe kriteret ligjore).*

18. Organizimi dhe koordinimi i veprimtarisë për të mbështetur viktimat e krimit, nxitja e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me organizatat e shoqërisë civile në kryerjen e trajnimeve, hartimin e protokolleve, strategjive dhe trajtimin e rasteve, në veçanti ku përfshihen viktimat e dhunës me bazë gjinore, me bazë urrejtje, trafikimit, krimeve seksuale[5](1 pikë).

    *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[6]:*
    - *Marrja e masave organizative për të ofruar mbështetje efektive viktimave të krimit. Rregullimi me akte nënligjore i aspekteve procedurale dhe administrative;*

---

[1]Shih nenin 6 të udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 10/2021 "Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore".

[2]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

[3]Shih nenin 5 të udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 10/2021 "Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore".

[4]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

[5]Shih nenin 16 të udhëzimit e përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 17 datë 23.12.2020 "Për heitmin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje, dhunës me baze urrejtjeje".

[6]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

- *Ndërmarrja e nismave konkrete për të vendosur dhe forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe me organizatat e shoqërisë civile;*
- *Hartimi i protokolleve dhe strategjive për trajtimin e rasteve;*
- *Monitorimi i zbatimit të tyre).*

19. Marrja e masave për nxitjen e hetimit kryesisht nga drejtuesi i prokurorisë, apo prokurorët e tjerë në drejtimet prioritare të rekomanduara (1 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[1]:*
- *Normimi i aspekteve procedurale-administrative për fillimin e hetimit kryesisht nga prokurori, apo drejtuesi i prokurorisë;*
- *Marrja e masave për nxitjen e prokurorëve në fillimin e hetimeve kryesisht;*
- *Ndjekja e ecurisë së procedimeve të filluara kryesisht;*
- *Organizimi i mbledhjeve të prokurorëve për të analizuar problematikat e vërejtura gjatë ecurisë së këtyre procedimeve dhe zgjidhja e tyre.*

20. Cilësia e vendimmarrjes sipas standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira (1 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[2]:*
- *Aftësitë hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave;*
- *Aftësia për të interpretuar ligjin. Aftësia për të interpretuar ligjin e identifikuar, arsyetimi i tij për mënyrën e zbatimit të ligjit mbi çështjet konkrete për trajtim, apo pasqyrimi dhe/ose analizimi i të dhënave në zbatim dhe në përputhje me ligjin e identifikuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;*
- *Aftësia për të zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale që kanë lidhje me interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjes për trajtim, në përpunimin e akteve dhe dokumenteve ligjorë, dhe/ose në arsyetimet me shkrim ose verbale, sipas rastit;*
- *Për aq sa është e mundur, aftësia për të analizuar jurisprudencën, praktikat më të mira, standardet ndërkombëtare, duke u përqendruar tek aftësia për të kërkuar, identifikuar, organizuar dhe përdorur jurisprudencën relevante për një çështje të caktuar, në mbështetje të një interpretimi të caktuar;*
- *Aftësia për të hartuar akte nënligjore. Zbatimi i teknikës legjislative. Qartësia, konçiziteti dhe kuptueshmëria. Përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës; Aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë; Zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës; Përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), paragrafëve dhe e strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin; Përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë).*

[1]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[2]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

| Shkalla e aftësisë së drejtuesit | Nr. i pikëve |
|---|---|
| Nën mesataren | 5 - 9 |
| Mesatare | 10 - 14 |
| Mbi mesatare | 15 - 20 |

**B. Planifikimin e prokurorëve për çështje të natyrës urgjente (10 pikë):**

1. Marrja e masave për organizimin, koordinimin dhe mbarëvajtjen e gatishmërisë në prokurorinë përkatëse (2 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[1]:*
   - *Normimi administrativ-procedural i gatishmërisë në prokurori, lidhur me mënyrën e organizimit dhe funksionimit, njoftimit të drejtuesit të prokurorisë, detyrat e prokurorit të gatshëm, hyrjes në grafikun e gatishmërisë të drejtuesit;*
   - *Monitorimi i mbarëvajtjes së gatishmërisë. Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre;*
   - *Respektimi i parashikimeve ligjore lidhur me caktimin e çështjeve me të arrestuar ose të ndaluar, prokurorëve të gatshëm;*
   - *Arsyetimi i rasteve të përjashtimit të prokurorit të gatshëm nga caktimi i çështjes).*
2. Marrja e masave për organizimin, koordinimin dhe mbarëvajtjen e gatishmërisë në periudha para dhe pas zgjedhjeve[2] (2 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[3]:*
   - *Normimi administrativ-procedural i gatishmërisë në prokurori, lidhur me mënyrën e organizimit dhe funksionimit, njoftimit të drejtuesit të prokurorisë, detyrat e prokurorit të gatshëm, hyrjes në grafikun e gatishmërisë të drejtuesit, në zbatim të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm;*
   - *Monitorimi i mbarëvajtjes së gatishmërisë. Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre;*
   - *Respektimi i parashikimeve ligjore lidhur me caktimin e çështjeve me të arrestuar ose të ndaluar, prokurorëve të gatshëm.*
   - *Arsyetimi i rasteve të përjashtimit të prokurorit të gatshëm nga caktimi i çështjes.*

[1]Mosplotësimi i tre elementeve passjell mosmarrjen e pikëve përkatëse.
[2]Shih udhëzimin e përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 03 datë 21.06.2019 "Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhjeve".
[3]Mosplotësimi i tre elementeve passjell mosmarrjen e pikëve përkatëse.

3. Ndjekja në dinamikë e ecurisë së këtyre çështjeve, si dhe nxjerrja udhëzimeve të përgjithshme të natyrës administrative ose procedurale[1] (2 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[2]:*
   - *Kërkimi i informacionit për ecurinë e procedimeve penale për krimin zgjedhor;*
   - *Shprehja dhe qëndrimi i tij me anë të udhëzimeve me shkrim, si dhe ndjekja e zbatimit të tyre për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit. Përjashtimisht, kur rrethanat nuk e lejojnë, udhëzimet mund të jepen verbalisht dhe, brenda një kohe të arsyeshme, të konfirmohen me shkrim;*
   - *Verifikimi periodik i ecurisë dhe përfundimit të çështjeve për krimet zgjedhore. Analiza e problematikave të konstatuara dhe adresimi i tyre. Ndjekja në vijimësi e tyre;*
   - *Nxjerrja e udhëzimeve jo të detyrueshme për kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake).*
4. Krijimi i grupeve hetimore për çështje të veçanta[3](2 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[4]:*
   - *Normimi aspekteve administrative-procedurale i krijimit të grupeve hetimore;*
   - *Rastet e përfshirjes së drejtuesit në grupe hetimore dhe roli i tij;*
   - *Monitorimi i mbarëvajtjes së grupeve hetimore. Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre;*
   - *Verifikimi periodik i ecurisë dhe përfundimit të çështjeve të hetuara me grup hetimor dhe nxjerra e udhëzimeve jo të detyrueshme përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake).*
5. Marrja e masave për funksionimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me publikun për çështjet e natyrës urgjente[5] (2 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[6]:*
   - *Normimi aspekteve administrative-procedurale i bashkëpunimit me Policinë e Shtetit, shërbimet e tjera policore, policinë shkencore, për çështjet e natyrës urgjente;*
   - *Normimi i aspekteve administrative-procedurale i bashkëpunimit me Prokurorinë e Përgjithshme, Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Gjykatën, për çështjet e natyrës urgjente;*
   - *Miratimi i strategjisë së komunikimit me publikun për çështjet e natyrës urgjente;*
   - *Monitorimi i mbarëvajtjes së bashkëpunimit. Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre).*

---

[1]Shih nenin 8/5 të udhëzimit e përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 03 datë 21.06.2019 "Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhjeve".
[2]Mosplotësimi i tre elementeve passjell mosmarrjen e pikëve përkatëse.
[3]shih nenin 42/ç të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[4]Mosplotësimi i tre elementeve passjell mosmarrjen e pikëve përkatëse.
[5]Shih nenin 8/5 të udhëzimit e përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 05 datë 30.07.2019 "Marrëdheniet me publikun në prokuritë me juridiksion të përgjithshëm".
[6]Mosplotësimi i tre elementeve passjell mosmarrjen e pikëve përkatëse.

| Shkalla e aftësisë së drejtuesit | Nr. i pikëve |
|---|---|
| Nën mesataren | 2- 4 |
| Mesatare | 5 - 7 |
| Mbi mesatare | 8 - 10 |

**C. Zëvendësimin në kohë të prokurorëve që kanë pengesa në proces (10 pikë):**

1. Qëndrimi proaktiv i drejtuesit të prokurorisë për të vendosur mbi zëvendësimin e prokurorit kur ekzistojnë arsye serioze që lidhen me detyrën sipas ligjit[1] (2 pikë).

*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[2]:*

- *Marrja e masave për identifikimin e rasteve dhe zëvendësimin e prokurorit kur konstatohet shkelje ligjore serioze nga prokurori i çështjes;*
- *Respektimin e shortit në caktimin prokurorëve për çështjet e zëvendësuara).*

2. Marrja e masave për zëvendësimin e prokurorit të çështjes, për shkak të mungesës ose paaftësisë së tij të përkohshme fizike për punë, nuk është në gjendje të ushtrojë funksionet apo të respektojë afatet ligjore[3] (2 pikë).

*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[4]:*

- *Marrja e masave për zëvendësimin e prokurorit për shkak të mungesës ose paaftësisë së tij të përkohshme fizike për punë, nuk është në gjendje të ushtrojë funksionet apo të respektojë afatet ligjore;*
- *Respektimin e shortit në caktimin prokurorëve për çështjet e zëvendësuara).*

3. Marrja e masave organizative-administrative dhe trajtimi me uniformitet i deklarimeve për heqje dore, apo kërkesave për zëvendësimin e prokurorit (2 pikë).

   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[5]:*

   - *Marrja e masave procedurale dhe administrative për trajtimin e deklarimeve për heqje dore, apo kërkesave për zëvendësimin e prokurorit;*
   - *Trajtimi i rasteve me uniformitet).*

4. Nxjerrja e udhëzimeve të përgjithshme për rregullimin e aspekteve procedurale të zëvendësimit të prokurorëve[6] (2 pikë).

   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[7]:*

   - *Nxjerrja e udhëzimeve të përgjithshme për rregullimin e aspekteve procedurale penale të zëvendësimit të prokurorëve;*
   - *Zbatimi i këtyre i këtyre udhëzimeve).*

5. Cilësia dhe arsyetimi ligjor i vendimmarrjeve. (2 pikë).

---

[1]Shih nenin 27/1 të Kodit të Procedurës Penale
[2]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[3]Shih nenin 43/d të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[4]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[5]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[6]Shih nenin 49 të ligjit 97/2016"Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[7]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[1]:*

- *Aftësitë hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave;*
- *Aftësia për të interpretuar ligjin. Aftësia për të interpretuar ligjin e identifikuar, arsyetimi i tij për mënyrën e zbatimit të ligjit mbi çështjet konkrete për trajtim, apo pasqyrimi dhe/ose analizimi i të dhënave në zbatim dhe në përputhje me ligjin e identifikuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;*
- *Aftësia për të zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale që kanë lidhje me interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjes për trajtim, në përpunimin e akteve dhe dokumenteve ligjorë, dhe/ose në arsyetimet me shkrim ose verbale, sipas rastit;*
- *Për aq sa është e mundur, aftësia për të analizuar jurisprudencën, praktikat me të mira, standardet ndërkombëtare, duke u përqendruar tek aftësia për të kërkuar, identifikuar, organizuar dhe përdorur jurisprudencën relevante për një çështje të caktuar, në mbështetje të një interpretimi të caktuar;*
- *Aftësia për të hartuar akte nënligjore. Zbatimi i teknikës legjislative. Qartësia, konçiziteti dhe kuptueshmëria. Përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës; Aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë; Zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës; Përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), paragrafëve dhe e strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin; Përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë).*

| **Shkalla e aftësisë së drejtuesit** | **Nr. i pikëve** |
|---|---|
| Nën mesataren | 2 - 4 |
| Mesatare | 5 – 7 |
| Mbi mesatare | 8 - 10 |

**D. Zhvillimin e mbledhjeve tematike për prokurorët (10 pikë);**

1. Zhvillimi periodik i mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve të zyrës që drejton për të diskutuar çështje me rëndësi për veprimtarinë e prokurorisë[2]. (2 pikë).

   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[3]:*

   - *Respektimi i parashikimeve ligjore lidhur me procedurën e njoftimit dhe zhvillimit të mbledhjes;*
   - *Periodiciteti i arsyeshëm i zhvillimit të mbledhjeve).*

[1]Mosplotësimi i tre elementi passjell mosmarrjen e pikve përkatëse.

[2]Shih nenin 55 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

[3]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e njëpike përkatëse.

2. Organizimi i diskutimeve për çështje të natyrës profesionale[1] (2 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[2]:*
   - *Rëndësia, risitë, zhvillimet e fundit të jurisprudencës të sjella gjatë diskutimeve;*
   - *Periodiciteti i arsyeshëm i zhvillimit të mbledhjeve).*
3. Vlerësimi dhe marrja e masave për zbatim sipas mendimit të dhënë nga mbledhja e prokurorëve mbi rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë; lidhur me përshkrimet e punës të të gjitha kategorive të nëpunësve civilë dhe punonjësve të prokurorisë, për ngritjen e seksioneve, për strukturën dhe përbërjen e tyre; çdo çështje tjetër me rëndësi për veprimtarinë e prokurorisë, përfshirë ato që lidhen me disiplinimin, karrierën dhe trajnimin e prokurorëve dhe nëpunësve të prokurorisë[3] (2 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[4]:*
   - *Masat organizative, nënligjore, administrative, të marra nga drejtuesi i prokurorisë për të konkretizuar mendimin e shfaqur dhe të mirëpranuar në mbledhjen e përgjithshme;*
   - *Mbikëqyrja e zbatimit të këtyre masave).*
4. Diskutimi i raportit vjetor të prokurorisë[5] (2 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[6]:*
   - *Respektimi i parashikimeve ligjore lidhur me procedurën e njoftimit dhe zhvillimit të mbledhjes;*
   - *Reflektimi në draftraport të mendimeve, diskutimeve të shfaqura gjatë mbledhjes).*
5. Cilësia e akteve shoqëruese të njoftimit të mbledhjeve, e argumentimit, moderimit të diskutimit në mbledhje, e arritjes së përfundimeve, ndjekja në vijimësi e zgjidhjes së tyre (2 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[7]:*

- *Aftësia për të hartuar akte shoqëruese. Zbatimi i teknikës legjislative. Qartësia, konçiziteti dhe kuptueshmëria. Përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës; Aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë; Zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës; Përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), paragrafëve dhe e strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin; Përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë);*
- *Niveli i argumentimit gjatë diskutimit, mënyra e moderimit të diskutimit në mbledhje, nxjerrja e përfundimeve, dhe ndjekja në vijimësi e zgjidhjes së tyre.)*

---

[1]Shih shih nenin 42/d të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.
[2]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e një pike përkatëse.
[3]Shih nenin 55 tëligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.
[4]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e një pike përkatëse.
[5]Shih nenin 56 tëligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.
[6]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e një pike përkatëse.
[7]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e një pike përkatëse.

| Shkalla e aftësisë së drejtuesit | Nr. i pikëve |
|---|---|
| Nën mesataren | 2 - 4 |
| Mesatare | 5 -7 |
| Mbi mesatare | 8 - 10 |

E. **Planifikimin dhe përdorimin efikas të fondeve publike, sipas nevojave të prokurorisë (10 pikë);**

1. Marrja mendim nga mbledhja e përgjithshme e prokurorëve të zyrës mbi projektbuxhetin e prokurorisë përkatëse, si dhe mbi përdorimin e fondeve publike brenda vitit buxhetor ekonomik[1](2 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[2]:*
   - *Respektimi i parashikimeve ligjore lidhur me procedurën e njoftimit dhe zhvillimit të mbledhjes;*
   - *Reflektimi në draftbuxhet të mendimeve, diskutimeve të shfaqura gjatë mbledhjes).*
2. Marrja e masave për të rritur buxhetin e Prokurorisë me të ardhura nga donacione dhe çdo të ardhur tjetër të ligjshme[3] (2 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[4]:*
   - *Normimi i aspekteve procedurale-administrative të lobimit, pranimit, dhe bërjes pjesë të buxhetit;*
   - *Marrja e nismave për rritjen e buxhetit me donacione dhe të ardhura të tjera të ligjshme).*
3. Qëndrimi proaktiv në adresimin, persistimin, në zgjidhjen e problematikave lidhur me planifikimin dhe përdorimin e fondeve publike (2 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[5]:*
   - *Masat e marra për të adresuar problematikat e konstatuara;*
   - *Këmbëngulja në zgjidhjen e tyre).*
4. Monitorimi i mbledhjes së të ardhurave nga shpenzimet procedurale, dhe të ardhurave të tjera që rezultojnë nga veprimtaria e rregullt e prokurorisë[6](2 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[7]:*
   - *Organizimi i monitorimit të mbledhjes të të ardhurave nga shpenzimet procedurale;*
   - *Problematikat e konstatuara dhe zgjidhja e tyre).*
5. Marrja e masave për mbikëqyrjen e veprimtarisë financiare të prokurorisë (2 pikë).

---

[1]Shih nenin 56 tëligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[2]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e një pike përkatëse.
[3]Shih shih nenin 40/4 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[4]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e një pike përkatëse.
[5]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e një pike përkatëse.
[6]Shih udhëzimin e përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 08 datë 19.05.2019 "Për shpenzimet procedurale penale në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm".
[7]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e një pike përkatëse.

*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[1]:*
- *Normimi i aspekteve procedurale-admnistrative për ushtrimin e mbikëqyrjes së brendshme të veprimtarisë financiare të prokurorisë;*
- *Problematikat e konstatuara dhe zgjidhja e tyre).*

| Shkalla e aftësisë së drejtuesit | Nr. i pikëve |
|---|---|
| Nën mesataren | 2 - 4 |
| Mesatare | 5 - 7 |
| Mbi mesatare | 8 - 10 |

**F. Mbikëqyrjen për efekt të përmirësimit të informacionit në faqen zyrtare të prokurorisë (10 pikë);**

1. Përmirësimi i ndërfaqes web të prokurorisë në përputhje me programin e transparencës së përgatitur nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bashkuar në ligjin nr. 119/2015 "Për të drejtën e informimit"[2] (2 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[3]:*
   - *Marrja e masave konkrete për përmirësimin e saj;*
   - *Problematikat e konstatuara dhe zgjidhja e tyre).*
2. Marrja e masave organizative për përditësimin dhe mirëmbajtjen e portalit unik[4](2 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[5]:*
   - *Normimi i aspekteve procedurale-administrative për përditësimin dhe mirëmbajtjen e portalit unik;*
   - *Problematikat e konstatuara dhe zgjidhja e tyre).*
3. Vendosja në zbatim të programit institucional të transparencës, në të cilin përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni[6](2 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[7]:*
   - *Marrja e masave konkrete për përmirësimin e saj;*
   - *Problematikat e konstatuara dhe zgjidhja e tyre).*
4. Hartimi i strategjisë së komunikimit publik nëpërmjet faqes zyrtare (2 pikë).

---
[1]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e një pike përkatëse.
[2]Shih nenin 79 të ligjit për statusin
[3]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e një pike përkatëse.
[4]Shih nenin 20 të udhëzimit e përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 05 datë 30.07.2019 "Marrëdheniet me publikun në prokuritë me juridiksion të përgjithshëm".
[5]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e një pike përkatëse.
[6]Shih nenin 24 të udhëzimit e përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 05 datë 30.07.2019 "Marrëdheniet me publikun në prokuritë me juridiksion të përgjithshëm".
[7]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e një pike përkatëse.

*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[1]:*

- *Hartimi i strategjisë së komunikimit publik;*
- *Monitorimi i zbatimit të saj).*

5. Monitorimi i përmbushjes së detyrave nga personeli përgjegjës dhe marrja e masave për zgjidhjen e problematikave (2 pikë).

   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[2]:*

   - *Normimi i aspekteve procedurale-admnistrative lidhur me ushtrimin e detyrave nga personale përgjegjës;*
   - *Monitorimi i zbatimit të tyre, problematikat e konstatuara dhe zgjidhja e tyre).*

| Shkalla e aftësisë së drejtuesit | Nr. i pikëve |
|---|---|
| Nën mesataren | 2 - 4 |
| Mesatare | 5 - 7 |
| Mbi mesatare | 8 - 10 |

**G. Mbikëqyrjen, për krijimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori, në përputhje me nevojat e palëve e të publikut (10 pikë);**

1. Marrja e masave për menaxhimin e objekteve dhe pasurisë së prokurorisë dhe monitorimi periodik(1 pikë).[3]

   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[4]:*

   - *Marrja e masave për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin, dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi;*
   - *Krijimi dhe përditësimi i regjistrit kontabël).*

2. Marrja e masave për të përmirësuar kushtet e punës, ambientet e zyrave, dhe infrastrukturën e prokurorisë, përfshirë marrjen e masave për garantimin e transportit me mjete zyrtare të prokurorëve në ushtrim të detyrave zyrtare, në veçanti kur godina e gjykatës është në largësi nga godina e prokurorisë(1 pikë).

   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[5]:*

   - *Marrja e masave konkrete për të përmirësuar kushtet e punës dhe infrastrukturën e prokurorisë;*
   - *Marrja e masave për garantimin e transportit me mjete zyrtare të prokurorëve në ushtrim të detyrave zyrtare).*

3. Marrja e masave për të garantuar parkimin dhe sigurinë për mjetet e prokurorisë dhe të prokurorëve të prokurorisë që drejton (1 pikë).

---

[1]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e një pike përkatëse.
[2]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e një pike përkatëse.
[3]Rregullore Nr. 01 datë 09.07.2020 "Për menaxhimin e aktiveve në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në njësitë e varësisë"
[4]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[5]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[1]:*

- *Marrja e masave konkrete për të garantuar parkimin dhe sigurinë e mjeteve të prokurorisë dhe të prokurorëve;*
- *Evidentimi i problematikave, këmbëngulja dhe zgjidhja e tyre).*

4. Normimi administrativ i përdorimit të automjeteve zyrtare, mbikëqyrja e përdorimit të tyre(1 pikë).

*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[2]:*

- *Përcaktimi i rregullave për përdorimin efikas dhe ekonomizimin e shpenzimeve për përdorimin e automjeteve zyrtare të prokurorisë;*
- *Monitorimi i zbatimit të tyre).*

5. Marrja e masave për adresimin dhe zgjidhjen e problematikave të ngritura nga prokurorët, dhe personeli administrativ lidhur me ambientet e punës (1 pikë).

*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[3]:*

- *Organizimi i monitorimeve periodike për evidentimin e problematikave, mbledhjeve dhe takimeve për bërjen prezent të problematikave nga prokurorët dhe personeli administrativ;*
- *Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre).*

6. Marrja e masave për të siguruar qasjen e publikut në prokurori, rritja e efikasitetit të shërbimit të administratës, caktimi i ditëve vizituese në godinë (1 pikë).

*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[4]:*

- *Marrja e masave konkrete për të lehtësuar aksesin e publikut, si dhe përmirësimi i shërbimeve të administratës. Mbikëqyrja periodike dhe evidentimi i problematikave;*
- *Caktimi i ditëve të caktuara për vizitimin e ambienteve të prokurorisë nga qytetarët. Rregullimi i aspekteve administrative dhe procedurale për këtë qëllim).*

7. Marrja e masave për të garantuar qasjen e personave që nuk kuptojnë gjuhën shqipe, apo personave me aftësi të kufizuara në prokurori (1 pikë).

*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[5]:*

- *Marrja e masave për të garantuar aksesin në prokurori dhe shërbimeve administrative për personat që nuk kuptojnë gjuhën shqipe;*
- *Krijimi i infrastrukturës, marrja e masave për të aksesuar prokurorinë dhe shërbimet ligjore të saj nga personat me aftësi të kufizuara).*

8. Marrja e masave për vënien në funksionim dhe zbatimin e të drejtës së magjistratit për aplikimin e skemës së huamarrjes së kredisë për shtëpi.[6](1 pikë).

*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[7]:*

- *Marrja e masave konkrete për të organizuar, koordinuar bashkëpunimin ndërinstitucional për vënien në funksionim dhe zbatimin e kësaj skeme;*

---

[1]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[2]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[3]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[4]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[5]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[6]Shih nenin 17 të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
[7]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

- *Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre).*

9. Marrja e masave për të siguruar qasjen në prokurori të viktimave të veprës penale, marrjen e kallëzimeve penale, apo të subjekteve të tjerë të procedurës penale në ushtrim të të drejtave dhe garancive procedurale (1 pikë).

   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[1]:*
   - *Marrja e masave konkrete për të lehtësuar aksesin e viktimave të veprës penale. Monitorimi i zbatimit të detyrave nga koordinatori, psikologu dhe punonjësve të tjerë të prokurorisë për të garantuar respektimin e të drejtave procedurale të viktimave;*
   - *Normimi i aspekteve procedurale dhe administrative për të garantuar marrjen e kallëzimeve penale në prokurori, si dhe monitorimi i zbatimit të tyre).*

10. Marrja e masave për krijimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur (1 pikë).

   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[2]:*
   - *Marrja e masave konkrete për të krijuar ambiente të përshtatshme në prokurori për marrjen në pyetje të të miturve. Afishimi publik në formë tabelare i të drejtave të tyre;*
   - *Marrja e masave për garantimin e marrjes në pyetje me pajisje, mjete audiovizive).*

| **Shkalla e aftësisë së drejtuesit** | **Nr. i pikëve** |
|---|---|
| Nën mesataren | 2 - 4 |
| Mesatare | 5 - 7 |
| Mbi mesatare | 8 - 10 |

**H. Kujdeset për çështjet e ruajtjes dhe të sigurisë në prokurori (10 pikë);**

1. Marrja me masave për ruajtjen dhe sigurinë në prokurori (1 pikë).

   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[3]:*
   - *Marrja e masave konkrete për zbatimin e legjislacionit në fuqi, të cilat rregullojnë ruajtjen dhe sigurinë në prokurori. Nxjerrja e urdhrave dhe udhëzimeve për të lehtësuar zbatimin e tyre në prokurori;*
   - *Monitorimi i zbatimit të tyre, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre).*

2. Miratimi i një politike për sigurinë e objektit/sigurinë në punë, si dhe përgatitja e programeve për menaxhimin e sigurisë dhe përditësimi i tyre (1 pikë).

   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[4]:*

[1]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[2]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[3]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[4]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

- *Miratimi i një politike për sigurinë, si dhe përgatitja e programeve. Përcaktimi i përgjegjësive individuale dhe "të zinxhirit të komandës" për arritjen e objektivave sa i përket secilit funksion dhe secilit nivel të hierarkisë. Miratimi i një kalendari me afate kohore për arritjen e objektivave dhe një përcaktim të stafit dhe burimeve që do të përdoren për këtë qëllim;*
- *Monitorimi i zbatimit të tyre, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre).*

3. Përcaktimi i punonjësve të caktuar dhe trajnimi i tyre për çështje të sigurisë dhe marrja e masave për të garantuar që informacioni në lidhje me sigurinë t'iu komunikohet anëtarëve të stafit dhe nëpunësve të prokurorisë[1] (1 pikë).

*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[2]:*

- *Normimi i rolit të anëtarëve të stafit, përgjegjësitë dhe kompetencat e tyre, organizimi dhe funksionimi, si dhe njohja me to e të gjithë stafit. Nënshkrimi i marrëveshjes së konfidencialitetit, dhe monitorimi i zbatimit të saj;*
- *Stafi i prokurorisë, të cilit i delegohen përgjegjësi në lidhje me sigurinë, duhet të marrë trajnimin e duhur me këto objektiva: Njohjen e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi; Njohjen e riskut për kërcënim ndaj prokurorisë dhe vulnerabilitetet e saj; Funksionimin e sistemit të menaxhimit të prokurorisë).*

4. Vendosja dhe përditësimi i procedurave për trajtimin e duhur të të gjitha dokumenteve në prokurori, si dhe vendosja dhe zbatimi i rregullave dhe procedurave në lidhje me sigurinë e sistemeve të informacionit që janë të përshtatshme sa i përket konstatimeve të vulnerabilitetit, sidomos rregullave në lidhje me: Administrimin e sistemeve të informacionit; Ruajtjen dhe instalimin e pajisjeve të sigurisë; Ruajtjen dhe asgjësimin e mjeteve të ruajtjes së të dhënave (1 pikë).

*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[3]:*

- *Regjistrimi dhe të ruajtja në mjete të përshtatshme, si për shembull në letër apo në kompjuter, informacione që duhen: Për të përshkruar elementet e domosdoshme të sistemit të menaxhimit dhe ndërveprimeve të tyre; Për të identifikuar apo për të përcaktuar vendndodhjen e dokumentacioneve të korrespondencës. Dokumente në lidhje me informacione dhe/ose objekte delikate duhet të trajtohen nga disa rregulla specifike, të cilat përcaktojnë: – shkallën e sensitivitetit të informacionit; Nivelin e klasifikimit sipas shkallës së specifikuar të sensitivitetit; Personat/grupet të cilëve mund tu qarkullohen dokumente të secilit nivel klasifikimi; Rregullat e identifikimit; Rregullat për lëshimin, riprodhimin, mbajtjen, ruajtjen dhe asgjësimin e informacioneve dhe/ose objekteve delikate;*
- *Vendosja dhe përditësimi i procedurave për trajtimin e duhur të të gjitha dokumenteve dhe të dhënave të nevojshme për të garantuar që: Të mund të përcaktohet vendndodhja e tyre; Të rishikohen dhe të ndryshohen në mënyrë sistematike nëse është e nevojshme dhe të miratohen sipas rregullave nga personat e autorizuar për këtë qëllim; Versionet aktuale të dokumenteve dhe të dhënave relevante të jenë të disponueshme në të gjitha vendndodhjet, ku*

[1]Shih "Përmirësimi i sigurisë së gjykatave dhe prokurorive shqiptare", Raport i vlerësimit të nevojave për trajnim, Këshilli i Evropës, shkurt 2019.
[2]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[3]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

*kryhen operacione të domosdoshme për funksionimin normal të sistemit të menaxhimit të sigurisë; Dokumente dhe të dhënat e vjetëruara të mund të tërhiqen në mënyrë të menjëhershme nga të gjitha vendet ku ato janë të disponueshme për përdorim dhe të menaxhohen në mënyrë të tillë që të mos mund të përdoren gabimisht; Dokumentet dhe të dhënat e arkivuara të mbajtura për qëllime juridike të mund të identifikohen dhe të sigurohen si duhet. Vendosja dhe zbatimi i rregullave dhe procedurave në lidhje me sigurinë e sistemeve të informacionit që janë të përshtatshme sa i përket konstatimeve të vulnerabilitetit, sidomos rregullave në lidhje me: Administrimin e sistemeve të informacionit; Ruajtjen dhe instalimin e pajisjeve të sigurisë; Ruajtjen dhe asgjësimin e mjeteve të ruajtjes së të dhënave).*

5. Përcaktimi i aktiviteteve që përfshijnë vulnerabilitete të njohura dhe që duhen kontrolluar rreptësisht, si dhe përcaktimi dhe përditësimi i procedurave për identifikimin, parandalimin dhe diktimin e situatave të emergjencës dhe për të pasur kapacitet reagues të tillë që të mund të parandalohet, të diktohet ose të zbutet çdo sulm ndaj njerëzve, pronës apo informacioneve (1 pikë).

   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm*[1]*:*

   - *Përcaktimi i atyre aktivitete që përfshijnë vulnerabilitete të njohura dhe që duhen kontrolluar rreptësisht. Këto aktivitete duhet të planifikohen, me mirëmbajtjen dhe mbikëqyrjen e duhur, për të garantuar realizimin e tyre siç kërkohet: a) Duke përcaktuar dhe përditësuar procedurat në lidhje me ambiente dhe vendndodhje të tjera vulnerabël (grafik organizativ për çelësat, karta për kontrollin e aksesit); b) Duke përgatitur dhe duke përditësuar procedurat zyrtare që përcaktojnë sjelljen që duhet demonstruar në rast situatash kritike (mosfunksionim të sistemit të sigurisë që prek mbikëqyrjen, kontrollin e aksesit, etj.); c) Duke futur një sistem për të monitoruar autorizimet për aksesin e kontrolluar në ambiente të kufizuara dhe delikate (dhomat e provave, dhomën e serverëve, kamerave); d) Duke përcaktuar zonat e kontrolluara mbi bazën e fluksit të lëvizjeve dhe konstatimeve të pikave të dobëta; e) Duke përcaktuar procedura specifike për trajtimin e anëtarëve të publikut dhe personave nga jashtë prokurorisë, sidomos kur ata mund të jenë në kontakt me informacione dhe/ose materiale që konsiderohen sensitive. Mjetet e mbrojtjes dhe diktimit duhet t'i përshtaten nivelit të vulnerabilitetit. Sistemi në tërësi duhet të monitorohet nga punonjës kompetentë të caktuar për këtë qëllim.*
   - *Marrja e masave me anë të cilave duhet: Të përcaktojë dhe të përditësojë procedura për identifikimin e situatave të emergjencës dhe për të pasur kapacitet reagues të tillë që të mund të parandalohet, të diktohet ose të zbutet çdo sulm ndaj njerëzve, pronës apo informacioneve; Të rishikojë procedurat për parandalimin dhe diktimin e situatave të emergjencës dhe të ofrojë kapacitet reagimi, sidomos pas një incidenti apo një emergjence).*

---

[1]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

6. Organizimi i simulimeve periodike, nga të cilat mund të nxirren mësime, si dhe përcaktimi dhe përditësimi i një programi për audite periodike të sigurisë (1 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[1]:*
    - *Organizimi i simulime periodike, nga të cilat mund të nxirren mësime; Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre;*
    - *Përcaktimi dhe përditësimi i një programi për audite periodike të sigurisë Për të vendosur nëse mjetet e vlerësimit dhe menaxhimit dhe sistemi i menaxhimit të sigurisë: Përmbushin kërkesat për menaxhimin e sigurisë të përcaktuara nga autoriteti i lartë kompetent; Zbatohen dhe përditësohen siç duhet; Ndihmojnë zbatimin efektiv të politikave dhe objektivave të saj; Për të rishikuar konstatimet e auditimeve të mëparshme).*
7. Marrja e masave për ndarjen e brendshme të ambienteve në zona sigurie, si dhe caktimi i një koordinatori për sigurinë, përgjegjës për kontrollin operacional dhe menaxhimin e mjeteve përkatëse (1 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[2]:*
    - *Ndarja e brendshme e ambienteve në zona sigurie, ku të ketë rregulla përkatëse për të kontrolluar aksesin e tyre, si dhe rregulla për të organizuar aksesin mes këtyre zonave. Duhen përcaktuar oraret kur këto zona janë të hapura dhe të mbyllura, duke përfshirë veprimet procedurale që duhet të kryhen në orët e vona ose në fundjava. Pikat e kontrollit të publikut duhet të vendosen në hyrje të ndërtesës për të siguruar që ato nuk mund të shmangen në rast se, synohet aksesi në ketë zonë të veçantë;*
    - *Caktimi i një koordinatori për sigurinë, përgjegjës për kontrollin operacional dhe menaxhimin e mjeteve përkatëse).*
8. Krijimi i instrumenteve të menaxhimit dhe komunikimit në sektorin e sigurisë, si lista kontrolli dhe formularë incidentesh(1 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[3]:*
    - *Marrja e masave për krijimin e instrumenteve të menaxhimit dhe komunikimit në sektorin e sigurisë. Kryerja në mënyrë sistematike e inspektimeve fizike dhe kontrolleve të të gjitha lëvizjeve hyrëse dhe dalëse. Përdorimi i regjistrit të vizitorëve;*
    - *Marrja e "masave të nevojshme për garantimin e sigurisë" të personave që punojnë në objekt. Mangësitë e mundshme mund të identifikohen dhe të korrigjohen duke përdorur formularë për incidentet: të hartuara sa herë që një ngjarje prek sigurinë e prokurorisë (sulmet ndaj personave apo pronës); Dosje sigurie: dosje që për çdo prokurori të përmbajnë të gjitha dokumentet që lidhen me sigurinë duke ofruar një historik informacionesh rreth institucionit; Plan sigurie: përcakton masat që duhen marrë në prokurori për të garantuar një nivel të kënaqshëm sigurie, Plan veprimi).*
9. Hartimi i planeve të ndërhyrjeve të njohura për të gjithë stafin (1 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[4]:*

[1]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[2]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[3]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[4]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

- *Miratimi i Planit të Posaçëm të Mbrojtjes dhe Planit të Jashtëm të Mbrojtjes. Protokolli i përcaktuar duhet të përfshijë mundësi për njoftime sa më të hershme dhe identifikim të ngjarjeve të dyshimta, diktim të sinjaleve në shkallë të vogël që mund të tregojnë për zhvillime të papritura të situatës, njoftim të menjëhershëm të forcave të zbatimit të ligjit dhe vendosje të menjëhershme të objektit në gjendje emergjence; ato duhet të parashikojnë një lloj shkallëzimi për të marrë parasysh ndjeshmërinë që mund të kenë aktivitetet e planifikuara të prokurorisë.*
- *Miratimi i protokollit të ndërhyrjeve të forcave të zbatimit të ligjit dhe shërbimeve në raste emergjence, i cili të parashikojë, në një kuadër të miratuar, garantimin e ndërhyrjeve të forcave të zbatimit të ligjit dhe shërbimeve të emergjencës në rast njoftimi. Fushatat për ndërgjegjësimin e stafit. Për kategori të ndryshme të stafit duhet të bëhen prezantime periodike lidhur me rreziqet ndaj të cilave ata ekspozohen dhe mjeteve dhe masave ekzistuese për parandalimin e tyre. Në ato departamente ku ka më shumë gjasa të shfaqen sjellje agresive, duhet të merren masa për minimizimin e rrezikut të ekspozimit të stafit ndaj tyre: – programe për parandalimin e dhunës; – sisteme gjurmimi për më shumë transparencë për mënyrën e funksionimit të këtij shërbimi; – sisteme për këshillimin e stafit dhe mbështetjen e tij në raste incidentesh që lidhen me sigurinë; – vigjilencë aktive për identifikimin e situatave të rrezikshme; – çdo masë e posaçme që mund të integrohet në planifikimin lokal për mbrojtjen dhe sigurinë).*

10. Zbatimi i politikës së ndërtesave dhe i një politike për sigurinë nga zjarri (1 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[1]:*
- *Marrja e masave për zbatimin e politikës së ndërtesës. Kjo politikë duhet të bazohet në njohjen e pronave aktuale dhe në një analizë të kërkesave për siguri në të ardhmen. Përcaktimi i objektivave të përmirësimit të objekteve dhe operacionet prioritare që duhen kryer sipas një programi pune shumëvjeçare;*
- *Marrja e masave paraprake për organizimin e ndihmës së shpejtë, si dhe për mbrojtjen nga zjarri dhe evakuimin në rast emergjence; të përgatisë një plan evakuimi dhe shpëtimi në rast emergjence, t'ua shpërndajë atë punonjësve dhe të organizojë trajnime dhe simulime të parashikuara nga ky plan të paktën një herë në dy vjet; të caktojë të paktën një punonjës të trajnuar për ndihmën e shpejtë, për shuarjen e zjarrit; dhe për shpëtimin në një staf prej më shumë se 20 vetash, duhet të ketë të paktën dy punonjës të trajnuar. Rregulloret për rastet e zjarrit duhet gjithashtu të afishohen në godinë, ku të tregohet se si lajmërohet zjarrfikësja, si sigurohet hap pas hapi siguria personale, si përdoren pajisjet për fikjen e zjarrit dhe si pritet dhe ndihmohet zjarrfikësja. Këto rregulla duhet të afishohen së bashku me planin e evakuimit, ku identifikohen rrugëdaljet, vendndodhja e daljeve të emergjencës, si dhe vendndodhja e pajisjeve për fikjen e zjarrit. Këto rregulla duhet të afishohen në çdo kat të ndërtesës, afër dyerve, shkallëve dhe ashensorëve dhe duhet të pozicionohen në mënyrë të tillë që të mund të lexohen lehtësisht*).

---
[1]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

| Shkalla e aftësisë së drejtuesit | Nr. i pikëve |
|---|---|
| Nën mesataren | 2 - 4 |
| Mesatare | 5 - 7 |
| Mbi mesatare | 8 - 10 |

**I.** Organizimin e trajnimeve për prokurorët dhe punonjësit e prokurorisë (10 pikë).

1. Përfshirja e drejtuesit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë ose në trajnime profesionale për drejtimin dhe organizimin e prokurorisë[1]. (2 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[2]:*
   - *Përfshirja e drejtuesit në veprimtari ndërinstitucionale (grupe pune, projekte, reforma etj) të cilat synojnë përmirësimin e sistemit të drejtësisë;*
   - *Marrja pjesë në trajnime profesionale për drejtimin dhe organizimin e prokurorisë për të rritur nivelin profesional).*
2. Koordinimi dhe organizimi i trajnimeve të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër veprave penale prioritare të rekomanduara, si dhe të lehtësojnë pjesëmarrjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në trajnime të përbashkëta me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit në fushat dhe drejtimet e rekomanduara[3] (2 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[4]:*
   - *Marrja e masave për të organizuar trajnime të përbashkëta me Policinë e Shtetit, shërbimet e tjera gjyqësore, apo institucione të tjera;*
   - *Planifikimi i punës për të lehtësuar pjesëmarrjen e prokurore dhe oficerëve në trajnime).*
3. Marrja e masave për të garantuar pjesëmarrje të barabartë të prokurorëve dhe oficerëve në trajnime, dhe sipas specializimit të tyre, seksionit në të cilin ushtron detyrën, në veçanti, në ato jashtë shtetit (2 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[5]:*
   - *Marrja e masave për të garantuar pjesëmarrje të barabartë në trajnime;*
   - *Mbikëqyrja e pjesëmarrjes në trajnime dhe përmbushje e detyrimeve nga pjesëmarrësit).*
4. Marrja e masave për koordinimin dhe organizimin e trajnimeve, webinareve (trajnime online), me organizmat ndërkombëtare në fushën e drejtësisë (2 pikë).

---

[1]Shih nenin 80 të ligjit Nr 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
[2]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[3]Shih nenin 6 të udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 02 datë 12.05.2023 "Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm".
[4]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[5]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[1]:*

- *Marrja e masave për realizmin e marrëveshjeve, krijimin e praktikave të mira me organizmat ndërkombëtare në fushën e drejtësisë;*
- *Marrja e masave për të organizuar trajnime të përbashkëta me to).*

5. Organizimi i trajnimeve për punonjësit administrativ të prokurorisë (2 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[2]:*

- *Marrja e masave për të organizuar trajnime të punonjësve administrative;*
- *Planifikimi i punës për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre në trajnime).*

| **Shkalla e aftësisë së drejtuesit** | **Nr. i pikëve** |
|---|---|
| Nën mesataren | 2 - 4 |
| Mesatare | 5 - 7 |
| Mbi mesatare | 8 - 10 |

Pikëzimi dhe përcaktimi i cilësisë të veprimtarisë drejtuese për Kriterin I

| **Shkalla e aftësisë së drejtuesit Kriteri I** | **Nr. i pikëve** |
|---|---|
| Nën mesataren | 25 - 49 |
| Mesatare | 50 - 74 |
| Mbi mesatare | 75 - 100 |

## II. Aftësitë komunikuese (100 pikë)

Për të pikëzuar aftësitë komunikuese vlerësuesi çmon aftësitë e drejtuesit për komunikim, nëpërmjet dhënies së vendimeve, urdhrave apo udhëzimeve, marrjen e masave procedurale për të siguruar bashkëpunim efektiv dhe në kohë me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Ministrinë e Drejtësisë, Kontrollin e Lartë të Shtetit, ose me çdo institucion tjetër, apo për lehtësimin e komunikimit ndërmjet organit të prokurorisë dhe publikut, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet prokurorisë dhe publikut, informimin dhe vetëdijesimin e publikut mbi rolin, kompetencat dhe veprimtarinë e prokurorisë, promovimin dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së publikut në parandalimin e krimit, dhe në procesin e reformave në të cilat përfshihet prokuroria, forcimin e llogaridhënies publike të prokurorisë duke ruajtur integritetin, pavarësinë dhe paanësinë.

Për të pikëzuar aftësitë komunikuese të drejtuesit të prokurorisë, vlerësuesi përqendrohet në dosjen personale, vlerësimi i kryer nga drejtuesi, raportet vjetore, raporti përkatës i

---

[1]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[2]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

përfaqësuesit të Këshillit duke përfshirë edhe regjistrimin audio, çdo urdhër ose vendim i drejtuesit i nxjerrë në ushtrim të kompetencave për organizimin e prokurorisë ose të administratës të prokurorisë, raportet e inspektimit të prokurorisë nga institucionet shtetërore, çdo dokument, i cili tregon aftësitë e komunikimit të drejtuesit me publikun dhe të tretët, mendimi i dhomës vendore të avokatisë dhe të kryetarit të gjykatës ku ushtron funksionin drejtuesi i prokurorisë, informacioni me shkrim nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera që vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e drejtuesit në veprimtari trajnuese për drejtimin dhe organizimin e prokurorisë, të dhëna për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj drejtuesit në këtë cilësi, gjatë periudhës së vlerësimit, vendime përfundimtare për masa disiplinore, mendimi i Prokurorit të Përgjithshëm për performancën e prokurorisë për periudhën e vlerësimit, raportimet vjetore të Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvendin e Shqipërisë, mendimi i Prokurorit të Përgjithshëm për funksionimin e policisë gjyqësore në atë prokurori për periudhën e vlerësimit dhe për organizimin dhe funksionimin administrativ të prokurorisë.

**A. Bashkëpunimin efektiv dhe në kohë me Këshillin, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Ministrinë e Drejtësisë, Kontrollin e Lartë të Shtetit ose me çdo institucion tjetër mbikëqyrjeje ose auditi (50 pikë);**

1. Bashkërendimi i punës me Këshillin e Lartë të Prokurorisë për çështje që lidhen me karrierën dhe rritjen profesionale të prokurorëve[1] (2 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[2]:*
   - *Marrja e masave organizative, procedurale për të siguruar bashkëpunimin me Këshillin e Lartë të Prokurorisë (normime procedurale administrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre);*
   - *Planifikimi i takimeve periodike brenda institucionit për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre).*
2. Organizimi, koordinimi i punës me Këshillin e Lartë të Prokurorisë për vlerësimin e performancës së prokurorëve (2 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[3]:*
   - *Marrja e masave për të organizuar, bashkërenduar, përmbushur detyrimet ligjore në kuadër të procesit të vlerësimit të prokurorëve;*
   - *Marrja e masave për monitorimin, saktësinë e të dhënave, objektivitetit në dhënien e mendimit për vlerësimin e prokurorëve).*
3. Marrja e masave administrative-procedurale për të garantuar zbatimin dhe respektimin e rregullave të etikës të miratuara nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe raportimin për gjetjet (2 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[4]:*
   - *Marrja e masave normuese në zbatim të rregullave të miratuara nga Këshilli;*
   - *Mbikëqyrja e zbatimit të tyre. Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre).*
4. Marrja e masave për të shprehur mendime dhe për të bërë propozime lidhur me draftet e akteve nënligjore, apo ndryshimeve në legjislacionin që mund të ndikojë në punën

[1]Shih shih nenin 42/ë të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[2]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[3]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[4]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

e prokurorisë dhe çdo çështje tjetër që është nën përgjegjësinë e prokurorisë, të njoftuara, apo kërkuara nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (2 pikë).

*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[1]:*

- *Qëndrimi aktiv në dhënien e mendimeve, propozimeve mbi draftet e akteve nënligjore, apo ligjore të kërkuara nga Këshilli. Organizimi i mbledhjeve, apo takimeve me prokurorët për të marrë mendimin e tyre lidhur me to;*
- *Marrja e nismave për të propozuar miratimin e akteve ligjore, apo nënligjore për të rregulluar punën e prokurorisë dhe çdo çështje tjetër që është nën përgjegjësinë e prokurorisë).*

5. Marrja e masave administrative-procedurale në zbatimin e akteve nënligjore të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre (2 pikë).

   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[2]:*

   - *Marrja e masave për njohjen e akteve nënligjore nga prokurorët dhe analizimi dhe diskutimi i tyre në mbledhjen e prokurorëve;*
   - *Marrja e masave për zbatimin e tyre në përshtatje me organizmin dhe funksionimin e prokurorisë që drejton, si dhe verifikimi i zbatimit të tyre, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre).*

6. Garantimi i zbatimit e vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm[3] (2 pikë).

   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[4]:*

   - *Marrja e masave për njohjen e vendimeve nga prokurorët, analizimi dhe diskutimi i tyre në mbledhjen e prokurorëve;*
   - *Marrja e masave për zbatimin e tyre në përshtatje me organizmin e funksionimin e prokurorisë që drejton, verifikimi i zbatimit të tyre, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.)*

7. Bashkërendimi i punës me Shkollën e Magjistraturës dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë për çështje që lidhen me rritjen profesionale të prokurorëve[5]. (2 pikë).

   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[6]:*

   - *Marrja e masave organizative, procedurale për të siguruar bashkëpunimin me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Shkollën e Magjistraturës, (normime procedurale-adminsitrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre);*
   - *Planifikimi i takimeve periodike brenda institucionit për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre).*

8. Bashkërendimi i punës me Shkollën e Magjistraturës dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë për çështje që lidhen me kandidatët për magjistrat[7]. (2 pikë).

   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[8]:*

---

[1]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

[2]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

[3]Shih shih nenin 42/g të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

[4]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

[5]Shih nenin 42/ë të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

[6]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

[7]Shih shih nenin 42/ë të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

[8]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

- *Marrja e masave organizative, procedurale për të siguruar bashkëpunimin me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Shkollën e Magjistraturës, (normime procedurale-adminsitrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre, krijimi i infrastrukturës për të lehtësuar përmbushjen e detyrimeve nga kandidatët për magjistrat);*
- *Planifikimi i takimeve periodike brenda institucionit për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre).*

9. Bashkërendimi i punës me Prokurorinë e Përgjithshme për çështje që lidhen me organizmin dhe funksionimin e sistemit të prokurorisë (2 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[1]:*
   - *Marrja e masave organizative, procedurale për të siguruar bashkëpunimin me Prokurorinë e Përgjithshme (normime procedurale administrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre);*
   - *Planifikimi i takimeve periodike brenda institucionit për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre).*
10. Bashkërendimi i punës me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për çështje që lidhen me hetimin disiplinor të prokurorëve[2] (2 pikë).
    *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[3]:*
    - *Marrja e masave organizative, procedurale për të siguruar bashkëpunimin me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (normime procedurale administrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre).*
    - *Planifikimi i takimeve periodike brenda institucionit për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre).*
11. Paraqitja e kërkesave drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kur gjatë ushtrimit të veprimtarisë mbikëqyrëse konstaton dhe vlerëson probleme tematike apo shkelje individuale, ose kur ka indicie, informacione ose ankesa për shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës nga prokurorët[4] (2 pikë).
    *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[5]:*
    - *Konstatimi i shkeljeve disiplinore dhe paraqitja e kërkesave pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;*
    - *Planifikimi i takimeve periodike brenda institucionit për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre).*
12. Marrja e masave për përforcimin e bashkëpunimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur ndërmjet tyre "Për kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike dhe për shkelje individuale të magjistratëve prokurorë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm" (2 pikë).
    *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[6]:*

---

[1]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[2]Shih nenin 42/ë të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[3]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[4]Shih nenin 42/dh të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[5]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[6]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

- *Marrja e masave për njohjen e marrëveshjes nga prokurorët, dhe analizimi dhe diskutimi i saj në mbledhjen e prokurorëve;*
- *Marrja e masave për zbatimin e tyre në përshtatje me organizmin e funksionimin e prokurorisë që drejton).*

13. Bashkërendimi i punës me drejtoritë përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Komisionin e Policisë Gjyqësore (2 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[1]:*
- *Marrja e masave organizative, procedurale për të siguruar bashkëpunimin me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Komisionin e Policisë Gjyqësore (normime procedurale-adminsitrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre) për çështje të veprimtarisë së policisë gjyqësore;*
- *Planifikimi i takimeve periodike brenda institucionit për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre).*

14. Informimi çdo tre muaj i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit[2] (2 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[3]:*
- *Marrja e masave organizative, procedurale për informimin e Prokurorit të Përgjithshëm çdo tre muaj për gjendjen e kriminalitetit. (normime procedurale-adminsitrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre);*
- *Planifikimi i takimeve periodike brenda institucionit për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre).*

15. Organizimi dhe koordinimi i takimeve periodike me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Ministrinë e Drejtësisë, Policinë e Shtetit, si dhe institucione të tjera ligjzbatuese (2 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[4]:*
- *Rëndësia, risitë, zhvillimet e fundit të jurisprudencës të sjella gjatë diskutimeve;*
- *Periodiciteti i arsyeshëm i zhvillimit të mbledhjeve).*

16. Organizimi i takimeve të planifikuara rregullisht me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare (2 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[5]:*
- *Rëndësia dhe natyra e çështjeve të ngritura gjatë diskutimeve;*
- *Periodiciteti i arsyeshëm i zhvillimit të mbledhjeve).*

17. Marrja e masave për të shprehur mendime dhe për të bërë propozime lidhur me draftet e akteve nënligjore, apo ndryshimeve në legjislacionin që mund të ndikojë në punën e prokurorisë dhe çdo çështje tjetër që është nën përgjegjësinë e prokurorisë, të njoftuara, apo kërkuara nga Ministria e Drejtësisë (2 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[6]:*

---

[1]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[2]Shih nenin 42 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[3]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[4]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e njëpike përkatëse.
[5]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e njëpike përkatëse.
[6]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

- *Qëndrimi aktiv në dhënien e mendimeve, propozimeve mbi draftet e akteve nënligjore, apo ligjore të kërkuara nga Ministria e Drejtësisë. Organizimi i mbledhjeve, apo takimeve me prokurorët për të marrë mendimin e tyre lidhur me to;*
- *Marrja e nismave për të propozuar miratimin e akteve ligjore, apo nënligjore për të rregulluar punën e prokurorisë dhe çdo çështje tjetër që është nën përgjegjësinë e prokurorisë).*

18. Bashkërendimi dhe koordinimi me efiçencë i veprimtarisë me Ministrinë e Drejtësisë dhe Prokurorinë e Përgjithshme lidhur me ndihmën e ndërsjellë juridike (2 pikë).
    *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[1]:*
    - *Marrja e masave organizative, procedurale për të siguruar bashkëpunimin me Ministrinë e Drejtësisë dhe Prokurorinë e Përgjithshme, (normime procedurale-administrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre);*
    - *Planifikimi i takimeve periodike brenda institucionit për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre).*
19. Bashkërendimi dhe koordinimi me efiçencë i veprimtarisë me prokuroritë e tjera, me iniciativë ose kur kërkohet në drejtimet/fushat ose për veprat penale prioritare të rekomanduara (2 pikë).
    *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[2]:*
    - *Marrja e masave organizative, procedurale për të siguruar bashkëpunimin me prokuroritë e tjera, (normime procedurale-adminsitrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre);*
    - *Planifikimi i takimeve periodike për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre).*
20. Marrja e masave për shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit me Kontrollin e Lartë të Shtetit (2 pikë).
    *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[3]:*
    - *Marrja e masave organizative, procedurale për të siguruar shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit me Kontrollin e Lartë të Shtetit, (normime procedurale-adminsitrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre);*
    - *Evidentimi i problematikave dhe masat për zgjidhjen e tyre).*
21. Organizimi dhe bashkërendimi i trajnimeve të përbashkëta dhe takimeve periodike ndërmjet KLSH-së dhe prokurorisë (2 pikë).
    *Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[4]:*
    - *Marrja e masave për të organizuar trajnime të përbashkëta me KLSH-në;*
    - *Planifikimi i punës për të lehtësuar pjesëmarrjen e prokurorëve dhe oficerëve në trajnime.)*
22. Nxjerra e udhëzimeve të përgjithshme, dhe/ose jo të detyrueshme për çështje konkrete, për hetimin e veprave penale të kallëzuara nga KLSH-ja (2 pikë).
    *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[5]:*

---

[1]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[2]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[3]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[4]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[5]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

- *Nxjerrja e udhëzimeve procedurale penale, apo lidhur me zbatimin e ligjit penal material, me qëllim unifikimin e praktikave brenda prokurorisë, ndjekja e zhvillimeve të legjislacioni, apo jurisprudencës, apo aplikimi i praktikave me të mira;*
- *Nxjerrja e udhëzimeve jo të detyrueshme me shkrim, të arsyetuara, të qarta për çështje konkrete. Ndjekja e zbatimit të tyre, si dhe efektiviteti i tyre).*

23. Bashkëpunimi në mënyre efektive me institucionet shtetërore dhe ligjzbatuese me rol të posaçëm në luftën kundër veprave penale prioritare të rekomanduara, si dhe të organizojnë dhe zhvillojnë analiza të përbashkëta ndërinstitucionale sipas nevojave dhe jo më pak se çdo gjashtë muaj[1] (2 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[2]:*
- *Marrja e masave organizative dhe procedurale për të siguruar bashkëpunimin në mënyrë efektive me institucionet shtetërore dhe ligjzbatuese me rol të posaçëm në luftën kundër veprave penale prioritare të rekomanduara (normime procedurale-adminsitrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre);*
- *Planifikimi i takimeve periodike dhe analizave të përbashkëta ndërinstitucionale sipas nevojave dhe jo më pak se çdo gjashtë muaj, për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre).*

24. Marrja e masave për përmirësimin më tej të efiçencës së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese palë në marrëveshje dy ose shumëpalëshe, si dhe në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet gjyqësore të huaja nëpërmjet Zyrës së Prokurorit ndërlidhës të Shqipërisë në Eurojust, veçanërisht për rritjen e numrit të skuadrave të përbashkëta hetimore dhe goditjen e veprimtarisë kriminale brenda dhe jashtë vendit (2 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[3]:*
- *Marrja e masave për përmirësimin më tej të efiçencës së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional (normime procedurale administrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre);*
- *Planifikimi i takimeve periodike dhe analizave të përbashkëta ndërinstitucionale, për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre);*

25. Të marrë masa për fuqizimin e bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale që lidhen sidomos me trafikimin e narkotikëve, pastrimit të parave, financimin e terrorizmit, trafikimin e qenieve njerëzore, krimeve mjedisore (2 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[4]:*
- *Marrja e masave për fuqizimin e bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale që lidhen sidomos me trafikimin e narkotikëve, pastrimit të parave, financimin e terrorizmit, trafikimin e qenieve njerëzore, krimeve mjedisore*

---

[1]Shih nenin 6 të udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 02 datë 12.05.2023 "Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokurorité e juridiksionit të përgjithshëm".
[2]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[3]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[4]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

*(normime procedurale administrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre);*
- *Planifikimi i takimeve periodike dhe analizave të përbashkëta ndërinstitucionale, për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre).*

| Shkalla e aftësisë së drejtuesit | Nr. i pikëve |
|---|---|
| Nën mesataren | 13 - 24 |
| Mesatare | 25 - 37 |
| Mbi mesatare | 38 - 50 |

**B. Komunikimin me publikun dhe të tretët, duke caktuar saktësisht oraret për pritjen e publikut, dokumentacionin e takimeve ose të shkresave për t'iu përgjigjur institucioneve të ndryshme (50 pikë).**

1. Marrja e masave për organizmin dhe funksionimin e shërbimeve për marrëdhëniet me publikun, të cilat kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtarinë e prokurorisë, si dhe për çështje të veçanta, duke zbatuar kërkesat ligjore për garantimin e sekretit dhe mbarëvajtjes së hetimit[1]. (5 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[2]:*
    - *Marrja e masave organizative, procedurale, administrative për funksionimin e shërbimet për marrëdhëniet me publikun;*
    - *Respektimi i parashikimeve ligjore dhe nënligjore për organizimin e shërbimeve;*
    - *Caktimi i prokurorit dhe nëpunësit civil për marrëdhëniet me publikun duke u bazuar tek specializimet e tij;*
    - *Mbarëvajtja e punës dhe marrjen e masave dhe veprimeve për të siguruar efikasitetin e shërbimeve;*
    - *Marrja e masave organizative për garantimin e sekretit dhe mbarëvajtjes së hetimit. Evidentimin e rasteve të shkeljes së sekretit hetimor dhe marrja e masave të duhura ligjore).*
2. Monitorimi i veprimtarisë së prokurorit të caktuar për marrëdhëniet me publikun për të garantuar efikasitetin dhe cilësinë e shërbimit të marrëdhënieve me publikun (5 pikë).
*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[3]:*

[1]Shih nenin 61 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[2]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e dy pikëve përkatëse.
[3]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

- *Normimi i aspekteve procedurale për ushtrimin e detyrave nga prokurori për marrëdhëniet me publikun, në drejtim të detyrave të ngarkuara dhe përmbushjes së tyre;*
- *Monitorimi i kthimit të përgjigjeve ndaj pyetjeve të mediave dhe personave të tjerë të interesuar, që kanë të bëjnë me një ngjarje aktuale, ose lidhur me një proces që ka filluar, është duke u zhvilluar, apo ka përfunduar pranë kësaj prokurorie;*
- *Monitorimi i reagimit kur në media, apo në publik është përhapur një informacion i pa drejtë, subjektiv, i njëanshëm, tendencioz, që mund të dëmtojë interesin e përgjithshëm të prokurorisë, integritetin profesional dhe moral të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore, të punonjësve të administratës të prokurorisë;*
- *Mbikëqyrja e bashkëpunimit ndërmjet, prokurorit të caktuar për marrëdhëniet me publikun, dhe prokurorit të çështjes, i cili duhet të jetë i ngushtë dhe në afatin sa më të shkurtër kohor, që t'i ofrojnë informacionin e kërkuar publikut;*
- *Planifikimi i takimeve periodike, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre).*

3. Marrja e masave administrative-procedurale për të garantuar që shërbimet e marrëdhënieve me publikun kryhen duke respektuar parimin për të drejtën e informimit, duke i kushtuar vëmendje mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë (5 pikë).
   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[1]:*
   - *Marrja e masave për krijimin, mbajtjen dhe bërjen publike të një regjistri të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre;*
   - *Përditësimi i tij çdo 3 muaj dhe publikimin në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe në mjediset e pritjes së publikut të prokurorisë;*
   - *Marrja e masave për të garantuar se dhënia e informacionit kryhet duke respektuar parimin për të drejtën e informimit, duke i kushtuar vëmendje mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë;*
   - *Marrja e masave shtesë për të parandaluar zbulimin e paligjshëm, shkatërrimin, dhe humbjen si në institucionin e prokurorisë, ashtu edhe gjatë transferimit të tyre, për të gjitha dokumentet e përpunuara në mënyrë manuale, të cilat përmbajnë të dhëna personale;*
   - *Marrja e masave shtesë për të garantuar që në rastet e transferimit automatik të dhënave personale, rrugët e transmetimit, ose dokumentet që përmbajnë këto të dhëna duhen koduar, duke përdorur mënyra dhe fuqi koduese në përputhje me rezultatin e vlerësimit të rreziqeve të kryera paraprakisht).*
4. Monitorimi i efikasitetit dhe cilësisë së shërbimit me marrëdhëniet me publikun nga nëpunësi civil në përputhje me ligjin "Për të drejtën e informimit"[2](5 pikë).

---

[1]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[2]Shih nenin 61 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

*(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[1]:*

- *Normimi i aspekteve procedurale për ushtrimin e detyrave nga nëpunësi civil për marrëdhëniet me publikun, në drejtim të detyrave të ngarkuara dhe përmbushjes së tyre;*
- *Monitorimi i kthimit të përgjigjeve ndaj pyetjeve të mediave dhe personave të tjerë të interesuar, që kanë të bëjnë me një ngjarje aktuale, ose lidhur me një proces që ka filluar, është duke u zhvilluar, apo ka përfunduar pranë kësaj prokurorie;*
- *Monitorimi i reagimit kur në media, apo në publik është përhapur një informacion i pa drejtë, subjektiv, i njëanshëm, tendencioz, që mund të dëmtojë interesin e përgjithshëm të prokurorisë, integritetin profesional dhe moral të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore, të punonjësve të administratës të prokurorisë;*
- *Mbikëqyrja e bashkëpunimit ndërmjet, nëpunësit të caktuar për marrëdhëniet me publikun, dhe prokurorit të çështjes, i cili duhet të jetë i ngushtë dhe në afatin sa më të shkurtër kohor, që t'i ofrojnë informacionin e kërkuar publikut;*
- *Planifikimi i takimeve periodike, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre).*

5. Marrja e masave organizative-administrative, si dhe mbikëqyrja e procedurës së brendshme të pranimit dhe trajtimit të kërkesave dhe mbajtjes së kontakteve me median (5 pikë).

   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[2]:*

   - *Marrja e masave organizative dhe administrative për rregullimin e procedurës së brendshme për trajtimin e kërkesave;*
   - *Marrja e masave organizative për mbajtjen e kontakteve me median;*
   - *Mbikëqyrja e procedurës së brendshme në mënyrë periodike;*
   - *Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre;*
   - *Cilësia e vendimmarrjeve për refuzimin e dhënies së informacionit.)*

6. Hartimi dhe dërgimi për media i komunikatave, sqarimeve, reagimeve, deklaratave, raporteve, dhe i publikimeve të shtypura dhe elektronike (5 pikë).

   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[3]:*

   - *Qëndrimi aktiv në hartimin dhe dërgimin për media i komunikatave, sqarimeve, reagimeve, deklaratave, raporteve, dhe i publikimeve të shtypura dhe elektronike;*
   - *Aftësia për të hartuar komunikatat, sqarimet, deklaratat, dhe aktet e tjera të publikuara. Qartësia, konçiziteti dhe kuptueshmëria. Përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës;*
   - *Aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë; Zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës;*
   - *Përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), paragrafëve dhe e strukturës së fjalisë për të*

---

[1]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[2]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[3]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.

*shprehur kuptimin; Përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë);*

- *Impakti publik i krijuar nga këto komunikime).*

7. Organizimi i konferencave për media, debateve, apo prezantimeve audiovizive publike, si dhe menaxhimi i vazhdueshëm i adresave elektronike zyrtare, ku adresohen të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe mediave ( 5 pikë).

   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[1]:*
   - *Qëndrimi aktiv në organizimin e konferencave për media, debateve, apo prezantimeve audiovizive publike;*
   - *Aftësia e prezantimit publik dhe niveli i argumentimit gjatë diskutimit, mënyra e moderimit të diskutimit;*
   - *Impakti publik i krijuar nga këto komunikime;*
   - *Marrja e masave për menaxhimin e vazhdueshëm të adresave elektronike zyrtare, ku adresohen të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe mediave;*
   - *Marrja e masave për strukturimin e monitorimit, me marrjen e një ankese nga persona fizikë ose juridikë ose një informacioni i lidhur me problematika të konstatuara nga ushtrimi i funksioneve në struktura të tjera, si dhe ndjekja procedurale sipas detyrave funksionale të parashikuara).*

8. Hartimi dhe zbatimi i planit të komunikimit publik dhe monitorimi i mediave (5 pikë).

   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[2]:*
   - *Marrja e masave për hartimin e planit të komunikimit publik;*
   - *Marrja e masave për zbatimin e planit të komunikimit publik;*
   - *Marrja e masave organizative dhe procedurale për monitorimin e mediave;*
   - *Problematikat e evidentuara gjatë monitorimit dhe zgjidhja e tyre;*
   - *Marrja e masave për përmirësimin dhe përditësimin e planit të komunikimit publik dhe monitorimit të medias).*

9. Marrja e masave administrative-rregullative për të garantuar qasjen e publikut në prokurori, duke përcaktuar, dhe bërë publike oraret për pritjen e publikut, dokumentacionin e takimeve ose të shkresave për t'iu përgjigjur institucioneve të ndryshme (5 pikë).

   *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[3]:*
   - *Marrja e masave konkrete administrative-rregullative për të garantuar qasjen e publikut në prokurori, duke përcaktuar, dhe bërë publike oraret për pritjen e publikut, dokumentacionin e takimeve;*
   - *Marrja e masave për ndjekjen dhe zgjidhjen e problematikave të evidentuara gjatë takimeve;*
   - *Marrja e masave për strukturimin e monitorimit, kthimit të përgjigjes ndaj shkresave të institucioneve të ndryshme;*
   - *Marrja e masave organizative për realizimin e mbikëqyrjes periodike të kthimit të përgjigjeve;*
   - *Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre).*

10. Hartimi i udhëzuesve, kodit etik për komunikimin publik (5 pikë).

    *(Vlerësimi për këtë indikator do të përqendrohet në elementët e mëposhtëm[4]:*

---

[1]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[2]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikëve përkatëse.
[3]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikës përkatëse.
[4]Mosplotësimi i një elementi passjell mosmarrjen e pikëve përkatëse.

- *Marrja e masave për hartimin e udhëzuesve për komunikimin publik;*
- *Marrja e masave për hartimin e kodit etik për komunikimin publik;*
- *Përgatitja dhe miratimi i programeve të transparencës;*
- *Monitorimi i zbatimit dhe përmirësimi i tyre;*
- *Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre).*

| **Shkalla e aftësisë së drejtuesit** | **Nr. i pikëve** |
|---|---|
| Nën mesataren | 13 - 24 |
| Mesatare | 25 - 37 |
| Mbi mesatare | 38 – 50 |

Pikëzimi dhe përcaktimi i cilësisë të veprimtarisë drejtuese për Kriterin II

| **Shkalla e aftësisë së drejtuesit Kriteri II** | **Nr. i pikëve** |
|---|---|
| Nën mesataren | 25 - 49 |
| Mesatare | 50 - 74 |
| Mbi mesatare | 75 - 100 |

**BURIMET E VLERËSIMIT**

Vlerësimi i veprimtarisë së drejtuesit bazohet në këto burime:
a) dosja personale e drejtuesit;
b) vlerësimi i kryer nga drejtuesi, i cili përmbush, në mënyrë të njëjtë, kriteret e vlerësimit të kryer nga magjistrati;
c) raportet vjetore të drejtuesit, ku pasqyrohen të dhënat e veprimtarisë financiare dhe procesverbalet e mbledhjeve vjetore të analizës së prokurorisë, si dhe raporti përkatës i përfaqësuesit të Këshillit në këto mbledhje, duke përfshirë edhe regjistrimin audio;
ç) çdo urdhër ose vendim i drejtuesit i nxjerrë në ushtrim të kompetencave për organizimin e prokurorëve ose të administratës të prokurorisë;
d) të dhëna statistikore për funksionimin e prokurorisë në pesë vitet e fundit;
dh) raportet e inspektimit të prokurorisë nga institucionet shtetërore;
e) çdo dokument, i cili tregon aftësitë e komunikimit të drejtuesit me publikun dhe të tretët;
ë) mendimi i dhomës vendore të avokatisë dhe të kryetarit të gjykatës ku ushtron funksionin drejtuesi i prokurorisë;
f) informacioni me shkrim nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera që vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e drejtuesit në veprimtari trajnuese për drejtimin dhe organizimin e prokurorisë;

g) të dhëna për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj drejtuesit në këtë cilësi, gjatë periudhës së vlerësimit;
gj) vendime përfundimtare për masa disiplinore, për shkak të pozicionit të drejtuesit, të dhëna gjatë periudhës së vlerësimit, pavarësisht nëse masa disiplinore është shuar ose jo;
h) kundërshtimet e drejtuesit dhe çdo procesverbal ose dokument i seancës dëgjimore gjatë procesit të vlerësimit;
i) çdo burim tjetër që evidenton veprimtarinë profesionale të drejtuesit (- mendimi i Prokurorit të Përgjithshëm për performancën e prokurorisë për periudhën e vlerësimit; - raportimet vjetore të Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvendin e Shqipërisë; - vlerësimi i Prokurorit të Përgjithshëm për funksionimin e policisë gjyqësore në atë prokurori për periudhën e vlerësimit dhe për organizimin dhe funksionimin administrativ të prokurorisë);
j) aktet e tjera të përcaktuara në këtë rregullore dhe anekset e saj.

**ANEKSI nr. 2**

**FORMULARI I VETËVLERËSIMIT TË DREJTUESIT TË PROKURORISË**

**Për periudhën 20__ - 20 ___**

---

**TË DHËNAT E DREJTUESIT TË PROKURORISË**

**Emri:**

**Mbiemri:**

**Datëlindja:**

**Vendbanimi:**

**Adresa e e-mailit zyrtar:**

**Adresa e e-mailit privat:**

**Numër telefoni:**

**Prokuroria:**

**Funksioni:**

---

**Formulari i vetëvlerësimit dhe hapat për plotësimin e tij.**

1. Formulari i vetëvlerësimit plotësohet nga drejtuesi i prokurorisë në zbatim të nenit 86 të ligjit nr.96/2016 "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*" *i ndryshuar* (Ligji për Statusin), dhe të nenit 17 të Rregullores "*Për vlerësimin e drejtuesit të prokurorisë të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm*".
2. Formulari i vetëvlerësimit është pjesë e akteve të vlerësimit dhe përbën burim vlerësimi në kuptim të nenit 82 të "*Ligjit për Statusin*" dhe të nenit 9 të Rregullores "*Për vlerësimin e drejtuesit të prokurorisë të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm*".
3. Drejtuesi plotëson formularin e vlerësimit, sipas rubrikave përkatëse, e nënshkruan atë dhe ia dorëzon relatorit brenda 3 (tre) javëve nga marrja e njoftimit mbi fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional.
4. Drejtuesi vetëvlerësohet sipas dy grup kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin "Për Statusin", duke përzgjedhur në mënyrë të pavarur vetëm njërën nga shkallët e

aftësisë për çdo tregues vlerësimi. Drejtuesi plotëson formularin e vetëvlerësimit duke marrë parasysh relacionet e tij periodike dhe mendimet vjetore të raportuesit.

5. Në pjesën dedikuar kritereve të vlerësimit *"aftësitë drejtuese dhe organizative"* dhe *"aftësitë komunikuese"* drejtuesi ka të drejtë të japë shpjegime dhe të argumentojë vetëvlerësimin e tij duke parashtruar të dhënat, kushtet faktike dhe arsyet që sipas tij/saj justifikojnë një shkallë më të lartë aftësie se ajo që rezulton nga burimet e vlerësimit.

## VLERËSIMI PËRKUNDREJT KRITEREVE VLERËSUESE

### 1. VLERËSIMI I AFTËSITË DREJTUESE DHE ORGANIZATIVE

***Me anë të këtij kriteri synohet të vlerësohet aftësia drejtuese, organizative, efektiviteti në vendimmarrje i drejtuesit të prokurorisë.***

**A. Mirorganizimin e prokurorisë në seksione**

| |
|---|
| **1. Marrja e masave për ngritjen e seksioneve bazuar ndër të tjera në mendimin e mbledhjes së përgjithshme, në numrin dhe specializimin e prokurorëve, llojin, përhapjen dhe kategoritë e veprave penale, subjekteve, si dhe në rekomandimet e Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit.**<br>*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: respektimi i procedurës ligjore për ngritjen e seksioneve dhe caktimin e drejtuesve të tyre; përcaktimi i prokurorëve në seksion në përshtatje me specializimet e tyre; Patundshmëria e lëvizjes nga seksioni.*<br><br>**2. Organizimi i punës dhe marrja e masave të nevojshme për mirëfunksionimin e prokurorisë në tërësi, duke respektuar më rigorizitet parashikimet ligjore, duke siguruar paanshmërinë, pavarësinë dhe efikasitetin e punës së prokurorisë.**<br><br>*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Respektimi i parashikimeve ligjore dhe nënligjore për organizmin e punës dhe funksionimin e prokurorisë në tërësi; Miratimi i rregulloreve, urdhrave, udhëzimeve të brendshme për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë; Mbarëvajtja e punës dhe marrjen e masave dhe veprimeve për të siguruar efikasitetin dhe ligjshmërinë e veprimtarisë së prokurorisë që drejton.*<br><br>**3. Organizimi i shpërndarjes së çështjeve prokurorëve, bazuar në kritere objektive dhe transparente, në përputhje me ligjin, si dhe sigurimi i përdorimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve në prokurori.**<br><br>*Në këtë indikator vlerësohen elementët si: Respektimi i parashikimeve ligjore dhe nënligjore për shpërndarjen e çështjeve prokurorëve me short; Normimi i aspekteve procedurale për organizmin dhe funksionimin e shpërndarjes së çështjeve me short, duke përcaktuar personat kompetent, përshkruar detyrat e secilit prej tyre dhe procedurën që ndiqet; Shpërndarja e ngarkesës në mënyrë të barabartë; Marrja e masave për të siguruar përdorimin e sistemit të* |

*menaxhimit të çështjeve në prokurori, duke bashkërenduar me Prokurorinë e Përgjithshëm; Përdorimi në çdo rast i shortit elektronik, dhe vetëm në raste përjashtimore të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore atë manual; Zbatimi i këtyre parashikimeve ligjore dhe nënligjore edhe në rastin e ushtrimit të ndjekjes penale nga drejtuesi i prokurorisë; Marrja e masave administrative për monitorimin e përditësimit të sistemeve elektronike PRESTO dhe SVHOPOW, saktësisë së të dhënave.*

**4. Mbikëqyrja dhe sigurimi i organizimit dhe funksionimit të administratës së prokurorisë, përpilimi i projektvendimit të vlerësimit, projekt raportit të vlerësimit, së bashku me vetëvlerësimin, si dhe marrja e mendimit me shkrim të të gjithë mbikëqyrësve per vlerësimin e nëpunësve civil.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Respektimi i parashikimeve ligjore dhe nënligjore për mënyrën e organizmit dhe funksionimit të administratës së prokurorisë; Normimi i aspekteve procedurale për organizmin dhe funksionimin e administratës, duke përcaktuar personat kompetent, përshkruar detyrat e secilit prej tyre dhe procedurën që ndiqet, dhe mënyrën e bashkëpunimit të sektorëve me njëri-tjetrin; Normimi i aspekteve procedurale të mbikëqyrjes periodikisht, duke përcaktuar personat kompetent, detyrat e tyre, mënyrën e mbikëqyrjes dhe adresimin, zgjidhja e problematikave të konstatuara, si dhe vlerësimi i performancës së tyre me objektivitet.*

**5. Drejtimi, bashkërendimi, mbikëqyrja dhe sigurimi i veprimtarisë së Policisë Gjyqësore, dhënia e urdhrave të detyrueshëm lidhur me ushtrimin e funksioneve, dhe përpilimi i raportit të vlerësimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Respektimi i parashikimeve ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe funksionimin e seksioneve të policisë gjyqësore në prokurori; Normimi i aspekteve procedurale-administrative të ushtrimit të veprimtarisë së seksionit të policisë gjyqësore; Respektimi i procedurës ligjore për caktimin e tyre në seksione në përshtatje me specializimet e tyre, si dhe patundshmëria e lëvizjes nga seksioni; Shpërndarja e ngarkesës në mënyrë të barabartë; Drejtimi dhe bashkërendimi i veprimtarisë së shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit, si dhe shërbimeve të tjera të Policisë Gjyqësore; Marrja e masave për mbikëqyrjen periodike të ushtrimit të veprimtarisë së policisë gjyqësore, adresimi dhe zgjidhja e problematikave, si dhe vlerësimi i performancës së tyre me objektivitet; Marrja e informacionit për veprimtarinë e oficerit dhe etikën, si dhe të dhëna statistikore për volumin e punës, shpejtësinë, cilësinë e akteve dhe problematikat e konstatuara në kryerjen e hetimeve.*

**6. Mbikëqyrja e disiplinës në punë, respektimit të etikës të prokurorit, planifikimin e punës së tyre, si dhe përmbushja e angazhimeve ligjore për vlerësimin profesional të prokurorëve.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Mbikëqyrja e disiplinës në punës, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre; Mbikëqyrja e respektimit të standardeve të etikës dhe rregullat e sjelljes nga prokurorët. Evidentimi i problematikave dhe adresimi i rasteve; Planifikimi i punës së prokurorëve, në përputhje me planin strategjik të institucionit, të*

*Prokurorisë së Përgjithshme, rekomandimet e Këshillit të Ministrave, rezolutës së Kuvendit; Marrja e masave për përmbushjen e angazhimeve ligjore për vlerësimin profesional, në bashkërendim më Këshillin; Objektiviteti dhe saktësia në dhënien e mendimit për veprimtarinë e magjistratit dhe vlerësimi i tij për këtë veprimtari, sipas kritereve të vlerësimit, duke u bazuar në nivelet e vlerësimit; Normimi i aspekteve administrative procedurale lidhur me paraqitjen, trajtimin dhe kthimin e përgjigjes për ankesat e bëra nga persona fizikë ose juridike, ose një informacioni i lidhur me problematika të konstatuara nga ushtrimi i veprimtarisë së prokurorisë.*

**7. Garantimi i zbatimit korrekt të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për njohjen e udhëzimeve nga prokurorët; Analizimi dhe diskutimi i tyre në mbledhjen e prokurorëve; Marrja e masave për zbatimin e tyre në përshtatje me organizmin dhe funksionimin e prokurorisë që drejton; Verifikimi i zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.*

**8. Kërkimi i informacionit për ecurinë e procedimeve, verifikimi i ecurisë dhe përfundimit e çështjeve.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Qëndrimi proaktiv në përmbushjen e detyrës nëpërmjet kërkimit të informacionit për ecurinë e procedimeve konkrete, në varësi të karakterit sensitiv të veprës penale, rëndësisë së çështjes. Pas shqyrtimit të informacionit, shprehja e qëndrimi të tij me anë të udhëzimeve me shkrim, si dhe ndjekja e zbatimit të tyre për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit. Përjashtimisht, kur rrethanat nuk e lejojnë, udhëzimet mund të jepen verbalisht dhe, brenda një kohe të arsyeshme, të konfirmohen me shkrim; Verifikimi periodik i ecurisë dhe përfundimit të çështjeve në funksion të respektimit të afateve procedurale ligjore. Analiza e problematikave të konstatuara dhe adresimi i tyre. Ndjekja në vijimësi e tyre. Nxjerra e udhëzimeve për kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake.*

**9. Nxjerrja e udhëzimeve të përgjithshme të natyrës administrative ose procedurale dhe udhëzimeve për çështje konkrete për prokurorët e prokurorisë përkatëse.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Nxjerrja e udhëzimeve të përgjithshme për çështje të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë, të karakterit administrativ; Nxjerrja e udhëzimeve procedurale penale, apo lidhur me zbatimin e ligjit penal material, me qëllim unifikimin e praktikave brenda prokurorisë, ndjekja e zhvillimeve të legjislacioni, apo jurisprudencës, apo aplikimi i praktikave më të mira; Nxjerrja e udhëzimeve jo të detyrueshme me shkrim, të arsyetuara, të qarta për çështje konkrete. Ndjekja e zbatimit të tyre, si dhe efektiviteti i tyre.*

**10. Marrja e masave administrative-procedurale, miratimi i udhëzimeve të përgjithshme dhe planit të veprimit për të siguruar zbatimin e rekomandimeve prioritare.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për njohjen, vlerësimin nga prokurorët dhe organizimi i mbledhjes për diskutim dhe dhënie mendimi për masat, aktivitetet dhe mënyrën e zbatimit; Miratimi i udhëzimeve të përgjithshme për të lehtësuar zbatimin e udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm. Miratimi i planit të veprimit, në kuadrin e planit të veprimit të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm; Marrja e masave organizative në drejtim të riorganizimit të brendshëm, forcimit të kapaciteteve institucionale e profesionale, monitorimin e zbatimit të tyre; Informimi në mënyre periodike i Prokurorisë së Përgjithshme për rezultatet e arritura.*

**11. Marrja e masave procedurale për nxitjen e hetimeve, nga drejtuesi i prokurorisë, apo prokurorët e tjerë në drejtimet prioritare të rekomanduara, duke përfshirë rastet e ndikimit të paligjshëm të brendshëm apo të jashtëm në veprimtarinë e prokurorit, efektiviteti në hetimin e pastrimit të produkteve të veprës penale, ose veprimtarisë kriminale, verifikimin e ecurisë dhe përfundimin e çështjeve për veprat penale prioritare të rekomanduara, duke monitoruar në veçanti, respektimin e afateve procedurale, rritjen e efektivitetit dhe plotshmërisë së hetimeve.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Nxjerrja e udhëzimeve të përgjithshme që sigurojnë zbatimin e rekomandimeve prioritare, garantojnë e lehtësojnë zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm; Nxjerrja e udhëzimeve jo të detyrueshme për çështje konkrete, në momentin e caktimit të çështjes për ndjekje, përfshi rastet e regjistruara kryesisht me iniciativën e tij apo të prokurorëve, ose kur vlerësohet e nevojshme për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit në hetimet paraprake ose në fazën e gjykimit, për vepra penale sipas kompetencës lëndore dhe në drejtimet prioritare të rekomanduara; Koordinimi i veprimtarisë me prokuroritë e tjera për çështje konkrete që lidhen me fushat/drejtimet prioritare të rekomanduara; Kërkimi i informacionit dhe verifikimi për ecurinë/përfundimin e procedimeve në hetimet paraprake ose në gjykim, për veprat penale prioritare të rekomanduara sipas ligjit dhe në kuadrin e forcimit të mekanizmit të kontrollit dhe llogaridhënies së prokurorit, duke garantuar paanshmërinë.*

**12. Përgatitja dhe saktësia e të dhënave të raportit vjetor mbi ecurinë e punës në prokurorinë përkatëse përgjatë vitit paraardhës.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Përgatitja e raportit vjetor sipas modelit të miratuar nga Prokuroria e Përgjithshme. Cilësia dhe detajimi i përmbajtjes së raportit; Verifikimi i saktësisë së të dhënave të paraqitura në raport; Kryerja e analizave të detajuara të temave, çështjeve, apo nënçështjeve, Nxjerrja e përfundimeve, evidentimi i problematikave.*

**13. Mbikëqyrja tematike, për grupvepra, ose seksione pranë prokurorisë, të cilat nga raportet dhe analizat e kryera, rezultojnë problematike në drejtim të efiçencës për kryerjen e hetimeve penale dhe/ose respektimin e kërkesave ligjore procedurale penale.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Nxjerrja e akteve nënligjore procedurale-administrative për këtë qëllim; Organizimi i verifikimeve, monitorimeve periodike me tematikë të përcaktuar me qëllim zgjidhjen e problematikave dhe rritjen e efiçencës dhe zbatimin e akteve*

*nënligjore të nxjerra për këtë qëllim; Organizimi i mbledhjeve të prokurorëve për të analizuar dhe trajtuar rezultatet e arritura; Informimi periodikisht i Prokurorisë së Përgjithshme për rezultatet e arritura.*

**14. Emërimi dhe koordinimi i punës me zëvendësdrejtuesin e prokurorisë dhe drejtuesit e seksioneve.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Respektimi i procedurës ligjore për emërimin e zëvendësdrejtuesit të prokurorisë dhe drejtuesit e seksioneve; Normimi i aspekteve procedurale për ushtrimin e detyrave nga zëvendësdrejtuesi i prokurorisë dhe drejtuesi i seksionit në rast mungese dhe me autorizim të drejtuesit, në drejtim të detyrave të ngarkuara dhe përmbushjes së tyre; Mbikëqyrja e ushtrimit të detyrave nga zëvendësdrejtuesi dhe drejtuesi i seksionit i prokurorisë për funksionimin e prokurorisë, për përfaqësimin e prokurorisë me të tretët, si dhe për detyrat tjetër të përcaktuara në udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm.*

**15. Zhvillimi i mbledhjeve tematike me prokurorët e seksioneve, prokurorët e caktuar për ndjekjen e çështjeve apo me drejtuesit e policisë gjyqësore të seksioneve apo të strukturave hetimore në shërbimet e Policisë Gjyqësore të caktuar për ecurinë në kryerjen e hetimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Organizimi i mbledhjeve, takimeve periodike me tematikë me prokurorët e seksioneve, prokurorët e caktuar për ndjekjen e çështjeve. Dokumentimi i këtyre mbledhjeve. Rëndësia e çështjeve të ngritura, përfundimet e arritura, masat e marra dhe efektiviteti i tyre; Organizimi i mbledhjeve, takimeve periodike me tematikë, me drejtuesit e policisë gjyqësore të seksioneve apo të strukturave hetimore në shërbimet e Policisë Gjyqësore të caktuar. Dokumentimi i këtyre mbledhjeve. Rëndësia e çështjeve të ngritura, përfundimet e arritura, masat e marra dhe efektiviteti i tyre.*

**16. Mbikëqyrja periodike e veprimtarisë së prokurorisë, edhe nëpërmjet analizës së treguesve të gjendjes së kriminalitetit, mbarëvajtjes së punës, efiçencës dhe efektivitetit në ushtrimin e ndjekjes penale sipas prioriteteve të rekomanduara, si dhe vlerësimit të performancës së prokurorisë që drejton.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Normimi i aspekteve procedurale-administrative lidhur me realizimin e analizës së treguesve të gjendjes së kriminalitetit. Përcaktimi i personave kompetent, i detyrave dhe përgjegjësive; Normimi i aspekteve procedurale-administrative për realizimin e mbikëqyrjes së mbarëvajtjes së punës, efiçencës dhe efektivitetit në ushtrimin e ndjekjes penale sipas prioriteteve të rekomanduara, si dhe vlerësimit të performancës së prokurorisë që drejton; Organizimi i mbledhjes së prokurorëve për të diskutuar mbi rezultatet e analizës dhe mbikëqyrjes, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.*

**17. Konstatimin, vlerësimin dhe verifikimin e shkeljeve individuale të evidentuara nga veprimtaria mbikëqyrëse, ose nga informacione, apo ankesa të ardhura në prokurorinë.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Konstatimi në kohë i problematikave gjatë veprimtarisë mbikëqyrëse, procedurat e ndjekura për vlerësimin, verifikimin e rasteve të evidentuara, dokumentimin e tyre, si dhe masat e marra. Trajtimi i shkeljeve disiplinore, duke përmbushur procedurat dhe kriteret ligjore.*

**18. Organizimi dhe koordinimi i veprimtarisë për të mbështetur viktimat e krimit, nxitja e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me organizatat e shoqërisë civile në kryerjen e trajnimeve, hartimin e protokolleve, strategjive dhe trajtimin e rasteve, në veçanti ku përfshihen viktimat e dhunës me bazë gjinore, me bazë urrejtje, trafikimit, krimeve seksuale.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave organizative për të ofruar mbështetje efektive të viktimave të krimit. Rregullimi me akte nënligjore i aspekteve procedurale dhe administrative; Ndërmarrja e nismave konkrete për të vendosur dhe forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe me organizatat e shoqërisë civile; Hartimi i protokollove dhe strategjive për trajtimin e rasteve; Monitorimi i zbatimit të tyre.*

**19. Marrja e masave për nxitjen e hetimit kryesisht nga drejtuesi i prokurorisë, apo prokurorët e tjerë në drejtimet prioritare të rekomanduara.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Normimi i aspekteve procedurale-administrative për fillimin e hetimit kryesisht nga prokurori, apo drejtuesi i prokurorisë; Marrja e masave për nxitjen e prokurorëve në fillimin e hetimeve kryesisht; Ndjekja e ecurisë së procedimeve të filluara kryesisht. Organizimi i mbledhjeve të prokurorëve për të analizuar problematikat e vërejtura gjatë ecurisë së këtyre procedimeve dhe zgjidhja e tyre.*

**20.Cilësia e vendimmarrjes sipas standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Aftësitë hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave; Aftësia për të interpretuar ligjin. Aftësia për të interpretuar ligjin e identifikuar, arsyetimi i tij për mënyrën e zbatimit të ligjit mbi çështjet konkrete për trajtim, apo pasqyrimi dhe/ose analizimi i të dhënave në zbatim dhe në përputhje me ligjin e identifikuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij; Aftësia për të zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale që kanë lidhje me interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjes për trajtim, në përpunimin e akteve dhe dokumenteve ligjorë, dhe/ose në arsyetimet me shkrim ose verbale, sipas rastit; Për aq sa është e mundur, aftësia për të analizuar jurisprudencën, praktikat me të mira, standardet ndërkombëtare, duke u përqendruar tek aftësia për të kërkuar, identifikuar, organizuar dhe përdorur jurisprudencën relevante për një çështje të caktuar, në mbështetje të një interpretimi të caktuar; Aftësia për të hartuar akte nënligjore. Zbatimi i teknikës legjislative. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria. Përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës; Aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë; Zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës; Përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), paragrafëve dhe e strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin; Përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë.*

*Si e vlerëson drejtuesi shkallën e aftësisë së tij?*

| Nën mesataren☐ | Mesatare☐ | Mbi mesataren☐ |
|---|---|---|

**Shpjegime** *(Këtu drejtuesi duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij gjatë periudhës së vlerësimit)*

**B. Planifikimin e prokurorëve për çështje të natyrës urgjente**

**1. Marrja e masave për organizimin, koordinimin dhe mbarëvajtjen e gatishmërisë në prokurorinë përkatëse.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Normimi administrativ-procedural i gatishmërisë në prokurori, lidhur me mënyrën e organizimit dhe funksionimit, njoftimit të drejtuesit të prokurorisë, detyrat e prokurorit të gatshëm, hyrjes në grafikun e gatishmërisë të drejtuesit; Monitorimi i mbarëvajtjes së gatishmërisë. Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre; Respektimi i parashikimeve ligjore lidhur me caktimin e çështjeve me të arrestuar, ose të ndaluar prokurorëve të gatshëm; Arsyetimi i rasteve të përjashtimit të prokurorit të gatshëm nga caktimi i çështjes.*

**2. Marrja e masave për organizimin, koordinimin dhe mbarëvajtjen e gatishmërisë në periudha para dhe pas zgjedhjeve.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Normimi administrativ-procedural i gatishmërisë në prokurori, lidhur me mënyrën e organizimit dhe funksionimit, njoftimit të drejtuesit të prokurorisë, detyrat e prokurorit të gatshëm, hyrjes në grafikun e gatishmërisë të drejtuesit, në zbatim të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm; Monitorimi i mbarëvajtjes së gatishmërisë. Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre; Respektimi i parashikimeve ligjore lidhur me caktimin e çështjeve me të arrestuar, ose të ndaluar prokurorëve të gatshëm; Arsyetimi i rasteve të përjashtimit të prokurorit të gatshëm nga caktimi i çështjes.*

**3. Ndjekja në dinamikë e ecurisë së këtyre çështjeve, si dhe nxjerrja udhëzimeve të përgjithshme të natyrës administrative ose procedurale.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Kërkimi i informacionit për ecurinë e procedimeve penale për krimin zgjedhor; Shprehja e qëndrimi i tij me anë të udhëzimeve me shkrim, si dhe ndjekja e zbatimit të tyre për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit. Përjashtimisht, kur rrethanat nuk e lejojnë, udhëzimet mund të jepen verbalisht dhe, brenda një kohe të arsyeshme, të konfirmohen me shkrim; Verifikimi periodik i ecurisë dhe përfundimit e çështjeve për krimet zgjedhore. Analiza e problematikave të konstatuara dhe adresimi i tyre. Ndjekja në vijimësi e tyre; Nxjerra e udhëzimeve jo të detyrueshme për kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake.*

**4. Krijimi i grupeve hetimore për çështje të veçanta.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: -Normimi aspekteve administrative-procedurale i krijimit të grupeve hetimore; Rastet e përfshirjes së drejtuesit në grupe hetimore dhe roli i tij; Monitorimi i mbarëvajtjes së grupeve hetimore. Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre;*

*Verifikimi periodik i ecurisë dhe përfundimit e çështjeve të hetuara me grup hetimor dhe nxjerra e udhëzimeve jo të detyrueshme përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake.*

**5. Marrja e masave për funksionimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me publikun për çështjet e natyrës urgjente.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Normimi aspekteve administrative-procedurale i bashkëpunimit me Policinë e Shtetit, shërbimet e tjera policore, policinë shkencore, për çështjet e natyrës urgjente; Normimi i aspekteve administrative-procedurale i bashkëpunimit me Prokurorinë e Përgjithshme, Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Gjykatën, për çështjet e natyrës urgjente; Miratimi i strategjisë së komunikimit me publikun për çështjet e natyrës urgjente; Monitorimi i mbarëvajtjes së bashkëpunimit. Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.*

***Si e vlerëson prokurori shkallën e aftësisë së tij?***

| Nën mesataren☐ | Mesatare☐ | Mbi mesataren☐ |
|---|---|---|

**Shpjegime** *(Këtu drejtuesi duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij gjatë periudhës së vlerësimit)*

**C. Zëvendësimin në kohë të prokurorëve që kanë pengesa në proces**

**1. Qëndrimi proaktiv i drejtuesit të prokurorisë për të vendosur mbi zëvendësimin e prokurorit kur ekzistojnë arsye serioze që lidhen me detyrën sipas ligjit.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për identifikimin e rasteve dhe zëvendësimin e prokurorit kur konstatohet shkelje ligjore serioze nga prokurori i çështjes; Respektimin e shortit në caktimin prokurorëve për çështjet e zëvendësuara.*

**2. Marrja e masave për zëvendësimin e prokurorit të çështjes, për shkak të mungesës ose paaftësisë së tij të përkohshme fizike për punë, nuk është në gjendje të ushtrojë funksionet apo të respektojë afatet ligjore.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për zëvendësimin e prokurorit për shkak të mungesës ose paaftësisë së tij të përkohshme fizike për punë, nuk është në gjendje të ushtrojë funksionet apo të respektojë afatet ligjore. Respektimin e shortit në caktimin prokurorëve për çështjet e zëvendësuara.*

**3. Marrja e masave organizative-administrative dhe trajtimi me uniformitet i deklarimeve për heqje dore, apo kërkesave për zëvendësimin e prokurorit.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave procedurale dhe administrative për trajtimin e deklarimeve për heqje dore, apo kërkesave për zëvendësimin e prokurorit; Trajtimi i rasteve me uniformitet.*

**4. Nxjerrja e udhëzimeve të përgjithshme për rregullimin e aspekteve procedurale të zëvendësimit të prokurorëve.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Nxjerrja e udhëzimeve të përgjithshme për rregullimin e aspekteve procedurale penale të zëvendësimit të prokurorëve; Zbatimi i këtyre i këtyre udhëzimeve.*

**5. Cilësia dhe arsyetimi ligjor i vendimmarrjeve.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Aftësitë hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave; Aftësia për të interpretuar ligjin. Aftësia për të interpretuar ligjin e identifikuar, arsyetimi i tij për mënyrën e zbatimit të ligjit mbi çështjet konkrete për trajtim, apo pasqyrimi dhe/ose analizimi i të dhënave në zbatim dhe në përputhje me ligjin e identifikuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij; Aftësia për të zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale që kanë lidhje me interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjes për trajtim, në përpunimin e akteve dhe dokumenteve ligjorë, dhe/ose në arsyetimet me shkrim ose verbale, sipas rastit; Për aq sa është e mundur, aftësia për të analizuar jurisprudencën, praktikat më të mira, standardet ndërkombëtare, duke u përqendruar tek aftësia për të kërkuar, identifikuar, organizuar dhe përdorur jurisprudencën relevante për një çështje të caktuar, në mbështetje të një interpretimi të caktuar; Aftësia për të hartuar akte nënligjore. Zbatimi i teknikës legjislative. Qartësia, konçiziteti dhe kuptueshmëria. Përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës; Aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë; Zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës; Përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), paragrafëve dhe e strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin; Përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë.*

***Si e vlerëson prokurori shkallën e aftësisë së tij?***

| | | |
|---|---|---|
| Nën mesataren☐ | Mesatare☐ | Mbi mesataren☐ |
| **Shpjegime** *(Këtu drejtuesi duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij gjatë periudhës së vlerësimit)* | | |

**D. Zhvillimin e mbledhjeve tematike për prokurorët**

**1. Zhvillimi periodik i mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve të zyrës që drejton për të diskutuar çështje me rëndësi për veprimtarinë e prokurorisë.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Respektimi i parashikimeve ligjore lidhur me procedurën e njoftimit dhe zhvillimit të mbledhjes; Periodiciteti i arsyeshëm i zhvillimit të mbledhjeve.*

**2. Organizimi i diskutimeve për çështje të natyrës profesionale.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Rëndësia, risitë, zhvillimet e fundit të jurisprudencës të sjella gjatë diskutimeve; Periodiciteti i arsyeshëm i zhvillimit të mbledhjeve.*

**3. Vlerësimi dhe marrja e masave për zbatim sipas mendimit të dhënë nga mbledhja e prokurorëve mbi rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë; lidhur me përshkrimet e punës të të gjitha kategorive të nëpunësve civilë dhe punonjësve të prokurorisë, për ngritjen e seksioneve, për strukturën dhe përbërjen e tyre; çdo çështje tjetër me rëndësi për veprimtarinë e prokurorisë, përfshirë ato që lidhen me disiplinimin, karrierën dhe trajnimin e prokurorëve dhe nëpunësve të prokurorisë.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Masat organizative, nënligjore, administrative, të marra nga drejtuesi i prokurorisë për të konkretizuar mendimin e shfaqur dhe të mirëpranuar në mbledhjen e përgjithshme; Mbikëqyrja e zbatimit të këtyre masave.*

**4. Diskutimi i raportit vjetor të prokurorisë**.

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Respektimi i parashikimeve ligjore lidhur me procedurën e njoftimit dhe zhvillimit të mbledhjes; Reflektimi në draft raport të mendimeve, diskutimeve të shfaqura gjatë mbledhjes.*

**5. Cilësia e akteve shoqëruese të njoftimit të mbledhjeve, e argumentimit, moderimit të diskutimit në mbledhje, e arritjes së përfundimeve, ndjekja në vijimësi e zgjidhjes së tyre.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Aftësia për të hartuar akte shoqëruese; Zbatimi i teknikës legjislative; Qartësia, konçiziteti dhe kuptueshmëria; Përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës; Aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë; Zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës; Përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), paragrafëve dhe e strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin; Përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë); Niveli i argumentimit gjatë diskutimit, mënyra e moderimit të diskutimit në mbledhje, nxjerrja e përfundimeve, dhe ndjekja në vijimësi e zgjidhjes së tyre.*

***Si e vlerëson prokurori shkallën e aftësisë së tij?***

| | | |
|---|---|---|
| Nën mesataren☐ | Mesatare☐ | Mbi mesataren☐ |

**Shpjegime** *(Këtu drejtuesi duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij gjatë periudhës së vlerësimit).*

**E. Planifikimin dhe përdorimin efikas të fondeve publike, sipas nevojave të prokurorisë**

**1. Marrja mendim nga mbledhja e përgjithshme e prokurorëve të zyrës mbi projektbuxhetin e prokurorisë përkatëse, si dhe mbi përdorimin e fondeve publike brenda vitit buxhetor ekonomik.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Respektimi i parashikimeve ligjore lidhur me procedurën e njoftimit dhe zhvillimit të mbledhjes; Reflektimi në draft buxhet të mendimeve dhe diskutimeve të shfaqura gjatë mbledhjes.*

**2. Marrja e masave për të rritur buxhetin e Prokurorisë me të ardhura nga donacione dhe çdo të ardhur tjetër të ligjshme.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si*: Normimi i aspekteve procedurale-administrative të lobimit, pranimit, dhe bërjes pjesë të buxhetit; Marrja e nismave për rritjen e buxhetit me donacione dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

**3. Qëndrimi proaktiv në adresimin dhe persistimin në zgjidhjen e problematikave lidhur me planifikimin dhe përdorimin e fondeve publike.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Masat e marra për të adresuar problematikat e konstatuara; Këmbëngulja në zgjidhjen e tyre.*

4. **Monitorimi i mbledhjes së të ardhurave nga shpenzimet procedurale dhe të ardhurave të tjera që rezultojnë nga veprimtaria e rregullt e prokurorisë.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Organizimi i monitorimit të mbledhjes të ardhurave nga shpenzimet procedurale; Problematikat e konstatuara dhe zgjidhja e tyre.*

5. **Marrja e masave për mbikëqyrjen e veprimtarisë financiare të prokurorisë.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Normimi i aspekteve procedurale-admnistrative për ushtrimin e mbikëqyrjes së brendshme të veprimtarisë financiare të prokurorisë; Problematikat e konstatuara dhe zgjidhja e tyre.*

***Si e vlerëson prokurori shkallën e aftësisë së tij?***

| Nën mesataren☐ | Mesatare☐ | Mbi mesataren☐ |
|---|---|---|

**Shpjegime** *(Këtu drejtuesi duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij gjatë periudhës së vlerësimit).*

F. **Mbikëqyrjen për efekt të përmirësimit të informacionit në faqen zyrtare të prokurorisë;**

1. **Përmirësimi i ndërfaqes web të prokurorisë në përputhje me programin e transparencës së përgatitur nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bashkuar në ligjin Nr. 119/2015 "Për të drejtën e informimit".**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave konkrete për përmirësimin e saj; Problematikat e konstatuara dhe zgjidhja e tyre.*

2. **Marrja e masave organizative për përditësimin dhe mirëmbajtjen e portalit unik.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Normimi i aspekteve procedurale-admnistrative për përditësimin dhe mirëmbajtjen e portalit unik; Problematikat e konstatuara dhe zgjidhja e tyre.*

3. **Vendosja në zbatim të programit institucional të transparencës, në të cilin përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave konkrete për përmirësimin e saj; Problematikat e konstatuara dhe zgjidhja e tyre.*

4. **Hartimi i strategjisë së komunikimit publik nëpërmjet faqes zyrtare.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Hartimi i strategjisë së komunikimit publik; Monitorimi i zbatimit të saj.*

5. **Monitorimi i përmbushjes së detyrave nga personeli përgjegjës, dhe marrja e masave për zgjidhjen e problematikave.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Normimi i aspekteve procedurale-admnistrative lidhur me ushtrimin e detyrave nga personat përgjegjës; Monitorimi i zbatimit të tyre, problematikat e konstatuara dhe zgjidhja e tyre.*

*Si e vlerëson prokurori shkallën e aftësisë së tij?*

| Nën mesataren☐ | Mesatare☐ | Mbi mesataren☐ |
|---|---|---|
| **Shpjegime** *(Këtu drejtuesi duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij gjatë periudhës së vlerësimit).* | | |

G. **Mbikëqyrjen, për krijimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori, në përputhje me nevojat e palëve e të publikut;**

1. **Marrja e masave për menaxhimin e objekteve dhe pasurisë së prokurorisë, si dhe monitorimi periodik.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin, dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi; Krijimi dhe përditësimi i regjistrit kontabël.*

2. **Marrja e masave për të përmirësuar kushtet e punës, ambjentet e zyrave, dhe infrastrukturën e prokurorisë, përfshirë marrjen e masave për garantimin e transportit me mjete zyrtare të prokurorëve në ushtrim të detyrave zyrtare, në veçanti kur godina e gjykatës është në largësi nga godina prokurorisë.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave konkrete për të përmirësuar kushtet e punës dhe infrastrukturën e prokurorisë; Marrja e masave për garantimin e transportit me mjete zyrtare të prokuroreve në ushtrim të detyrave zyrtare.*

3. **Marrja e masave për të garantuar parkimin dhe sigurinë për mjetet e prokurorisë dhe të prokurorëve të prokurorisë që drejton.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave konkrete për të garantuar parkimin dhe sigurinë e mjeteve të prokurorisë dhe të prokurorëve; Evidentimi i problematikave, këmbëngulja dhe zgjidhja e tyre.*

4. **Normimi i administrativ i përdorimit të automjeteve zyrtare, mbikëqyrja e përdorimit të tyre.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Përcaktimi i rregullave për përdorimin efikas dhe ekonomizimin e shpenzimeve për përdorimin e automjeteve zyrtare të prokurorisë; Monitorimi i zbatimit të tyre.*

5. **Marrja e masave për adresimin, dhe zgjidhjen e problematikave të ngritura nga prokurorët dhe personeli administrativ lidhur me ambjentet e punës.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Organizimi i monitorimeve periodike për evidentimin e problematikave, mbledhjeve dhe takimeve për bërjen prezent të problematikave nga prokurorët dhe personeli administrativ; Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.*

6. **Marrja e masave për të siguruar qasjen e publikut në prokurori, rritja e efikasitetit të shërbimit të administratës, caktimi i ditëve vizituese në godinë.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave konkrete për të lehtësuar aksesin e publikut, si dhe përmirësimi i shërbimeve të administratës; Mbikëqyrja periodike dhe evidentimi i problematikave; Caktimi i ditëve të caktuara për vizitimin e ambienteve të prokurorisë nga qytetarët. Rregullimi i aspekteve administrative dhe procedurale për këtë qëllim.*

7. **Marrja e masave për të garantuar qasjen e personave që nuk kuptojnë gjuhën shqipe, apo personave me aftësi të kufizuara në prokurori.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për të garantuar aksesin në prokurori dhe shërbimeve administrative për personat që nuk kuptojnë gjuhën shqipe; Krijimi i infrastrukturës, marrja e masave për të aksesuar prokurorinë dhe shërbimet ligjore të saj nga personat me aftësi të kufizuara.*

8. **Marrja e masave për vënien në funksionim dhe zbatimin e të drejtës së magjistratit për aplikimin e skemës së huamarrjes së kredisë për shtëpi. (1 pikë).**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave konkrete për të organizuar, koordinuar bashkëpunimin ndërinstitucional për vënien në funksionim dhe zbatimin e kësaj skeme; Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.*

9. **Marrja e masave për të siguruar qasjen në prokurori të viktimave të veprës penale, marrjen e kallëzimeve penale, apo të subjekteve të tjerë të procedurës penale në ushtrim të të drejtave dhe garancive procedurale.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave konkrete për të lehtësuar aksesin e viktimave të veprës penale; Monitorimi i zbatimit të detyrave nga koordinatori, psikologu dhe punonjësve të tjerë të prokurorisë për të garantuar respektimin e të drejtave procedurale të viktimave; Normimi i aspekteve procedurale dhe administrative për të garantuar marrjen e kallëzimeve penale në prokurori, si dhe monitorimi i zbatimit të tyre.*

10. **Marrja e masave për krijimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave konkrete për të krijuar ambiente të përshtatshme në prokurori për marrjen në pyetje të miturve. Afishimi publik në formë tabelare i të drejtave të tyre; Marrja e masave për garantimin e marrjes në pyetje me pajisje, mjete audiovizive).*

***Si e vlerëson prokurori shkallën e aftësisë së tij?***

| Nën mesataren☐ | Mesatare☐ | Mbi mesataren☐ |
|---|---|---|
| **Shpjegime** *(Këtu drejtuesi duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij gjatë periudhës së vlerësimit).* | | |

H. **Kujdeset për çështjet e ruajtjes dhe të sigurisë në prokurori**

1. **Marrja me masave për ruajtjen dhe sigurinë në prokurori.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave konkrete për zbatimin e legjislacionit në fuqi, të cilat rregullojnë ruajtjen dhe sigurinë në prokurori. Nxjerrja e urdhrave*

*dhe udhëzimeve për të lehtësuar zbatimin e tyre në prokurori; Monitorimi i zbatimit të tyre, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.*

2. **Miratimi i një politike për sigurinë e objektit/sigurinë në punë, si dhe përgatitja e programeve për menaxhimin e sigurisë dhe mbajtja të përditësuara.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Miratimi i një politike për sigurinë, si dhe përgatitja e programeve. Përcaktimi i përgjegjësive individuale dhe "të zinxhirit të komandës" për arritjen e objektivave sa i përket secilit funksion dhe secilit nivel të hierarkisë. Miratimi i një kalendar me afate kohore për arritjen e objektivave dhe një përcaktim të stafit dhe burimeve që do të përdoren për këtë qëllim; Monitorimi i zbatimit të tyre, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.*

3. **Përcaktimi i punonjësve të caktuar dhe trajnimi i tyre për çështje të sigurisë dhe marrja e masave për të garantuar që informacioni në lidhje me sigurinë t'iu komunikohet anëtarëve të stafit dhe nëpunësve të prokurorisë.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Normimi i rolit të anëtarëve të stafit, përgjegjësitë dhe kompetencat e tyre, organizimi dhe funksionimi, si dhe njohja me to e të gjithë stafit. Nënshkrimi i marrëveshjes së konfidencialitetit, dhe monitorimi i zbatimit të saj; Stafi i prokurorisë, të cilit i delegohen përgjegjësi në lidhje me sigurinë, duhet të marrë trajnimin e duhur me këto objektiva: Njohjen e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi; Njohjen e riskut për kërcënim ndaj prokurorisë dhe vulnerabilitetet e saj; Funksionimin e sistemit të menaxhimit të prokurorisë.*

4. **Vendosja dhe përditësimi i procedurave për trajtimin e duhur të të gjitha dokumenteve në prokurori, si dhe vendosja dhe zbatimi i rregullave dhe procedurave në lidhje me sigurinë e sistemeve të informacionit që janë të përshtatshme sa i përket konstatimeve të vulnerabilitetit, sidomos rregullave në lidhje me: Administrimin e sistemeve të informacionit; Ruajtjen dhe instalimin e pajisjeve të sigurisë; Ruajtjen dhe asgjësimin e mjeteve të ruajtjes së të dhënave.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Regjistrimi dhe të ruajtja në mjete të përshtatshme, si për shembull në letër apo në kompjuter, informacione që duhen: Për të përshkruar elementet e domosdoshme të sistemit të menaxhimit dhe ndërveprimeve të tyre; Për të identifikuar apo për të përcaktuar vendndodhjen e dokumentacioneve të korrespondencës. Dokumente në lidhje me informacione dhe/ose objekte delikate duhet të trajtohen nga disa rregulla specifike, të cilat përcaktojnë: – shkallën e sensitivitetit të informacionit; Nivelin e klasifikimit sipas shkallës së specifikuar të sensitivitetit; Personat/grupet të cilëve mund t'u qarkullohen dokumente të secilit nivel klasifikimi; Rregullat e identifikimit; Rregullat për lëshimin, riprodhimin, mbajtjen, ruajtjen dhe asgjësimin e informacioneve dhe/ose objekteve delikate; Vendosja dhe përditësimi i procedurave për trajtimin e duhur të të gjitha dokumenteve dhe të dhënave të nevojshme për të garantuar që: Të mund të përcaktohet vendndodhja e tyre; Të rishikohen dhe të ndryshohen në mënyrë sistematike nëse është e nevojshme dhe të miratohen sipas rregullave nga personat e autorizuar për këtë qëllim; Versionet aktuale të dokumenteve dhe të dhënave relevante të jenë të disponueshme në të gjitha vendndodhjet, ku kryhen operacione të domosdoshme për funksionimin normal të sistemit të menaxhimit të sigurisë; Dokumente dhe të dhënat e vjetruara të mund të tërhiqen në mënyrë të menjëhershme nga të gjitha vendet, ku ato janë të disponueshme për përdorim dhe të menaxhohen në mënyrë të tillë që të mos mund të përdoren*

*gabimisht; Dokumentet dhe të dhënat e arkivuara të mbajtura për qëllime juridike të mund të identifikohen dhe të sigurohen si duhet. Vendosja dhe zbatimi i rregullave dhe procedurave në lidhje me sigurinë e sistemeve të informacionit që janë të përshtatshme sa i përket konstatimeve të vulnerabilitetit, sidomos rregullave në lidhje me: Administrimin e sistemeve të informacionit; Ruajtjen dhe instalimin e pajisjeve të sigurisë; Ruajtjen dhe asgjësimin e mjeteve të ruajtjes së të dhënave.*

5. **Përcaktimi i aktiviteteve që përfshijnë vulnerabilitete të njohura dhe që duhen kontrolluar rreptësisht, si dhe përcaktimi dhe përditësimi i procedurave për identifikimin, parandalimin dhe diktimin e situatave të emergjencës dhe për të pasur kapacitet reagues të tillë që të mund të parandalohet, të diktohet ose të zbutet çdo sulm ndaj njerëzve, pronës apo informacioneve.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Përcaktimi i atyre aktivitete që përfshijnë vulnerabilitete të njohura dhe që duhen kontrolluar rreptësisht. Këto aktivitete duhet të planifikohen, me mirëmbajtjen dhe mbikëqyrjen e duhur, për të garantuar realizimin e tyre siç kërkohet: a) Duke përcaktuar dhe përditësuar procedurat në lidhje me ambiente dhe vendndodhje të tjera vulnerabël (grafik organizativ për çelësat, karta për kontrollin e aksesit); b) Duke përgatitur dhe duke përditësuar procedurat zyrtare që përcaktojnë sjelljen që duhet demonstruar në rast situatash kritike (mosfunksionim të sistemit të sigurisë që prek mbikëqyrjen, kontrollin e aksesit, etj.); c) Duke futur një sistem për të monitoruar autorizimet për aksesin e kontrolluar në ambiente të kufizuara dhe delikate (dhomat e provave, dhomën e serverëve, kamerave); d) Duke përcaktuar zonat e kontrolluara mbi bazën e fluksit të lëvizjeve dhe konstatimeve të pikave të dobëta; e) Duke përcaktuar procedura specifike për trajtimin e anëtarëve të publikut dhe personave nga jashtë prokurorisë, sidomos kur ata mund të jenë në kontakt me informacione dhe/ose materiale që konsiderohen sensitive. Mjetet e mbrojtjes dhe diktimit duhet t'i përshtaten nivelit të vulnerabilitetit. Sistemi në tërësi duhet të monitorohet nga punonjës kompetentë të caktuar për këtë qëllim; Marrja e masave me anë të cilave duhet: Të përcaktojë dhe të përditësojë procedura për identifikimin e situatave të emergjencës dhe për të pasur kapacitet reagues të tillë që të mund të parandalohet, të diktohet ose të zbutet çdo sulm ndaj njerëzve, pronës apo informacioneve; Të rishikojë procedurat për parandalimin dhe diktimin e situatave të emergjencës dhe të ofrojë kapacitet reagimi, sidomos pas një incidenti apo një emergjence.*

6. **Organizimi i simulime periodike, nga të cilat mund të nxirren mësime, si dhe përcaktimi dhe të përditësimit të një programi për audite periodike të sigurisë.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Organizimi i simulime periodike, nga të cilat mund të nxirren mësime. Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre; Përcaktimi dhe përditësimi i një program për audite periodike të sigurisë. Për të vendosur nëse mjetet e vlerësimit dhe menaxhimit dhe sistemi i menaxhimit të sigurisë: Përmbushin kërkesat për menaxhimin e sigurisë të përcaktuara nga autoriteti i lartë kompetent; Zbatohen dhe përditësohen siç duhet; Ndihmojnë zbatimin efektiv të politikave dhe objektivave të saj; Për të rishikuar konstatimet e auditimeve të mëparshme.*

7. **Marrja e masave për ndarjen e brendshme të ambienteve në zona sigurie, si dhe caktimi i një koordinatori për sigurinë, përgjegjës për kontrollin operacional dhe menaxhimin e mjeteve përkatëse.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Ndarja e brendshme e ambienteve në zona sigurie, ku të ketë rregulla përkatëse për të kontrolluar aksesin e tyre, si dhe rregulla për të organizuar aksesin mes këtyre zonave. Duhen përcaktuar oraret kur këto zona janë të hapura dhe të mbyllura, duke përfshirë veprimet procedurale që duhet të kryhen në orët e vona ose në fundjava. Pikat e kontrollit të publikut duhet të vendosen në hyrje të ndërtesës për të siguruar që ato nuk mund të shmangen në rast se synohet aksesi në këtë zonë të veçantë. Caktimi i një koordinatori për sigurinë, përgjegjëse për kontrollin operacional dhe menaxhimin e mjeteve përkatëse.*

**8. Krijimi i instrumenteve të menaxhimit dhe komunikimit në sektorin e sigurisë, si lista kontrolli dhe formularë incidentesh.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për krijimin e instrumenteve të menaxhimit dhe komunikimit në sektorin e sigurisë. Kryerja në mënyrë sistematike e inspektimeve fizike dhe kontrolleve të të gjitha lëvizjeve hyrëse dhe dalëse. Përdorimi i regjistrit të vizitorëve; Marrja e "masave të nevojshëm për garantimin e sigurisë" të personave që punojnë në objekt. Mangësitë e mundshme mund të identifikohen dhe të korrigjohen duke përdorur formularë për incidentet: të hartuara sa herë që një ngjarje prek sigurinë e prokurorisë (sulmet ndaj personave apo pronës); Dosje sigurie: dosje që për çdo prokurori të përmbajnë të gjitha dokumentet që lidhen me sigurinë duke ofruar një historik informacionesh rreth institucionit; Plan sigurie: përcakton masat që duhen marrë në prokurori për të garantuar një nivel të kënaqshëm sigurie. Plan veprimi.*

**9. Hartimi i planeve të ndërhyrjeve të njohura për të gjithë stafin.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Miratimi i Planit të Posaçëm të Mbrojtjes dhe Planit të Jashtëm të Mbrojtjes. Protokolli i përcaktuar duhet të përfshijë mundësi për njoftime sa më të hershme dhe identifikim të ngjarjeve të dyshimta, diktim të sinjaleve në shkallë të vogël që mund të tregojnë për zhvillime të papritura të situatës, njoftim të menjëhershëm të forcave të zbatimit të ligjit dhe vendosje të menjëhershme të objektit në gjendje emergjence; ato duhet të parashikojnë një lloj shkallëzimi për të marrë parasysh ndjeshmërinë që mund të kenë aktivitetet e planifikuara të prokurorisë; Miratimi i protokollit të ndërhyrjeve të forcave të zbatimit të ligjit dhe shërbimeve në raste emergjence, i cili të parashikojë në një kuadër të miratuar garantimin e ndërhyrjeve të forcave të zbatimit të ligjit dhe shërbimeve të emergjencës në rast njoftimi. Fushatat për ndërgjegjësimin e stafit. Për kategori të ndryshme të stafit duhet të bëhen prezantime periodike lidhur me rreziqet ndaj të cilave ata ekspozohen dhe mjeteve dhe masave ekzistuese për parandalimin e tyre. Në ato departamente ku ka më shumë gjasa të shfaqen sjellje agresive, duhet të merren masa për minimizimin e rrezikut të ekspozimit të stafit ndaj tyre: – programe për parandalimin e dhunës; – sisteme gjurmimi për më shumë transparencë për mënyrën e funksionimit të këtij shërbimi; – sisteme për këshillimin e stafit dhe mbështetjen e tij në raste incidentesh që lidhen me sigurinë; – vigjilencë aktive për identifikimin e situatave të rrezikshme; – çdo masë e posaçme që mund të integrohet në planifikimin lokal për mbrojtjen dhe sigurinë.*

**10. Zbatimi i politikës së ndërtesave dhe i një politikë për sigurinë nga zjarri.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për zbatimin e politikës së ndërtesës. Kjo politikë duhet të bazohet në njohjen e pronave aktuale dhe në një analizë të kërkesave për siguri në të ardhmen. Përcaktimi i objektivave të përmirësimit të objekteve dhe operacionet*

*prioritare që duhen kryer sipas një programi pune shumëvjeçare; Marrja e masave paraprake për organizimin e ndihmës së shpejtë, si dhe për mbrojtjen nga zjarri dhe evakuimin në rast emergjence; të përgatisë një plan evakuimi dhe shpëtimi në rast emergjence, t'ua shpërndajë atë punonjësve dhe të organizojë trajnime dhe simulime të parashikuara nga ky plan të paktën një herë në dy vjet; të caktojë të paktën një punonjës të trajnuar për ndihmën e shpejtë, për shuarjen e zjarrit; dhe për shpëtimin në një staf prej më shumë se 20 vetash, duhet të ketë të paktën dy punonjës të trajnuar. Rregulloret për rastet e zjarrit duhet gjithashtu të afishohen në godinë, ku të tregohet se si lajmërohet zjarrfikësja, si sigurohet hap pas hapi siguria personale, si përdoren pajisjet për fikjen e zjarrit dhe si pritet dhe ndihmohet zjarrfikësja. Këto rregulla duhet të afishohen së bashku me planin e evakuimit, ku identifikohen rrugëdaljet, vendndodhja e daljeve të emergjencës, si dhe vendndodhja e pajisjeve për fikjen e zjarrit. Këto rregulla duhet të afishohen në çdo kat të ndërtesës, afër dyerve, shkallëve dhe ashensorëve dhe duhet të pozicionohen në mënyrë të tillë që të mund të lexohen lehtësisht.*

***Si e vlerëson prokurori shkallën e aftësisë së tij?***

| Nën mesataren☐ | Mesatare☐ | Mbi mesataren☐ |
|---|---|---|

**Shpjegime** *(Këtu drejtuesi duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij gjatë periudhës së vlerësimit).*

**I. Organizimin e trajnimeve për prokurorët dhe punonjësit e prokurorisë.**

**1. Përfshirja e drejtuesit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë ose në trajnime profesionale për drejtimin dhe organizimin e prokurorisë.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Përfshirja e drejtuesit në veprimtari ndërinstitucionale (grupe pune, projekte, reforma etj) të cilat synojnë përmirësimin e sistemit të drejtësisë; Marrja pjesë në trajnime profesionale për drejtimin dhe organizimin e prokurorisë për të rritur nivelin profesional.*

**2. Koordinimi dhe organizimi i trajnimeve të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër veprave penale prioritare të rekomanduara, si dhe të lehtësojnë pjesëmarrjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në trajnime të përbashkëta me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit në fushat dhe drejtimet e rekomanduara.**

*Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për të organizuar trajnime të përbashkëta me Policinë e Shtetit, shërbimet e tjera gjyqësore, apo institucione të tjera; Planifikimi i punës për të lehtësuar pjesëmarrjen e prokurorëve dhe oficerëve në trajnime.*

**3. Marrja e masave për të garantuar pjesëmarrje të barabartë të prokurorëve dhe oficerëve në trajnime, dhe sipas specializimit të tyre, seksionit në të cilën ushtron detyrën ne veçanti në ato jashtë shtetit.**

*Kjo shkallë aftësie ndiqet nga një pikëzim, mbi të cilin përcaktohet cilësia e veprimtarisë drejtuese për çdonjërin nga dy kriteret e vlerësimit dhe mbi bazën e tyre konkludohet edhe për nivelin final të aftësive drejtuese të cilët i propozohen për miratim Mbledhjes Plenare. Projekt raporti i vlerësimit të aftësive drejtuese dhe organizative dhe aftyësive të komunikimit të drejtuesit të prokurorisë, hartohet bazuar në parashikimet e neneve 68 e vijues dhe 89 e vijues të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e prokurorëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (Ligji për Statusin)*[2]*, Rregulloren "Për vlerësimin e drejtuesit të prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm" dhe anekset përkatëse.*
*Me qëllim përcaktimin e shkallës/cilësisë së aftësisë së drejtuesit për çdo kriter, tregues, indikator (nëntregues), element, relatori bën analizë të integruar të të gjitha të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit.*

**NDARJA Ç**
**BURIMET E VLERËSIMIT**

*Në këtë rubrikë listohen burimet e vlerësimit sipas parashikimeve të nenit 82 të Ligjit nr.96/2016 "Për Statusin", dhe Rregullorës "Për vlerësimin e drejtuesve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm", të individualizuara për drejtuesin për tëcilin hartohet projektraporti.*

1. Burimi 1
2. Burimi 2
3. Burimi 3
4. ….

**NDARJA D**
**PROCEDURA**

[2]Në procedurën e vlerësimit të veprimtarisë së kryetarit nuk zbatohen nenet 86, pika 2, 87, 88, pika 2, 90, pika 1, dhe 91 të këtij ligji.

*Në këtë rubrikë përshkruhet, në rend kronologjik, procedura e ndjekur nga momenti i fillimit të procedurës së vlerësimit të aftësive drejtuese, organizative dhe të komunikimit të drejtuesit të prokurorisë, deri në momentin e hartimit të projektraportit të vlerësimit.*

**NDARJA E**
**PASQYRIMI DHE ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI**

*Në këtë rubrikë listohen burimet e vlerësimit, pasqyrohen dhe analizohen të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet shkalla e aftësisë/nivelit të veprimtarisë së drejtuesit për çdo kritër, tregues, nëntregues, element vlerësimi, bëhet pikëzimi dhe propozimi për nivelin e vlerësimit të drejtuesit për secilin nga dy kriteret e vlerësimit.*

**1. AFTËSITË DREJTUESE DHE ORGANIZATIVE**

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësitë drejtuese dhe organizative të drejtuesit të prokurorisë, vlerësuesi përqendrohet në dosjen personale, vlerësimi i kryer nga drejtuesi, raportet vjetore, raporti përkatës i përfaqësuesit të Këshillit duke përfshirë edhe regjistrimin audio, çdo urdhër ose vendim i drejtuesit i nxjerrë në ushtrim të kompetencave për organizimin e prokurorisë ose të administratës të prokurorisë, të dhëna statistikore për funksionimin e prokurorisë në pesë vitet e fundit, raportet e inspektimit të prokurorisë nga institucionet shtetërore, çdo dokument, i cili tregon aftësitë e komunikimit të drejtuesit me publikun dhe të tretët, mendimi i dhomës vendore të avokatisë dhe të kryetarit të gjykatës ku ushtron funksionin drejtuesi i prokurorisë, informacioni me shkrim nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera që vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e drejtuesit në veprimtari trajnuese për drejtimin dhe organizimin e prokurorisë, të dhëna për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj drejtuesit në këtë cilësi gjatë periudhës së vlerësimit, vendime përfundimtare për masa disiplinore, mendimi i Prokurorit të Përgjithshëm për performancën e prokurorisë për periudhën e vlerësimit, raportimet vjetore të Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvendin e Shqipërisë, mendimi i Prokurorit të Përgjithshëm për funksionimin e policisë gjyqësore në atë prokurori për periudhën e vlerësimit dhe për organizimin dhe funksionimin administrativ të prokurorisë.*

*Vlerësuesi çmon aftësitë e drejtuesit për organizimin e qartë të veprimtarive administrative, nëpërmjet dhënies së vendimeve dhe urdhrave për të siguruar respektimin e afateve dhe përdorimin sa më të mirë të burimeve të disponueshme, si dhe aksesin dhe transparencën në prokurori.*

**A. Mirorganizimin e prokurorisë në seksione**

| |
|---|
| ***Burimet e vlerësimit:***<br><br>**1.** Burimi 1;<br>**2.** Burimi 2;<br>**3.** ..... |
| ***Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:*** |

| |
|---|
| **Referuar burimit 1,** rezulton se ................<br><br>**Referuar burimit 2,** rezulton se ................ |
| ***Analiza e të dhënave***<br>*Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohen aftësitë e drejtuesit, në lidhje me indikatoret dhe elementet e secilit prej tyre si më poshtë:*<br>1. *Marrjen e masave për ngritjen e seksioneve, bazuar ndër të tjera në mendimin e mbledhjes së përgjithshme, në numrin dhe specializimin e prokurorëve, llojin, përhapjen dhe kategoritë e veprave penale, subjekteve, si dhe në rekomandimet e Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: respektimi i procedurës ligjore për ngritjen e seksioneve dhe caktimin e drejtuesve të tyre; përcaktimi i prokuroreve në seksion në përshtatje me specializimet e tyre; Patundshmeria e lëvizjes nga seksioni.*<br>2. *Organizimi i punës dhe marrja e masave të nevojshme për mirëfunksionimin e prokurorisë në tërësi, duke respektuar më rigorizitet parashikimet ligjore, duke siguruar paanshmërinë, pavarësinë dhe efikasitetin e punës së prokurorisë. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Respektimi i parashikimeve ligjore dhe nënligjore për organizmin e punës dhe funksionimin e prokurorisë në tërësi; Miratimi i rregulloreve, urdhërave, udhëzimeve të brendshme për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë; Mbarëvajtja e punës dhe marrjen e masave dhe veprimeve për të siguruar efikasitetin dhe ligjshmërinë e veprimtarisë së prokurorisë që drejton.*<br>3. *Organizimi i shpërndarjes së çështjeve prokurorëve, bazuar në kritere objektive dhe transparente, në përputhje me ligjin, si dhe sigurimi i përdorimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve në prokurori. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Respektimi i parashikimeve ligjore dhe nënligjore për shpërndarjen e ceshtjeve prokurorëve me short; Normimi i aspekteve procedurale për organizmin dhe funksionimin e shpërndarjes së çështjeve me short, duke përcaktuar personat kompetent, përshkruar detyrat e secilit prej tyre dhe procedurën që ndiqet; Shpërndarja e ngarkesës në mënyrë të barabartë; Marrja e masave për të siguruar përdorimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve në prokurori, duke bashkërenduar me Prokurorin e Përgjithshëm; Përdorimi në cdo rast i shortit elektronik, dhe vetëm në raste përjashtimore të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore atë manual; Zbatimi i këtyre parashikimeve ligjore dhe nënligjore edhe në rastin e ushtrimit të ndjekjes penale nga drejtuesi i prokurorisë; Marrja e masave administrative për monitorirnin e përditesimit të sistemeve elektronike PRESTO dhe SVHOPOW, saktësisë së të dhenave.*<br>4. *Mbikëqyrja dhe sigurimi i organizimit dhe funksionimit të administratës së prokurorisë, përpilimi i projektvendimit të vlerësimit, projektraportit të vlerësimit, së bashku me vetëvlerësimin, si dhe marrja e mendimit me shkrim të të gjithë mbikëqyrësve për vlerësimin e nëpunësve civilë. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Respektimi i parashikimeve ligjore dhe nënligjore për mënyrën e organizmit dhe funksionimit të administratës së prokurorisë; Normimi i aspekteve procedurale për organizmin dhe funksionimin e administratës, duke përcaktuar personat kompetent, përshkruar detyrat e secilit prej tyre dhe procedurën që ndiqet,* |

*dhe mënyrën e bashkëpunimit të sektorëve me njëri-tjetrin; Normimi i aspekteve procedurale të mbikqyrjes periodikisht, duke përcaktuar personat kompetent, detyrat e tyre, mënyrën e mbikqyrjes dhe adresimin, zgjidhja e problematikave të konstatuara, si dhe vlerësimi i përformacës së tyre me objektivitet.*

5. *Drejtimi, bashkërendimi, mbikëqyrja dhe sigurimi i veprimtarisë së Policisë Gjyqësore, dhënia e urdhrave të detyrueshëm lidhur me ushtrimin e funksioneve, dhe përpilimi i raportit të vlerësimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Respektimi i parashikimeve ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe funksionimin e seksioneve të policisë gjyqësore në prokurori; Normimi i aspekteve procedurale-administrative të ushtrimit të veprimtarisë së seksionit të policisë gjyqsore; Respektimi i procedurës ligjore për caktimin e tyre në seksione në përshtatje me specializimet e tyrë, si dhe patundshmëria e lëvizjes nga seksioni; Shpërndarja e ngarkesës në mënyrë të barabartë; Drejtimi dhe bashkërendimi i veprimtarisë së shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit, si dhe shërbimeve të tjera të Policisë Gjyqësore; Marrja e masave për mbikqyrjen periodike të ushtrimit të veprimtarisë së policisë gjyqësore, adresimi dhe zgjidhja e problematikave, si dhe vlerësimi i përformacës së tyre me objektivitet; Marrja e informacionit për veprimtarinë e oficerit dhe etikën, si dhe të dhëna statistikore për volumin e punës, shpejtësinë, cilësinë e akteve dhe problematikat e konstatuara në kryerjen e hetimeve.*
6. *Mbikëqyrja e disiplinës në punë, respektimit të etikës të prokurorit, planifikimin e punës së tyre, si dhe përmbushja e angazhimeve ligjore për vlerësimin profesional të prokurorëve. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Mbikqyrja e disiplinës në punë, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre; Mbikqyrja e respektimit të standardeve të etikës dhe rregullat e sjelljes nga prokurorët. Evidentimi i problematikave dhe adresimi i rasteve; Planifikimi i punës së prokurorëve, në përputhje me planin stratëgjik të institucionit, të Prokurorisë së Përgjithshme, rekomandimet e Këshillit të Ministrave, rezolutës së Kuvendit; Marrja e masave për përmbushjen e angazhimeve ligjore për vlerësimin profesional, në bashkërendim më Këshillin; Objektiviteti dhe saktësia në dhënien e mendimit për veprimtarinë e magjistratit dhe vlerësimi i tij për këtë veprimtari, sipas kritereve të vlerësimit, duke u bazuar në nivelet e vlerësimit; Normimi i aspekteve administrative procedurale lidhur me paraqitjen, trajtimin dhe kthimin e përgjigjes për ankesat e bëra nga persona fizikë ose juridike, ose një informacioni i lidhur me problematika të konstatuara nga ushtrimi i veprimtarisë së prokurorisë.*
7. *Garantimi i zbatimit korrekt të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për njohjen e udhëzimeve nga prokurorët; Analizimi dhe diskutimi i tyre në mbledhjen e prokurorëve; Marrja e masave për zbatimin e tyre në përshtatje me organizmin dhe funksionimin e prokurorisë që drejton; Verifikimi i zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.*
8. *Kërkimi i informacionit për ecurinë e procedimeve, verifikimi i ecurisë dhe përfundimit të çështjeve. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Qëndrimi proaktiv në përmbushjen e detyrës nëpërmjet kërkimit të informacionit për ecurinë e procedimeve konkrete, në varësi të karakterit sensitiv të veprës penale, rëndësisë së çështjes. Pas shqyrtimit të informacionit, shprehja e qëndrimit të tij me anë të*

*udhëzimeve me shkrim, si dhe ndjekja e zbatimit të tyre për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit. Përjashtimisht, kur rrethanat nuk e lejojnë, udhëzimet mund të jepen verbalisht dhe, brenda një kohe të arsyeshme, të konfirmohen me shkrim; Verifikimi periodik i ecurisë dhe përfundimit të çështjeve në funksion të respektimit të afateve procedurale ligjore. Analiza e problematikave të konstatuara, adresimi i tyre dhe ndjekja në vijimësi e tyre. Nxjerra e udhezimeve për kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake.*

9. *Nxjerrja udhëzimeve të përgjithshme të natyrës administrative ose procedurale dhe udhëzimeve për çështje konkrete për prokurorët e prokurorisë përkatëse. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Nxjerrja e udhëzimeve të përgjithshme për çështje të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë, të karakterit administrativ; Nxjerrja e udhëzimeve procedurale penale, apo lidhur me zbatimin e ligjit penal material, me qëllim unifikimin e praktikave brenda prokurorisë, ndjekja e zhvillimeve të legjislacionit, apo jurisprudencës, apo aplikimi i praktikave më të mira; Nxjerrja e udhëzimeve jo të detyrueshme me shkrim, të arsyetuara, të qarta për çështje konkrete. Ndjekja e zbatimit të tyre, si dhe efektivitetit të tyre.*
10. *Marrja e masave administrative-procedurale, miratimi i udhëzimeve të përgjithshme dhe planit të veprimit për të siguruar zbatimin e rekomandimeve prioritare. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për njohjen, vlerësimin nga prokurorët, organizimi i mbledhjes për diskutim, dhënie mendimi për masat, aktivitetet dhe mënyrën e zbatimit; Miratimi i udhëzimeve të përgjithshme për të lehtësuar zbatimin e udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm. Miratimi i planit të veprimit, në kuadrin e planit të veprimit të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm; Marrja e masave organizative në drejtim të riorganizimit të brendshëm, forcimit të kapaciteteve institucionale e profesionale, monitorimin e zbatimit të tyre; Informimi në mënyrë periodike i Prokurorisë së Përgjithshme për rezultatet e arritura.*
11. *Marrja e masave procedurale për nxitjen e hetimeve, nga drejtuesi i prokurorisë, apo prokurët e tjerë në drejtimet prioritare të rekomanduara, duke përfshirë rastet e ndikimit të paligjshëm të brendshëm apo të jashtëm në veprimtarinë e prokurorit, efektivieti në hetimin e pastrimit të produkteve të vepres penale, ose veprimtarisë kriminale, verifikimin e ecurisë dhe përfundimin e çështjeve për veprat penale prioritare të rekomanduara, duke monitoruar në veçanti, respektimin e afateve procedurale, rritjen e efektivitetit dhe plotshmërisë së hetimeve. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Nxjerrja e udhëzimeve të përgjithshme që sigurojnë zbatimin e rekomandimeve prioritare, garantojnë e lehtësojnë zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm; Nxjerrja e udhëzimeve jo të detyrueshme për çështje konkete, në momentin e caktimit të çështjes për ndjekje, përfshi rastet e regjistruara kryesisht me iniciativën e tij apo të prokurorëve, ose kur vlerësohet e nevojshme për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit në hetimet paraprake ose në fazën e gjykimit, për vepra penale sipas kompetenës lëndore dhe në drejtimet prioritare të rekomanduara; Koordinimi i veprimtarisë me prokuroritë e tjera për çështje konkrete që lidhen me fushat/drejtimet prioritare të rekomanduara; Kërkimi i infomacionit dhe verifikimi për ecurinë/përfundimin e procedimeve në hetimet paraprake ose nëgjykim, për veprat penale prioritare të rekomanduara sipas ligjit dhe*

*në kuadrin e forcimit të mekanizmit të kontrollit dhe llogaridhënies së prokurorit, duke garantuar paanshmërinë.*

12. *Përgatitja dhe saktësia e të dhënave të raportit vjetor mbi ecurinë e punës në prokurorinë përkatëse përgjatë vitit paraardhës. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Përgatitja e raportit vjetor sipas modelit të miratuar nga Prokuroria e Përgjithshme. Cilësia dhe detajimi i përmbajtjes së raportit; Verifikimi i saktësisë së të dhënave të paraqitura në raport; Kryerja e analizave të detajuara të temave, çështjeve, apo nënçështjeve, Nxjerrja e përfundimeve, evidentimi i problematikave.*
13. *Mbikëqyrja tematike, për grupvepra, ose seksione pranë prokurorisë, të cilat nga raportet dhe analizat e kryera, rezultojnë problematike në drejtim të eficencës për kryerjen e hetimeve penale dhe/ose respektimin e kërkesave ligjore procedurale penale. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Nxjerrja e akteve nënligjore procedurale-administrative për këtë qëllim; Organizimi i verifikimeve, monitorimeve periodike me tematikë të përcaktuar me qëllim zgjidhjen e problematikave dhe rritjen e efiçensës dhe zbatimin e akteve nënligjore të nxjerra për këtë qëllim; Organizimi i mbledhjeve të prokuroreve për të analizuar dhe trajtuar rezultatet e arritura; Informimi përiodikisht i Prokurorisë së Përgjithshme për rezultatet e arritura.*
14. *Emërimi dhe koordinimi i punës me zëvendësdrejtuesin e prokurorisë dhe drejtuesit e seksioneve. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Respektimi i procedurës ligjore për emerimin e zëvendësdrejtuesit të prokurorisë dhe drejtuesit e seksioneve; Normimi i aspekteve procedurale për ushtrimin e detyrave nga zëvendësdrejtuesi i prokurorisë dhe drejtuesi i seksionit në rast mungese dhe me autorizim të drejtuesit, në drejtim të detyrave të ngarkuara dhe përmbushjes së tyre; Mbikqyrja e ushtrimit të detyrave nga zëvendësdrejtuesi dhe drejtuesi i seksionit i prokurorisë për funksionimin e prokurorisë, për përfaqësimin e prokurorisë me të tretët, si dhe për detyrat tjetër të përcaktuara në udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm.*
15. *Zhvillimi i mbledhjeve tematike me prokurorët e seksioneve, prokurorët e caktuar për ndjekjen e çështjeve apo me drejtuesit e policisë gjyqësore të seksioneve apo të strukturave hetimore në shërbimet e Policisë Gjyqësore të caktuar për ecurinë në kryerjen e hetimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Organizimi i mbledhjeve, takimeve periodike me tematikë me prokurorët e seksioneve, prokurorët e caktuar për ndjekjen e çështjeve. Dokumentimi i këtyre mbledhjeve. Rëndësia e çështjeve të ngritura, përfundimet e arritura, masat e marra dhe efiktiviteti i tyre; Organizimi i mbledhjeve, takimeve periodike me tematikë me drejtuesit e policisë gjyqësore të seksioneve apo të strukturave hetimore në shërbimet e Policisë Gjyqësore të caktuar. Dokumentimi i këtyre mbledhjeve. Rëndësia e çështjeve të ngritura, përfundimet e arritura, masat e marra dhe efiktiviteti i tyre.*
16. *Mbikëqyrja periodike e veprimtarisë së prokurorisë, edhe nëpërmjet analizes se treguesve të gjendjes së kriminalitetit, mbarëvajtjes së punës, efiçencës dhe efektivitetit në ushtrimin e ndjekjes penale sipas prioriteteve të rekomanduara, si dhe vlerësimit të performancës së prokurorisë që drejton. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Normimi i aspekteve procedurale-administrative lidhur me realizimin e analizës së treguesve të gjendjes së kriminalitetit. Përcaktimi i personave kompetent, i detyrave dhe përgjegjësive; Normimi i aspekteve procedurale administrative për realizimin e mbikqyrjes së mbarëvajtjes së punes, efiçencës dhe efektivitetit në*

*ushtrimin e ndjekjen penale sipas prioriteteve te rekomanduara, si dhe vlerësimit të performancës së prokurorise që drejton; Organizimi i mbledhjes së prokurorëve për të diskutuar mbi rezultatet e analizës dhe mbikqyrjes, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.*

17. *Konstatimin, vlerësimin dhe verifikimin e shkeljeve individuale të evidentuara nga veprimtaria mbikqyrëse, ose nga informacione, apo ankesa të ardhura në prokurori. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Konstatimi në kohë i problematikave gjatë veprimtarisë mbikqyrëse, procedurat e ndjekura për vlësimin, verifikimin e rasteve të evidentuara, dokumentimin e tyre, si dhe masat e marra. Trajtimi i shkeljeve disiplinore, duke përmbushur procedurat dhe kriteret ligjore.*
18. *Organizimi dhe koordinimi i veprimtarisë për të mbështetur viktimat e krimit, nxitja e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me organizatat e shoqërisë civile në kryerjen e trajnimeve, hartimin e protokollove, strategjive dhe trajtimin e rasteve, në veçanti ku përfshihen viktimat e dhunës me bazë gjinore, me bazë urrejtje, trafikimit, krimeve seksuale. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave organizative për të ofruar mbështetje efektive viktimave të krimit. Rregullimi me akte nënligjore i aspekteve procedurale dhe administrative; Ndërmarrja e nismave konkrete për të vendosur dhe forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe me organizatat e shoqërisë civile; Hartimi i protokollove dhe strategjive për trajtimin e rasteve; Monitorimi i zbatimit të tyre.*
19. *Marrja e masave për nxitjen e hetimit kryesisht nga drejtuesi i prokurorisë, apo prokurët e tjerë në drejtimet prioritare të rekomanduara. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Normimi i aspekteve procedurale-administrative për fillimin e hetimit kryesisht nga prokurori, apo drejtuesi i prokurorisë; Marrja e masave për nxitjen e prokurorëve në fillimin e hetimeve kryesisht; Ndjekja e ecurisë së procedimeve të filluara kryesisht. Organizimi i mbledhjeve të prokurorëve për të analizuar problematikat e vërejtura gjatë ecurisë së këtyre procedimeve dhe zgjidhja e tyre.*
20. *Cilësia e vendimmarrjes sipas standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Aftësitë hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave; Aftësia për të interpretuar ligjin. Aftësia për të interpretuar ligjin e identifikuar, arsyetimi i tij për mënyrën e zbatimit të ligjit mbi çështjet konkrete për trajtim, apo pasqyrimi dhe/ose analizimi i të dhënave në zbatim dhe në përputhje me ligjin e identifikuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij; Aftësia për të zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale që kanë lidhje me interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjes për trajtim, në përpunimin e akteve dhe dokumentave ligjorë, dhe/ose në arsyetimet me shkrim ose verbale, sipas rastit; Për aq sa është e mundur, aftësia për të analizuar jurisprudencën, praktikat me të mira, standartet ndërkombëtare, duke u përqëndruar tek aftësia për të kërkuar, identifikuar, organizuar dhe përdorur jurisprudencën relevante për një çështje të caktuar, në mbështetje të një interpretimi të caktuar; Aftësia për të hartuar akte nënligjore. Zbatimi i teknikës legjislative. Qartësia, konçiziteti dhe kuptueshmëria. Përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës; Aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë; Zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës; Përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit*

| |
|---|
| *shqip (ë dhe ç), paragrafëve dhe e strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin; Përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë.* |
| ***Shkalla e aftësisë së drejtuesit dhe pikëzimi***<br>*(Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën (cilësinë) e aftësisë së drejtuesit dhe pikët e propozuara për këtë tregues).* |

**B. Planifikimin e prokurorëve për çështje të natyrës urgjente**

| |
|---|
| ***Burimet e vlerësimit:***<br><br>**1.** Burimi 1;<br>**2.** Burimi 2;<br>**3.** ..... |
| ***Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:***<br><br>**Referuar burimit 1,** rezulton se ................<br><br>**Referuar burimit 2,** rezulton se ................ |
| ***Analiza e të dhënave***<br>*Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohen aftësitë e drejtuesit, në lidhje me indikatorët dhe elementet e secilit prej tyre si më poshtë:*<br>1. *Marrja e masave për organizimin, koordinimin dhe mbarëvajtjen e gadishmerisë në prokurorinë përkatëse. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Normimi administrativ-procedural i gadishmerisë në prokurori, lidhur me mënyrën e organizimit dhe funksionimit, njoftimit të drejtuesit të prokurorisë, detyrat e prokurorit të gatshëm, hyrjes në grafikun e gadishmerisë të drejtuesit; Monitorimi i mbarëvajtjes së gadishmerisë. Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre; Respektimi i parashikimeve ligjore lidhur me caktimin e çështjeve me të arrestuar ose të ndaluar, të prokurorëve të gatshëm; Arsyetimi i rasteve të përjashtimit të prokurorit të gatshëm nga caktimi i çështjes.*<br>2. *Marrja e masave për organizimin, koordinimin dhe mbarëvajtjen e gadishmerisë në përiudha para dhe pas zgjedhjeve. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Normimi administrativ-procedural i gadishmerisë në prokurori, lidhur me mënyrën e organizimit dhe funksionimit, njoftimit të drejtuesit të prokurorisë, detyrat e prokurorit të gatshëm, hyrjes në grafikun e gadishmerisë të drejtuesit, në zbatim të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm; Monitorimi i mbarëvajtjes së gadishmerisë. Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre; Respektimi i parashikimeve ligjore lidhur me caktimin e çështjeve me të arrestuar ose të ndaluar, të prokurorëve të gatshëm; Arsyetimi i rasteve të përjashtimit të prokurorit të gatshëm nga caktimi i çështjes.* |

3. *Ndjekja në dinamike ecurisë së këtyre çështjeve, si dhe nxjerrja udhëzimeve të përgjithshme të natyrës administrative ose procedurale. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Kërkimi i informacionit për ecurinë e procedimeve penale për krimin zgjedhor; Shprehja e qëndrimi i tij me anë të udhëzimeve me shkrim, si dhe ndjekja e zbatimit të tyre për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit. Përjashtimisht, kur rrethanat nuk e lejojnë, udhëzimet mund të jepen verbalisht dhe, brenda një kohe të arsyeshme, të konfirmohen me shkrim; Verifikimi periodik i ecurisë dhe përfundimit të çështjeve për krimet zgjedhore. Analiza e problematikave të konstatuara dhe adresimi i tyre. Ndjekja në vijimësi e tyre; Nxjerra e udhëzimeve jo të detyrueshme për kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake.*
4. *Krijimi i grupeve hetimore për çështje të veçanta. Në këtë indikator vlerësohen elementet si - Normimi i aspekteve administrative-procedurale i krijimit të grupeve hetimore; Rastet e përfshirjes së drejtuesit në grupe hetimore dhe roli i tij; Monitorimi i mbarëvajtjes së grupeve hetimore. Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre; Verifikimi periodik i ecurisë dhe përfundimit të çështjeve të hetuara me grup hetimor dhe nxjerra e urdhëzimeve jo të dëtyrueshme përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake.*
5. *Marrja e masave për funksionimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me publikun për çështjet e natyrës urgjente. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Normimi aspekteve administrative-procedurale i bashkëpunimit me Policinë e Shtetit, shërbimet e tjera policore, policinë shkencore, për çështjet e natyrës urgjente; Normimi i aspekteve administrative-procedurale i bashkëpunimit me Prokurinë e Përgjithshme, Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Gjykatën, për çështjet e natyrës urgjente; Miratimi i strategjisë së komunikimit me publikun për çështjet e natyres urgjente; Monitorimi i mbarëvajtjes së bashkëpunimit. Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.*

***Shkalla e aftësisë së drejtuesit dhe pikëzimi***

*(Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën (cilësinë) e aftësisë së drejtuesit dhe pikët e propozuara për këtë tregues).*

**C. Zëvendësimin në kohë të prokurorëve që kanë pengesa në proces**

***Burimet e vlerësimit:***

**1.** Burimi 1;
**2.** Burimi 2;
**3.** .....

***Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:***

**Referuar burimit 1,** rezulton se .................

**Referuar burimit 2,** rezulton se .................

| |
|---|
| ***Analiza e të dhënave*** <br> *Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohen aftësitë e drejtuesit, në lidhje me indikatoret dhe elementet e secilit prej tyre si më poshtë:* <br> 1. Qëndrimi proaktiv i drejtuesit të prokurorisë për të vendosur mbi zëvendësimin e prokurorit kur ekzistojnë arsye serioze që lidhen me detyrën sipas ligjit. *Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për identifikimin e rasteve dhe zëvendesimin e prokurorit kur konstatohet shkelje ligjore serioze nga prokurori i çështjes; Repektimin e shortit në caktimin prokurorëve për çështjet e zëvendësuara.* <br> 2. Marrja e masave për zëvendësimin e prokurorit të çështjes, për shkak të mungesës ose paaftësisë së tij të përkohshme fizike për punë, nuk është në gjendje të ushtrojë funksionet apo të respektojë afatet ligjore. *Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për zëvendesimin e prokurorit për shkak të mungesës ose paaftësisë së tij të përkohshme fizike për punë, nuk është në gjendje të ushtrojë funksionet apo të respektojë afatet ligjore. Respektimin e shortit në caktimin prokurorëve për çështjet e zëvendësuara.* <br> 3. Marrja e masave organizative-administrative dhe trajtimi me uniformitet i deklarimeve për heqje dorë, apo kërkesave për zëvendesimin e prokurorit. *Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave procedurale dhe administrative për trajtimin e deklarimeve për heqje dorë, apo kërkesave për zëvendësimin e prokurorit; Trajtimi i rasteve me uniformitet.* <br> 4. Nxjerrja e udhëzimeve të përgjithshme për rregullimin e aspekteve procedurale të zëvendesimit të prokurorëve. *Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Nxjerrja e urdhëzimeve të përgjithshme për rregullimin e aspekteve procedurale penale të zëvendësimit të prokurorëve; Zbatimi i këtyre udhëzimeve.* <br> 5. Cilësia dhe arsyetimi ligjor i vendimmarrjeve. *Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Aftësitë hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave; Aftësia për të interpretuar ligjin. Aftësia për të interpretuar ligjin e identifikuar, arsyetimi i tij për mënyrën e zbatimit të ligjit mbi çështjet konkrete për trajtim, apo pasqyrimi dhe/ose analizimi i të dhënave në zbatim dhe në përputhje me ligjin e identifikuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij; Aftësia për të zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale që kanë lidhje me interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjes për trajtim, në përpunimin e akteve dhe dokumentave ligjorë, dhe/ose në arsyetimet me shkrim ose verbale, sipas rastit; Për aq sa është e mundur, aftësia për të analizuar jurisprudencën, praktikat me të mira, standartet ndërkombëtare, duke u përqëndruar tek aftësia për të kërkuar, identifikuar, organizuar dhe përdorur jurisprudencën relevante për një çështje të caktuar, në mbështetje të një interpretimi të caktuar; Aftësia për të hartuar akte nënligjore. Zbatimi i teknikës legjislative. Qartësia, konçiziteti dhe kuptueshmëria. Përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës; Aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë; Zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës; Përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), paragrafëve dhe e* |

| |
|---|
| *strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin; Përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë.* |
| ***Shkalla e aftësisë së drejtuesit dhe pikëzimi***<br>*(Pas analizës së të dhënave që rezultojnë ngaburimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën(cilësinë) e aftësisë së drejtuesit dhe pikët e propozuara për këtë tregues).* |

**D. Zhvillimin e mbledhjeve tematike për prokurorët**

| |
|---|
| ***Burimet e vlerësimit:***<br><br>**1.** Burimi 1;<br>**2.** Burimi 2;<br>**3.** ..... |
| ***Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:***<br><br>**Referuar burimit 1,** rezulton se ................<br><br>**Referuar burimit 2,** rezulton se ................ |
| ***Analiza e të dhënave***<br>*Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohen aftësitë e drejtuesit, në lidhje me indikatoret dhe elementet e secilit prej tyre si më poshtë:*<br>1. *Zhvillimi periodik i mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve të zyrës që drejton për të diskutuar çështje me rëndësi për veprimtarinë e prokurorisë. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Respektimi i parashikimeve ligjore lidhur me proceduren e njoftimit dhe zhvillimit të mbledhjes; Periodiciteti i arsyeshëm i zhvillimit të mbledhjeve.*<br>2. *Organizimi i diskutimeve për çështje të natyrës profesionale. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Rëndësia, risitë, zhvillimet e fundit të jurisprudencës të sjella gjatë diskutimeve; Periodiciteti i arsyeshëm i zhvillimit të mbledhjeve.*<br>3. *Vlerësimi dhe marrja e masave për zbatim sipas mendimit të dhënë nga mbledhja e prokuroreve mbi rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë; lidhur me përshkrimet e punës të të gjitha kategorive të nëpunësve civilë dhe punonjësve të prokurorisë, për ngritjen e seksioneve, për strukturën dhe përbërjen e tyre; çdo çështje tjetër me rëndësi për veprimtarinë e prokurorisë, përfshirë ato që lidhen me disiplinimin, karrierën dhe trajnimin e prokurorëve dhe nëpunësve të prokurorisë. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Masat organizative, nënligjore, administrative, të marra nga drejtuesi i prokurorisë për të konkretizuar mendimin e shfaqur dhe të mirëpranuar në mbledhjen e përgjithshme; Mbikqyrja e zbatimit të këtyre masave.* |

4. *Diskutimi i raportit vjetor të prokurorisë. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Respektimi i parashikimeve ligjore lidhur me procedurën e njoftimit dhe zhvillimit të mbledhjes; Reflektimi në draftraport i mendimeve, diskutimeve të shfaqura gjatë mbledhjes.*
5. *Cilësia e akteve shoqëruese të njoftimit të mbledhjeve, e argumentimit, moderimit të diskutimit në mbledhje, e arritjes së përfundimeve, ndjekja në vijimësi e zgjidhjes së tyre. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Aftësia për të hartuar akte shoqëruese; Zbatimi i teknikës legjislative; Qartësia, konçiziteti dhe kuptueshmëria; Përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës; Aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë; Zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës; Përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), paragrafëve dhe e strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin; Përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë; Niveli i argumentimit gjatë diskutimit, mënyra e moderimit të diskutimit në mbledhje, nxjerrja e përfundimeve, dhe ndjekja në vijimësi e zgjidhjes së tyre.*

***Shkalla e aftësisë së drejtuesit dhe pikëzimi***

*(Pas analizës së të dhënave që rezultojnë ngaburimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën(cilësinë) e aftësisë së drejtuesit dhe pikët e propozuara për këtë tregues).*

**E. Planifikimin dhe përdorimin efikas të fondeve publike, sipas nevojave të prokurorisë**

***Burimet e vlerësimit:***

1. Burimi 1;
2. Burimi 2;
3. .....

***Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:***

**Referuar burimit 1,** rezulton se ................

**Referuar burimit 2,** rezulton se ................

***Analiza e të dhënave***

*Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohen aftësitë e drejtuesit, në lidhje me indikatoret dhe elementet e secilit prej tyre si më poshtë:*

1. *Marrja mendim nga mbledhja e përgjithshme e prokurorëve të zyrës mbi projektbuxhetin e prokurorisë përkatëse, si dhe mbi përdorimin e fondeve publike brenda vitit buxhetor ekonomik. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Respektimi*

| |
|---|
| *i parashikimeve ligjore lidhur me proceduren e njoftimit dhe zhvillimit të mbledhjes; Reflektimi në draftbuxhet i mendimeve, diskutimeve të shfaqura gjatë mbledhjes.*<br>2. *Marrja e masave për të rritur buxhetin e Prokurorisë me të ardhura nga donacione dhe çdo të ardhur tjetër të ligjshme. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Normimi i aspekteve procedurale-administrative të lobimit, pranimit, dhe bërjes pjesë të buxhetit; Marrja e nismave për rritjen e buxhetit me donacione dhe të ardhura të tjera të ligjshme.*<br>3. *Qëndrimi proaktiv në adresimin, përsistimin, në zgjidhjen e problematikave lidhur me planifikimin dhe përdorimin e fondeve publike. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Masat e marra për të adresuar problematikat e konstatuara; Këmbëngulja në zgjidhjen e tyre.*<br>4. *Monitorimi i mbjedhjes së të ardhurave nga shpenzimet procedurale, dhe të ardhurave të tjera që rezultojnë nga veprimtaria e rregullt e prokurorisë. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Organizimi i monitorimit të mbledhjes të ardhurave nga shpenzimet procedurale. Problematikat e konstatuara dhe zgjidhja e tyre.*<br>5. *Marrja e masave për mbikëqyrjen e veprimtarisë financiare të prokurorisë. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Normimi i aspekteve procedurale-admnistrative për ushtrimin e mbikqyrjes së brendshme të veprimtarisë financiare të prokurorisë; Problematikat e konstatuara dhe zgjidhja e tyre.* |
| ***Shkalla e aftësisë së drejtuesit dhe pikëzimi***<br>*(Pas analizës së të dhënave që rezultojnë ngaburimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën(cilësinë) e aftësisë së drejtuesit dhe pikët e propozuara për këtë tregues).* |

**F. Mbikëqyrjen për efekt të përmirësimit të informacionit në faqen zyrtare të prokurorisë;**

| |
|---|
| ***Burimet e vlerësimit:***<br>**1.** Burimi 1;<br>**2.** Burimi 2;<br>**3.** ..... |
| ***Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:***<br>**Referuar burimit 1,** rezulton se .................<br>**Referuar burimit 2,** rezulton se ................. |
| ***Analiza e të dhënave***<br>*Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohen aftësitë e drejtuesit, në lidhje me indikatoret dhe elementet e secilit prej tyre si më poshtë:* |

1. *Përmirësimi i ndërfaqeseëb të prokurorisë në përputhje me programin e transparencës së përgatitur nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bashkuar në ligjin Nr. 119/2015 "Për të drejtën e informimit". Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave konkrete për përmirësimin e saj; Problematikat e konstatuara dhe zgjidhja e tyre.*
2. *Marrja e masave organizative për përditësimin dhe mirëmbajtjen e portalit unik. Në këtë indikator vlerësohen elementet si. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Normimi i aspekteve procedurale-admnistrative për përditësimin dhe mirëmbajtjen e portalit unik; Problematikat e konstatuara dhe zgjidhja e tyre.*
3. *Vendosja në zbatim të programit institucional të transparencës, në të cilin përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informaconi. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave konkrete për përmirësimin e saj; Problematikat e konstatuara dhe zgjidhja e tyre.*
4. *Hartimi i strat[egjisë së komunikimit publik nëpërmjet faqës zyrtare. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Hartimi i stratëgjisë së komunikimit publik; Monitorimi i zbatimit të saj.*
5. *Monitorimi i përmbushjes së detyrave nga personeli përgjegjës, dhe marrja e masave për zgjidhjen e problematikave. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Normimi i aspekteve procedurale-admnistrative lidhur me ushtrimin e detyrave nga personle pergjegjes; Monitorimi i zbatimit të tyre, problematikat e konstatuara dhe zgjidhja e tyre.*

***Shkalla e aftësisë së drejtuesit dhe pikëzimi***
*(Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën (cilësinë) e aftësisë së drejtuesit dhe pikët e propozuara për këtë tregues).*

**G. Mbikëqyrjen, për krijimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori, në përputhje me nevojat e palëve e të publikut;**

***Burimet e vlerësimit:***

1. Burimi 1;
2. Burimi 2;
3. .....

***Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:***

**Referuar burimit 1,** rezulton se ................

**Referuar burimit 2,** rezulton se ................

***Analiza e të dhënave***
*Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohen aftësitë e drejtuesit, në lidhje me indikatorët dhe elementet e secilit prej tyre si më poshtë:*

1. *Marrja e masave për menaxhimin e objekteve dhe pasurisë së prokurorisë dhe monitorimi periodik. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin, dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi; Krijimi dhe përditësimi i regjistrit kontabël.*
2. *Marrja e masave për të përmirësuar kushtet e punës, ambjentet e zyrave, dhe infrastrukturën e prokurorisë, përfshirë marrjen e masave për garantimin e transportit me mjete zyrtare të prokurorëve në ushtrim të detyrave zyrtare, në veçanti kur godina e gjykatës është në largësi nga godina prokurorisë. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave konkrete për të përmirësuar kushtet e punës dhe infrastrukturën e prokurorisë; Marrja e masave për garantimin e transportit me mjete zyrtare të prokurorëve në ushtrim të detyrave zyrtare.*
3. *Marrja e masave për të garantuar parkimin dhe sigurinë për mjetet e prokurorisë dhe të prokurorëve të prokurorisë që drejton. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave konkrete për të garantuar parkimin dhe sigurinë e mjeteve të prokurorisë dhe të prokurorëve; Evidentimi i problematikave, këmbëngulja dhe zgjidhja e tyre.*
4. *Normimi i administrativ i përdorimit të automjeteve zyrtare, mbikëqyrja e përdorimit të tyre. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Përcaktimi i rregullave për përdorimin efikas dhe ekonomizimin e shpenzimeve për përdorimin e automjeteve zyrtare të prokurorisë; Monitorimi i zbatimit të tyre.*
5. *Marrja e masave për adresimin, dhe zgjidhjen e problematikave të ngritura nga prokurorët, dhe personeli administrativ lidhur me ambjentet e punës. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Organizimi i monitorimeve periodike për evidentimin e problematikave, mbledhjeve dhe takimeve për bërjen prezent të problematikave nga prokurorët dhe personeli adminsitrativ; Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.*
6. *Marrja e masave për të siguruar qasjen e publikut në prokurori, rritja e efikasitetit të shërbimit të administratës, caktimi i ditëve vizituese në godinë. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave konkrete për të lehtësuar aksesin e publikut, si dhe përmirësimi i shërbimeve të administratës; Mbikëqyrja periodike dhe evidentimi i problematikave; Caktimi i ditëve të caktuara për vizitimin e ambienteve të prokurorisë nga qytetarët. Rregullimi i aspekteve administrative dhe procedurale për këtë qëllim.*
7. *Marrja e masave për të garantuar qasjen e personave që nuk kuptojnë gjuhën shqipe, apo personave me aftësi të kufizuara në prokurori. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për të garantuar aksesin në prokurori dhe shërbimeve administrative për personat që nuk kuptojnë gjuhën shqipe; Krijimi i infrastukturës, marrja e masave për të aksesuar prokurorinë dhe shërbimet ligjore të saj nga personat me aftësi të kufizuara.*
8. *Marrja e masave për vënien në funksionim dhe zbatimin e të drejtës së magjistratit për aplikimin e skemës së huamarrjes së kredisë për shtëpi. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave konkrete për të organizuar, koordinuar bashkëpunimin ndërinsitucional për vënien në funksionim dhe zbatimin e kësaj skeme; Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.*

9. *Marrja e masave për të siguruar qasjen në prokurori të viktimave të veprës penale, marrjen e kallëzimeve penale, apo të subjekteve të tjerë të procedurës penale në ushtrim të të drejtave dhe garancive procedurale. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave konkrete për të lehtësuar aksesin e viktimave të veprës penale; Monitorimi i zbatimit të detyrave nga koordinatori, psikolologu dhe punonjësve të tjerë të prokurorisë për të garantuar respektimin e të drejtave procedurale të viktimave; Normimi i aspekteve procedurale dhe administrative për të garantuar marrjen e kallëzimeve penale në prokurori, si dhe monitorimi i zbatimit të tyre.*
10. *Marrja e masave për krijimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave konkrete për të krijuar ambjente të përshtatshme në prokurori për marrjen në pyetje të miturve. Afishimi publik në formë tabelare i të drejtave të tyre; Marrja e masave për garantimin e marrjes në pyetje me pajisje, mjete audiovizive).*

***Shkalla e aftësisë së drejtuesit dhe pikëzimi***
*(Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën(cilësinë) e aftësisë së drejtuesit dhe pikët e propozuara për këtë tregues).*

**H. Kujdeset për çështjet e ruajtjes dhe të sigurisë në prokurori**

***Burimet e vlerësimit:***

1. Burimi 1;
2. Burimi 2;
3. .....

***Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:***

**Referuar burimit 1,** rezulton se .................

**Referuar burimit 2,** rezulton se .................

***Analiza e të dhënave***
*Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohen aftësitë e drejtuesit, në lidhje me indikatorët dhe elementët e secilit prej tyre si më poshtë:*

1. *Marrja me masave për ruajten dhe sigurinë në prokurori. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave konkrete për zbatimin e legjislacionit në fuqi, të cilat rregullojnë ruajtjen dhe sigurinë në prokurori. Nxjerrja e urdhrave dhe udhëzimeve për të lehtësuar zbatimin e tyre në prokurori; Monitorimi i zbatimit të tyre, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.*
2. *Miratimi i një politike për sigurinë e objektit/sigurinë në punë, si dhe përgatitja e programeve për menaxhimin e sigurisë dhe mbajtja e tyre të përditësuara. Në këtë*

*indikator vlerësohen elementet si: Miratimi i një politike për sigurinë, si dhe përgatitja e programeve. Përcaktimi i përgjegjësive individuale dhe "të zinxhirit të komandës" për arritjen e objektivave sa i përket secilit funksion dhe secilit nivel të hierarkisë. Miratimi i një kalendar me afate kohore për arritjen e objektivave dhe një përcaktim të stafit dhe burimeve që do të përdoren për këtë qëllim; Monitorimi i zbatimit të tyre, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.*

3. *Përcaktimi i punonjësve të caktuar dhe trajnimi i tyre për çështje të sigurisë dhe marrja e masave për të garantuar që informacioni në lidhje me sigurinë t'iu komunikohet anëtarëve të stafit dhe nëpunësve të prokurorisë. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Normimi i rolit të anëtarëve të stafit, përgjegjësitë dhe kompetencat e tyre, organizimi dhe funksionimi, si dhe njohja me to e të gjithë stafit. Nënshkrimi i marrëveshjes së konfidencialitetit, dhe monitorimi i zbatimit të saj; Stafi i prokurorisë, të cilit i delegohen përgjegjësi në lidhje me sigurinë, duhet të marrë trajnimin e duhur me këto objektiva: Njohjen e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi; Njohjen e riskut për kërcënim ndaj prokurorisë dhe vulnerabilitetet e saj; Funksionimin e sistemit të menaxhimit të prokurorisë.*
4. *Vendosja dhe përditësimi i procedurave për trajtimin e duhur të të gjitha dokumenteve në prokurori, si dhe vendosja dhe zbatimi i rregullave dhe procedurave në lidhje me sigurinë e sistemeve të informacionit që janë të përshtatshme sa i përket konstatimeve të vulnerabilitetit, sidomos rregullave në lidhje me: Administrimin e sistemeve të informacionit; Ruajtjen dhe instalimin e pajisjeve të sigurisë; Ruajtjen dhe asgjësimin e mjeteve të ruajtjes së të dhënave. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Regjistrimi dhe të ruajtja në mjete të përshtatshme, si për shembull në letër apo në kompjuter, informacione që duhen: Për të përshkruar elementet e domosdoshme të sistemit të menaxhimit dhe ndërveprimeve të tyre; Për të identifikuar apo për të përcaktuar vendndodhjen e dokumentacioneve të korrespondencës. Dokumente në lidhje me informacione dhe/ose objekte delikate duhet të trajtohen nga disa rregulla specifike, të cilat përcaktojnë: – shkallën e sensitivitetit të informacionit; Nivelin e klasifikimit sipas shkallës së specifikuar të sensitivitetit; Personat/grupet të cilëve mund t'u qarkullohen dokumente të secilit nivel klasifikimi; Rregullat e identifikimit; Rregullat për lëshimin, riprodhimin, mbajtjen, ruajtjen dhe asgjësimin e informacioneve dhe/ose objekteve delikate; Vendosja dhe përditësimi i procedurave për trajtimin e duhur të të gjitha dokumenteve dhe të dhënave të nevojshme për të garantuar që: Të mund të përcaktohet vendndodhja e tyre; Të rishikohen dhe të ndryshohen në mënyrë sistematike nëse është e nevojshme dhe të miratohen sipas rregullave nga personat e autorizuar për këtë qëllim; Versionet aktuale të dokumenteve dhe të dhënave relevante të jenë të disponueshme në të gjitha vendndodhjet, ku kryhen operacione të domosdoshme për funksionimin normal të sistemit të menaxhimit të sigurisë; Dokumente dhe të dhënat e vjetruara të mund të tërhiqen në mënyrë të menjëhershme nga të gjitha vendet, ku ato janë të disponueshme për përdorim dhe të menaxhohen në mënyrë të tillë që të mos mund të përdoren gabimisht; Dokumentet dhe të dhënat e arkivuara të mbajtura për qëllime juridike të mund të identifikohen dhe të sigurohen si duhet. Vendosja dhe zbatimi i rregullave dhe procedurave në lidhje me sigurinë e sistemeve të informacionit që janë të përshtatshme sa i përket konstatimeve të vulnerabilitetit, sidomos rregullave në lidhje me:*

*Administrimin e sistemeve të informacionit; Ruajtjen dhe instalimin e pajisjeve të sigurisë; Ruajtjen dhe asgjësimin e mjeteve të ruajtjes së të dhënave.*

5. *Përcaktimi i aktiviteteve që përfshijnë vulnerabilitete të njohura dhe që duhen kontrolluar rreptësisht, si dhe përcaktimi dhe përditësimi i procedurave për identifikimin, parandalimin dhe diktimin e situatave të emergjencës dhe për të pasur kapacitet reagues të tillë që të mund të parandalohet, të diktohet ose të zbutet çdo sulm ndaj njerëzve, pronës apo informacioneve. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Përcaktimi i atyre aktivitete që përfshijnë vulnerabilitete të njohura dhe që duhen kontrolluar rreptësisht. Këto aktivitete duhet të planifikohen, me mirëmbajtjen dhe mbikëqyrjen e duhur, për të garantuar realizimin e tyre siç kërkohet: a) Duke përcaktuar dhe përditësuar procedurat në lidhje me ambiente dhe vendndodhje të tjera vulnerabël (grafik organizativ për çelësat, karta për kontrollin e aksesit); b) Duke përgatitur dhe duke përditësuar procedurat zyrtare që përcaktojnë sjelljen që duhet demonstruar në rast situatash kritike (mosfunksionim të sistemit të sigurisë që prek mbikëqyrjen, kontrollin e aksesit, etj.); c) Duke futur një sistem për të monitoruar autorizimet për aksesin e kontrolluar në ambiente të kufizuara dhe delikate (dhomat e provave, dhomën e serverëve, kamerave); d) Duke përcaktuar zonat e kontrolluara mbi bazën e fluksit të lëvizjeve dhe konstatimeve të pikave të dobëta; e) Duke përcaktuar procedura specifike për trajtimin e anëtarëve të publikut dhe personave nga jashtë prokurorisë, sidomos kur ata mund të jenë në kontakt me informacione dhe/ose materiale që konsiderohen sensitive. Mjetet e mbrojtjes dhe diktimit duhet t'i përshtaten nivelit të vulnerabilitetit. Sistemi në tërësi duhet të monitorohet nga punonjës kompetentë të caktuar për këtë qëllim; Marrja e masave me anë të cilave duhet: Të përcaktojë dhe të përditësojë procedura për identifikimin e situatave të emergjencës dhe për të pasur kapacitet reagues të tillë që të mund të parandalohet, të diktohet ose të zbutet çdo sulm ndaj njerëzve, pronës apo informacioneve; Të rishikojë procedurat për parandalimin dhe diktimin e situatave të emergjencës dhe të ofrojë kapacitet reagimi, sidomos pas një incidenti apo një emergjence.*
6. *Organizimi i simulime periodike, nga të cilat mund të nxirren mësime, si dhe përcaktimi dhe të përditësimi i një program për audite periodike të sigurisë. Në këtë indikator vlerësohen elementet si:Organizimi i simulime periodike, nga të cilat mund të nxirren mësime. Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre; Përcaktimi dhe të përditësimi i një program për audite periodike të sigurisë. Për të vendosur nëse mjetet e vlerësimit dhe menaxhimit dhe sistemi i menaxhimit të sigurisë: Përmbushin kërkesat për menaxhimin e sigurisë të përcaktuara nga autoriteti i lartë kompetent; Zbatohen dhe përditësohen siç duhet; Ndihmojnë zbatimin efektiv të politikave dhe objektivave të saj; Për të rishikuar konstatimet e auditimeve të mëparshme.*
7. *Marrja e masave për ndarjen e brendshme të ambienteve në zona sigurie, si dhe caktimi i një koordinatori për sigurinë, përgjegjës për kontrollin operacional dhe menaxhimin e mjeteve përkatëse. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Ndarja e brendshme e ambienteve në zona sigurie, ku të ketë rregulla përkatëse për të kontrolluar aksesin e tyre, si dhe rregulla për të organizuar aksesin mes këtyre zonave. Duhen përcaktuar oraret kur këto zona janë të hapura dhe të mbyllura, duke përfshirë veprimet procedurale që duhet të kryhen në orët e vona ose në fundjava. Pikat e kontrollit të publikut duhet të vendosen në hyrje të ndërtesës për të siguruar që ato nuk mund të shmangen në rast se synohet aksesi në ketë zonë të veçantë. Caktimi i një*

*koordinatori për sigurinë, përgjegjëse për kontrollin operacional dhe menaxhimin e mjeteve përkatëse.*

8. *Krijimi i instrumenteve të menaxhimit dhe komunikimit në sektorin e sigurisë, si lista kontrolli dhe formularë incidentesh. Në këtë indikator vlerësohen elementet si:Marrja e masave për krijimin e instrumenteve të menaxhimit dhe komunikimit në sektorin e sigurisë. Kryerja në mënyrë sistematike e inspektimeve fizike dhe kontrolleve të të gjitha lëvizjeve hyrëse dhe dalëse. Përdorimi i regjistrit të vizitorëve; Marrja e "masave të nevojshëm për garantimin e sigurisë" të personave që punojnë në objekt. Mangësitë e mundshme mund të identifikohen dhe të korrigjohen duke përdorur formularë për incidentet: të hartuara sa herë që një ngjarje prek sigurinë e prokurorisë (sulmet ndaj personave apo pronës); Dosje sigurie: dosje që për çdo prokurori të përmbajnë të gjitha dokumentet që lidhen me sigurinë duke ofruar një historik informacionesh rreth institucionit; Plan sigurie: përcakton masat që duhen marrë në prokurori për të garantuar një nivel të kënaqshëm sigurie, Plan veprimi.*
9. *Hartimi i planeve të ndërhyrjeve të njohura për të gjithë stafin. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Miratimi i Planit të Posaçëm të Mbrojtjes dhe Planit të Jashtëm të Mbrojtjes. Protokolli i përcaktuar duhet të përfshijë mundësi për njoftime sa më të hershme dhe identifikim të ngjarjeve të dyshimta, diktim të sinjaleve në shkallë të vogël që mund të tregojnë për zhvillime të papritura të situatës, njoftim të menjëhershëm të forcave të zbatimit të ligjit dhe vendosje të menjëhershme të objektit në gjendje emergjence; ato duhet të parashikojnë një lloj shkallëzimi për të marrë parasysh ndjeshmërinë që mund të kenë aktivitetet e planifikuara të prokurorisë; Miratimi i protokollit të ndërhyrjeve të forcave të zbatimit të ligjit dhe shërbimeve në raste emergjence, i cili të parashikojë në një kuadër të miratuar garantimin e ndërhyrjeve të forcave të zbatimit të ligjit dhe shërbimeve të emergjencës në rast njoftimi. Fushatat për ndërgjegjësimin e stafit. Për kategori të ndryshme të stafit duhet të bëhen prezantime periodike lidhur me rreziqet ndaj të cilave ata ekspozohen dhe mjeteve dhe masave ekzistuese për parandalimin e tyre. Në ato departamente ku ka më shumë gjasa të shfaqen sjellje agresive, duhet të merren masa për minimizimin e rrezikut të ekspozimit të stafit ndaj tyre: – programe për parandalimin e dhunës; – sisteme gjurmimi për më shumë transparencë për mënyrën e funksionimit të këtij shërbimi; – sisteme për këshillimin e stafit dhe mbështetjen e tij në raste incidentesh që lidhen me sigurinë; – vigjilencë aktive për identifikimin e situatave të rrezikshme; – çdo masë e posaçme që mund të integrohet në planifikimin lokal për mbrojtjen dhe sigurinë.*
10. *Zbatimi i politikës së ndërtesave dhe i një politike për sigurinë nga zjarri. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për zbatimin e politikës së ndërtesës. Kjo politikë duhet të bazohet në njohjen e pronave aktuale dhe në një analizë të kërkesave për siguri në të ardhmen. Përcaktimi i objektivave të përmirësimit të objekteve dhe operacionet prioritare që duhen kryer sipas një programi pune shumëvjeçare; Marrja e masave paraprake për organizimin e ndihmës së shpejtë, si dhe për mbrojtjen nga zjarri dhe evakuimin në rast emergjence; të përgatisë një plan evakuimi dhe shpëtimi në rast emergjence, t'ua shpërndajë atë punonjësve dhe të organizojë trajnime dhe simulime të parashikuara nga ky plan të paktën një herë në dy vjet; të caktojë të paktën një punonjës të trajnuar për ndihmën e shpejtë, për shuarjen e zjarrit; dhe për shpëtimin në një staf prej më shumë se 20 vetash, duhet të*

| |
|---|
| *ketë të paktën dy punonjës të trajnuar. Rregulloret për rastet e zjarrit duhet gjithashtu të afishohen në godinë, ku të tregohet se si lajmërohet zjarrfikësja, si sigurohet hap pas hapi siguria personale, si përdoren pajisjet për fikjen e zjarrit dhe si pritet dhe ndihmohet zjarrfikësja. Këto rregulla duhet të afishohen së bashku me planin e evakuimit, ku identifikohen rrugëdaljet, vendndodhja e daljeve të emergjencës, si dhe vendndodhja e pajisjeve për fikjen e zjarrit. Këto rregulla duhet të afishohen në çdo kat të ndërtesës, afër dyerve, shkallëve dhe ashensorëve dhe duhet të pozicionohen në mënyrë të tillë që të mund të lexohen lehtësisht.* |
| ***Shkalla e aftësisë së drejtuesit dhe pikëzimi***<br>*(Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën(cilësinë) e aftësisë së drejtuesit dhe pikët e propozuara për këtë tregues).* |

**I. Organizimin e trajnimeve për prokurorët dhe punonjësit e prokurorisë.**

| |
|---|
| ***Burimet e vlerësimit:***<br><br>**1.** Burimi 1;<br>**2.** Burimi 2;<br>**3.** ..... |
| ***Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:***<br><br>**Referuar burimit 1,** rezulton se ................<br><br>**Referuar burimit 2,** rezulton se ................ |
| ***Analiza e të dhënave***<br>*Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohen aftësitë e drejtuesit, në lidhje me indikatoret dhe elementet e secilit prej tyre si më poshtë:*<br>1. *Përfshirja e drejtuesit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë ose në trajnime profesionale për drejtimin dhe organizimin e prokurorisë. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Përfshirja e drejtuesit në veprimtari ndërinstitucionale (grupe pune, projekte, reforma etj) të cilat synojnë përmirësimin e sistemit të drejtësisë; Marrja pjesë në trajnime profesionale për drejtimin dhe organizimin e prokurorisë për të rritur nivelin profesinal.*<br>2. *Koordinimi dhe organizimi i trajnimeve të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër veprave penale prioritare të rekomanduara, si dhe të lehtësojnë pjesëmarrjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në trajnime të përbashkëta me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit në fushat dhe drejtimet e rekomanduara. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për të organizuar trajnime të përbashkëta me Policinë e Shtetit, shërbimet e tjera gjyqësore,* |

| |
|---|
| *apo institucione të tjera; Planifikimi i punës për të lehtësuar pjesëmarrjen e prokurorëve dhe oficerëve në trajnime.*<br><br>3. *Marrja e masave për të garantuar pjesëmarrje të barabartë të prokurorëve dhe oficereve në trajnime, dhe sipas specializimit të tyre, seksionit në të cilën ushtron detyrën ne veçanti në ato jashtë shtetit. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për të garantuar pjesëmarrje të barabartë në trajnime; Mbikqyrja e pjesëmarrjes në trajnime dhe përmbushje e detyrimeve nga pjesëmarrësit.*<br>4. *Marrja e masave për koordinimin dhe organizimin e trajnimeve, webinareve (trajnime online), me organizmat ndërkombëtare në fushën e drejtësisë. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për realizmin e marrëveshjeve, krijimin e praktikave të mira me organizmat ndërkombëtare në fushën e drejtësisë; Marrja e masave për të organizuar trajnime të përbashkëta me to.*<br>5. *Organizimi i trajnimeve për punonjësit administrativ të prokurorisë. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për të organizuar trajnime të punonjësve administrative; Planifikimi i punës për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre në trajnime* |
| ***Shkalla e aftësisë së drejtuesit dhe pikëzimi***<br>*(Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën (cilësinë) e aftësisë së drejtuesit dhe pikët e propozuara për këtë tregues).* |

| Propozim për nivelin e vlerësimit<br>**KRITERI 1**<br>**AFTËSITË DREJTUESE DHE ORGANIZATIVE TË DREJTUESIT** | |
|---|---|
| Pikët | Shkalla/cilësia e aftësisë |
| | |

**2. AFTËSITË KOMUNIKUESE**

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e drejtuesit në drejtim të aftësive komunikuese, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë e drejtuesit për të komunikuar dhe bashkëpunuar, efektivitetin në vendimmarrje me synim përmirësimin e vazhdueshëm të performancës, integritetit, llogaridhënies dhe efiçencës së sistemit të prokurorisë.*

A. **Bashkëpunimin efektiv dhe në kohë me Këshillin, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Ministrinë e Drejtësisë, Kontrollin e Lartë të Shtetit ose me çdo institucion tjetër mbikëqyrjeje ose auditi.**

| |
|---|
| ***Burimet e vlerësimit:*** <br><br> **1.** Burimi 1; <br> **2.** Burimi 2; <br> **3.** ..... |
| ***Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:*** <br><br> **Referuar burimit 1,** rezulton se ................ <br><br> **Referuar burimit 2,** rezulton se ................ |
| ***Analiza e të dhënave*** <br> *Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohen aftësitë e drejtuesit, në lidhje me indikatorët dhe elementet e secilit prej tyre si më poshtë:* <br> 1. *Bashkërendimi i punës me Këshillin e Lartë të Prokurorisë për çështje që lidhen me karrierën dhe rritjen profesionale të prokurorëve. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave organizative, procedurale për të siguruar bashkëpunimin me Këshillin e Lartë të Prokurorisë (normime procedurale administrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre); Planifikimi i takimeve periodike brenda institucionit për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre.* <br> 2. *Organizimi, koordinimi i punës me Këshillin e Lartë të Prokurorisë për vlerësimin e performancës së prokurorëve. Në këtë indikator vlerësohen elementët si: Marrja e masave për të organizuar, bashkërenduar, përmbushur detyrimet ligjore në kuadër të procesit të vlerësimit të prokuroreve; Marrja e masave për monitorimin, saktësinë e të dhënave, objektivitetit në dhënien e mendimit për vlerësimin e prokurorëve.* <br> 3. *Marrja e masave administrative-procedurale për të garantuar zbatimin dhe respektimin e rregullave të etikës të miratuara nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe raportimin për gjetjet. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave normuese në zbatim të rregullave të miratuara nga Këshilli; Mbikqyrja e zbatimit të tyre. Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.* <br> 4. *Marrja e masave për të shprehur mendime dhe për të bërë propozime lidhur me draftet e akteve nënligjore, apo ndryshimeve në legjislacionin që mund të ndikojë në punën e prokurorisë dhe çdo çështje tjetër që është nën përgjegjësinë e prokurorisë, të njoftuara, apo kërkuara nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Në këtë indikator vlerësohen elementet si:Qëndrimi aktiv në dhënien e mendimeve, propozimeve mbi draftet e akteve nënligjore, apo ligjore të kërkuara nga Këshilli. Organizimi i mbledhjeve, apo takimeve me prokurorët për të marrë mendimin e tyre lidhur me to; Marrja e nismave për të propozuar miratimin e akteve ligjore, apo nënligjore për të* |

*rregulluar punën e prokurorisë dhe çdo çështje tjetër që është nën përgjegjësinë e prokurorisë.*

5. *Marrja e masave administrative-procedurale në zbatimin e akteve nënligjore të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe mbikqyrja e zbatimit të tyre. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për njohjen e akteve nënligjore nga prokurorët dhe analizimi dhe diskutimi i tyre në mbledhjen e prokurorëve; Marrja e masave për zbatimin e tyre në përshtatje me organizmin dhe funksionimin e prokurorisë që drejton, si dhe verifikimi i zbatimit të tyre, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.*
6. *Garantimi i zbatimit të vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për njohjen e vendimeve nga prokurorët, dhe analizimi dhe diskutimi i tyre në mbledhjen e prokurorëve; Marrja e masave për zbatimin e tyre në përshtatje me organizmin e funksionimin e prokurorisë që drejton, verifikimi i zbatimit të tyre, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.*
7. *Bashkërendimi i punës me Shkollën e Magjistraturës dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë për çështje që lidhen me rritjen profesionale të prokurorëve. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave organizative, procedurale për të siguruar bashkëpunimin me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Shkollën e Magjistraturës, (normime procedurale administrative, caktimi i personaveëergjegjës, monitorimi i tyre); Planifikimi i takimeve periodike brenda institucionit për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre.*
8. *Bashkërendimi i punës me Shkollën e Magjistraturës dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë për çështje që lidhen me kandidatët për magjistrat. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave organizative, procedurale për të siguruar bashkëpunimin me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Shkollën e Magjistraturës, (normime procedurale-adminsitrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre, krijimi i infrastrukturës për të lehtësuar përmbushjen e detyrimeve nga kandidatët për magjistrat); Planifikimi i takimeve periodike brenda institucionit për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre.*
9. *Bashkërendimi i punës me Prokurorinë e Përgjithshme për çështje që lidhen me organizmin dhe funksionimin e sistemit të prokurorisë. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave organizative, procedurale për të siguruar bashkëpunimin me Prokurorinë e Përgjithshme (normime procedurale-adminsitrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre; Planifikimi i takimeve periodike brenda institucionit për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre.*
10. *Bashkërendimi i punës me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për çështje që lidhen me hetimin disiplinor të prokurorëve. Në këtë indikator vlerësohen elementet si:Marrja e masave organizative, procedurale për të siguruar bashkëpunimin me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (normime procedurale-administrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre); Planifikimi i takimeve periodike brenda institucionit për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre.*
11. *Bërja e kërkesave drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kur gjatë ushtrimit të veprimtarisë mbikëqyrëse konstaton dhe vlerëson probleme tematike apo shkelje individuale, ose kur ka indicie, informacione ose ankesa për shkelje disiplinore gjatë*

*ushtrimit të detyrës nga prokurorët. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Konstatimi i shkeljeve disiplinore dhe paraqitja e kërkesave pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Planifikimi i takimeve periodike brenda institucionit për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre.*

12. *Marrja e masave për forcimin e bashkëpunimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur ndërmjet tyre "Për kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike dhe për shkelje individuale të magjistratëve prokurorë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm". Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për njohjen e marrëveshjes nga prokurorët dhe analizimi dhe diskutimi i saj në mbledhjen e prokurorëve; Marrja e masave për zbatimin e tyre në përshtatje me organizimin e funksionimin e prokurorisë që drejton.*
13. *Bashkërendimi i punës me drejtoritë përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Komisionin e Policisë Gjyqësore. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave organizative, procedurale për të siguruar bashkëpunimin me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Komisionin e Policisë Gjyqësore (normime procedurale-adminsitrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre) për çështje të veprimtarisë së policisë gjyqësore; Planifikimi i takimeve periodike brenda institucionit për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre.*
14. *Informimi çdo tre muaj Prokurorin e Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit. Në këtë indikator vlerësohen elementet si:Marrja e masave organizative, procedurale për informimin e Prokurorit të Përgjithshëm çdo tre muaj për gjendjen e kriminalitetit. (normime procedurale-administrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre); Planifikimi i takimeve periodike brenda institucionit për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre.*
15. *Organizimi dhe koordinimi i takimeve periodike me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Ministrinë e Drejtësisë, Policinë e Shtetit, si dhe intitucione të tjera ligjzbatuese. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Rëndësia, risitë, zhvillimet e fundit të jurisprudencës të sjella gjatë diskutimeve; Periodiciteti i arsyeshëm i zhvillimit të mbledhjeve.*
16. *Organizimi i takimeve të planifikuara rregullisht me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Rëndësia dhe natyra e çështjeve të ngritura gjatë diskutimeve; Periodiciteti i arsyeshëm i zhvillimit të mbledhjeve.*
17. *Marrja e masave për të shprehur mendime dhe për të bërë propozime lidhur me draftet e akteve nënligjore, apo ndryshimeve në legjislacionin që mund të ndikojë në punën e prokurorisë dhe çdo çështje tjetër që është nën përgjegjësinë e prokurorisë, të njoftuara, apo kërkuara nga Ministria e Drejtësisë. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Qëndrimi aktiv në dhënien e mendimeve, propozimeve mbi draftet e akteve nënligjore, apo ligjore të kërkuara nga Ministria e Drejtësisë. Organizimi i mbledhjeve, apo takimeve me prokurorët për të marrë mendimin e tyre lidhur me to. Marrja e nismave për të propozuar miratimin e akteve ligjore, apo nënligjore për të rregulluar punën e prokurorisë dhe çdo çështje tjetër që është nën përgjegjësinë e prokurorisë .*
18. *Bashkërendimi dhe koordinimi me efiçencë i veprimtarisë me Ministrinë e Drejtësisë dhe Prokurorinë e Përgjithshme lidhur me ndihmën e ndërsjellë juridike. Në këtë indikator vlerësohen elementet si:Marrja e masave organizative, procedurale për të*

*siguruar bashkëpunimin me Ministrinë e Drejtësisë dhe Prokurorinë e Përgjithshme, (normime procedurale-adminsitrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre); Planifikimi i takimeve periodike brenda institucionit për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre.*

19. *Bashkërendimi dhe koordinimi me efiçencë i veprimtarisë me prokuroritë e tjera me iniciativë ose kur kërkohet në drejtimet/fushat ose për veprat penale prioritare të rekomanduara. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave organizative, procedurale për të siguruar bashkëpunimin me prokuroritë e tjera, (normime procedurale-adminsitrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre); Planifikimi i takimeve periodike për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre.*
20. *Marrja e masave për shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit me Kontrollin e Lartë të Shtetit. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave organizative, procedurale për të siguruar shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit me Kontrollin e Lartë të Shtetit, (normime procedurale-adminsitrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre); Evidentimi i problematikave dhe masat për zgjidhjen e tyre.*
21. *Organizimi dhe bashkërendimi i trajnimeve të përbashkëta dhe takimeve periodike ndërmjet KLSh-së dhe prokurorisë. Në këtë indikator vlerësohen elementet si:Marrja e masave për të organizuar trajnime të përbashkëta me KLSH-në; Planifikimi i punës për të lehtësuar pjesëmarrjen e prokurorëve dhe oficerëve në trajnime.*
22. *Nxjerra e udhëzimeve të përgjithshme, dhe/ose jo të detyrushme për çështje konkrete, për hetimin e veprave penale të kallëzuara nga KLSH-ja. Në këtë indikator vlerësohen elementet si:Nxjerrja e udhëzimeve procedurale penale, apo lidhur me zbatimin e ligjit penal material, me qëllim unifikimin e praktikave brenda prokurorisë, ndjekja e zhvillimeve të legjislacioni, apo jurisprudencës, apo aplikimi i praktikave me të mira; Nxjerrja e udhëzimeve jo të detyrueshme me shkrim, të arsyetuara, të qarta për çështje konkrete. Ndjekja e zbatimit të tyre, si dhe efektiviteti i tyre.*
23. *Bashkëpunimi në mënyrë efektive me institucionet shtetërore dhe ligjzbatuese me rol të posaçëm në luftën kundër veprave penale prioritare te rekomanduara, si dhe të organizojnë dhe zhvillojnë analiza të përbashkëta ndërinstitucionale sipas nevojave dhe jo më pak se çdo gjashtë muaj. Në këtë indikator vlerësohen elementet si:Marrja e masave organizative, procedurale për të siguruar bashkëpunimin në menyrë efektive me institucionet shtetërore dhe ligjzbatuese me rol ëe posaçëm në luftën kundër veprave penale prioritare të rekomanduara (normime procedurale-administrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre); Planifikimi i takimeve periodike dhe analizave të përbashkëta nderinstitucionale sipas nevojave dhe jo më pak se çdo gjashtë muaj, për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre.*
24. *Marrja e masave për përmirësimin më tej të efiçencës së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese palë në marrëveshje dy ose shumëpalëshe, si dhe në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet gjyqësore të huaja nëpërmjet Zyrës së Prokurorit ndërlidhës të Shqipërisë në Eurojust, veçanërisht për rritjen e numrit të skuadrave të përbashkëta hetimore dhe goditjen e veprimtarisë kriminale brenda dhe jashtë vendit. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për përmirësimin më tej të efiçencës së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional (normime procedurale-adminsitrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre); Planifikimi i*

*takimeve periodike dhe analizave të përbashkëta ndërinstitucionale, për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre.*

25. *Të marrë masa për fuqizimin e bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale që lidhen sidomos me trafikimin e narkotikëve, pastrimit të parave, financimin e terrorizmit, trafikimin e qenieve njerëzore, krimeve mjedisore. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për fuqizimin e bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale që lidhen sidomos me trafikimin e narkotikëve, pastrimit të parave, financimin e terrorizmit, trafikimin e qenieve njerëzore, krimeve mjedisore (normime procedurale-administrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre): Planifikimi i takimeve periodike dhe analizave të përbashkëta ndërinstitucionale, për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre.*

***Shkalla e aftësisë së drejtuesit dhe pikëzimi***
*(Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën(cilësinë) e aftësisë së drejtuesit dhe pikët e propozuara për këtë tregues).*

**B. Komunikimin me publikun dhe të tretët, duke caktuar saktësisht oraret për pritjen e publikut, dokumentacionin e takimeve ose të shkresave për t'iu përgjigjur institucioneve të ndryshme.**

***Burimet e vlerësimit:***

**1.** Burimi 1;
**2.** Burimi 2;
**3.** .....

***Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:***

**Referuar burimit 1,** rezulton se ................

**Referuar burimit 2,** rezulton se ................

***Analiza e të dhënave***
*Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohen aftësitë e drejtuesit, në lidhje me indikatoret dhe elementet e secilit prej tyre si më poshtë:*

1. *Marrja e masave për organizmin dhe funksionimin e shërbimeve për marrëdhëniet me publikun, të cilat kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtarinë e prokurorisë, si dhe për çështje të veçanta, duke zbatuar kërkesat ligjore për garantimin e sekretit dhe mbarëvajtjes së hetimit. Në këtë indikator vlerësohen*

*elementet si: Marrja e masave organizative, procedurale, administrative për funksionimin e shërbimet për marrëdhëniet me publikun: Respektimi i parashikimeve ligjore dhe nënligjore për organizimin e shërbimeve: Caktimi i prokurorit dhe nëpunësit civil për marrëdhëniet me publikun duke u bazuar tek specializmet e tij; Mbarëvajtja e punës dhe marrjen e masave dhe veprimeve për të siguruar efikasitetin e shërbimeve; Marrja e masave organizative për garantimin e sekretit dhe mbarëvajtjes së hetimit. Evidentimin e rasteve të shkeljes së sekretit hetimor dhe marrja e masave të duhura ligjore.*

2. *Monitorimi i veprimtarisë së prokurorit të caktuar për marrëdhëniet me publikun për të garantuar efikasitetin dhe cilësinë e shërbimit të marrëdhënieve me publikun. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Normimi i aspekteve procedurale për ushtrimin e detyrave nga prokurori për marrëdhëniet me publikun, në drejtim të detyrave të ngarkuara dhe përmbushjes së tyre; Monitorimi i kthimit të përgjigjeve ndaj pyetjeve të mediave dhe personave të tjerë të interesuar, që kanë të bëjnë me një ngjarje aktuale, ose lidhur me me një proces që ka filluar, është duke u zhvilluar, apo ka përfunduar pranë kësaj prokurorie; Monitorimi i reagimit kur në media, apo në publik është përhapur një informacion i padrejtë, subjektiv, i njëanshëm, tendencioz, që mund të dëmtojë interesin e përgjithshëm të prokurorisë, integritetin profesional dhe moral të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore, të punonjësve të administratës të prokurorisë; Mbikëqyrja e bashkëpunimit ndërmjet, prokurorit të caktuar për marrëdhëniet me publikun, dhe prokurorit të çështjes, i cili duhet të jetë i ngushtë dhe në afat sa më të shkurtër kohor, që t'i ofrojnë informacionin e kërkuar publikut; Planifikimi i takimeve periodike, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.*
3. *Marrja e masave administrative-procedurale për të garantuar që shërbimet e marrëdhënieve me publikun kryhen duke respektuar parimin për të drejtën e informimit, duke i kushtuar vëmendje mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për krijimin, mbajtjen dhe bërjen publike të një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre: Përditësimi i tij çdo 3 muaj dhe publikimin në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe në mjediset e pritjes së publikut të prokurorisë; Marrja e masave për të garantuar se dhënia e informacionit kryhet duke respektuar parimin për të drejtën e informimit, duke i kushtuar vëmendje mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë; Marrja e masave shtesë për të parandaluar zbulimin e paligjshëm, shkatërrimin, dhe humbjen si në institucionin e prokurorisë, ashtu edhe gjatë transferimit të tyre për të gjitha dokumentat e përpunuara në mënyrë manuale, të cilat përmbajnë të dhëna personale; Marrja e masave shtesë për të garantuar që në rastet e transferimit automatik të dhënave personale, rrugët e transmetimit, ose dokumentet që përmbajnë këto të dhëna duhen koduar, duke përdorur mënyra dhe fuqi koduese në përputhje me rezultatin e vlerësimit të rreziqeve të kryera paraprakisht.*
4. *Monitorimi i efikasitetit dhe cilësisë së shërbimit me marrëdhëniet me publikun nga nëpunësi civil në përputhje me ligjin "Për të drejtën e informimit". Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Normimi i aspekteve procedurale për ushtrimin e detyrave nga nëpunësi civil për marrëdhëniet me publikun, në drejtim të detyrave të ngarkuara dhe përmbushjes së tyre; Monitorimi i kthimit të përgjigjeve ndaj pyetjeve të mediave*

*dhe personave të tjerë të interesuar, që kanë të bëjnë me një ngjarje aktuale, ose lidhur me një proces që ka filluar, është duke u zhvilluar, apo ka përfunduar pranë kësaj prokurorie; Monitorimi i reagimit kur në media, apo në publik është përhapur një informacion i pa drejtë, subjektiv, i njëanshëm, tendencioz, që mund të dëmtojë interesin e përgjithshëm të prokurorisë, integritetin profesional dhe moral të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore, të punonjësve të administratës të prokurorisë; Mbikëqyrja e bashkëpunimit ndërmjet, nëpunësit të caktuar për marrëdhëniet me publikun, dhe prokurorit të çështjes, i cili duhet të jetë i ngushtë dhe në afatin sa më të shkurtër kohor, që t'i ofrojnë informacionin e kërkuar publikut; Planifikimi i takimeve periodike, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.*

5. *Marrja e masave organizative administrative, si dhe mbikëqyrja e procedurës e brendshme të pranimit dhe trajtimit të kërkesave dhe mbajtjes së kontakteve me median. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave organizative dhe administrative për rregullimin e procedurës së brendshme për trajtimin e kërkesave; Marrja e masave organizative për mbajtjen e kontakteve median; Mbikëqyrja e procedurës së brendshme në mënyrë periodike; Evidentimi i problemtikave dhe zgjidhja e tyre; Cilësia e vendimmarrjeve për refuzimin e dhënies së informacionit.*
6. *Hartimi dhe dërgimi për media i komunikatave, sqarimeve, reagimeve, deklaratave, raporteve, dhe i publikimeve të shtypura dhe elektronike. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Qëndrimi aktiv në hartimin dhe dërgimin për media i komunikatave, sqarimeve, reagimeve, deklaratave, raporteve, dhe i publikimeve të shtypura dhe elektronike; Aftësia për të hartuar komunikatat, sqarimet, deklaratat, dhe aktet e tjera të publikuara. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria. Përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës; Aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë; Zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës; Përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), paragrafëve dhe e strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin; Përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë); Impakti publik i krijuar nga këto komunikime.*
7. *Organizimi i konferencave për media, debateve, apo prezantimeve audiovizive publike, si dhe menaxhimi i vazhdueshëm i adresave elektronike zyrtare, ku adresohen të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe mediave. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Qëndrimi aktiv në organizimin e konferencave për media, debateve, apo prezantimeve audiovizive publike; Aftësia e prezantimit publik dhe niveli i argumentimit gjatë diskutimit, mënyra e moderimit të diskutimit; Impakti publik i krijuar nga këto komunikime; Marrja e masave menaxhimi i vazhdueshëm i adresave elektronike zyrtare, ku adresohen të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe mediave; Marrja e masave për strukturimin e monitorimit, me marrjen e një ankese nga persona fizikë ose juridikë ose një informacioni i lidhur me problematika të konstatuara nga ushtrimi funksioneve në struktura të tjera, si dhe ndjekja procedurale sipas detyrave funksionale të parashikuara.*
8. *Hartimi dhe zbatimi i planit të komunikimit publik dhe monitorimi i mediave. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave për hartimin e planit të komunikimit publik; Marrja e masave për zbatimin e planit të komunikimit publik; Marrja e masave organizative dhe procedurale për monitorimin e mediave; Problematikat e evidentuara gjatë monitorimit dhe zgjidhja e tyre. Marrja e masave*

*për përmirësimin dhe përditësimin e planit të komunikimit publik dhe monitorimit të medias.*

9. *Marrja e masave administrative-rregullative për të garantuar qasjen e publikut në prokurori, duke përcaktuar, dhe bërë publike oraret për pritjen e publikut, dokumentacionin e takimeve ose të shkresave për t'iu përgjigjur institucioneve të ndryshme. Në këtë indikator vlerësohen elementet si: Marrja e masave konkrete administrative-rregullative për të garantuar qasjen e publikut në prokurori, duke përcaktuar, dhe bërë publike oraret për pritjen e publikut, dokumentacionin e takimeve; Marrja e masave për ndjekjen dhe zgjidhjen e problematikave të evidentuara gjatë takimeve; Marrja e masave për strukturimin e monitorimit, kthimit të përgjigjes ndaj shkresave të institucioneve të ndryshme; Marrja e masave organizative për realizimin e mbikëqyrjes periodike të kthimit të përgjigjeve; Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.*
10. *Hartimi i udhëzuesve, kodit etik për komunikimin publik. Në këtë indikator vlerësohen elementet si:Marrja e masave për hartimin e udhëzuesve për komunikimin publik; Marrja e masave për hartimin e kodit etik për komunikimin publik; Përgatitja dhe miratimi i programeve të transparencës; Monitorimi i zbatimit dhe përmirësimi i tyre; evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.*

***Shkalla e aftësisë së drejtuesit dhe pikëzimi***

*(Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën (cilësinë) e aftësisë së drejtuesit dhe pikët e propozuara për këtë tregues).*

Propozim për nivelin e vlerësimit

**KRITERI 2**

**AFTËSITË KOMUNIKUESE TË DREJTUESIT**

| Pikët | Shkalla/cilësia e aftësisë |
|---|---|
| | |

**NDARJA F**

**PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMIN DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT**

*Në ketë pjesë, relatori, bazuar në parashikimet e nenit 93, pika 5, shkronja "c" të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e prokurorëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, mbi bazën e pikëzimit të kryer prej tij, propozon nivelin e vlerësimit për secilin nga dy kriteret e vlerësimit të drejtuesit.*

**Propozim për nivelin e vlerësimit të përgjithshëm:**

| N/R | Kriteri | Shkalla/Cilësia | Niveli i vlerësimit |
|---|---|---|---|
| 1. | Aftësitë drejtuese dhe organizative të drejtuesit | | |
| 2. | Aftësitë komunikuese të drejtuesit | | |

| **Propozim për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit** |
|---|
| |

**NDARJA G**
**PROPOZIME DHE REKOMANDIME.**
*Në këtë pjesë, relatori, bazuar në parashikimet e nenit 93 pika 5 shkronja "ç" të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e prokurorëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, bën propozim për trajnime dhe/ose rekomandon hapa të cilët i vlerëson të nevojshëm për t'u ndërmarrë nga drejtuesi i prokurorisë me qëllim përmirësimin e veprimtarisë drejtuese së tij.*

**RELATOR**

*(EMRI, MBIEMRI DHE NËNSHKRIMI)*